

BASHKIA SHKODËR

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM

2025 - 2027 BASHKIA SHKODËR

Vizioni ynë është “Shkodra qendër e rëndësishme kombëtare e rajonale, një bashki me cilësi të mirë jetese për banorët e vet dhe mikpritëse për vizitorët”.

Bazuar në vizionin politik të kryetarit të bashkisë, puna e Bashkisë Shkodër në tre vitet e ardhshme do të jetë e fokusuar për të arritur një moment kthese në zhvillimin social dhe ekonomik të Shkodrës. Bashkia Shkodër do të jetë e përqëndrar tek puna si e vetmja mënyrë për t'i kthyer Shkodrës shkëlqimin që meriton si një nga qendra më të rëndësishme ekonomike dhe kulturore të vendit.

Në këto vite do të përqëndrohemi në këto shtylla kryesore:

- **Forcimi i ekonomisë nëpërmjet tërheqjes dhe zbatimit të investimeve publike të rëndësishme në territorin e bashkisë, çka do të krijojë një mjedis tërheqës për nxitjen e investimeve private dhe punësimit nga aktorë brenda e jashtë territorit të bashkisë.**
 - o *Një sërë investimesh madhore për territorin e bashkisë sonë kanë filluar e do të vijojnë edhe vitin e ardhshëm. Këto investime pavarësisht se mund të zhvillohen edhe nga aktorë të tjerë veç bashkisë do të kërkojnë një punë të madhe për përgatitjen, koordinimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e tyre. Për këtë arsye kemi ndërmarrë disa veprime kryesore:*
 - *Rishikimi i strukturës për të krijuar pranë zyrës së kryetarit të Bashkisë një Njësi të Menaxhimit të Projekteve, e cila do të koordinojë të gjitha aktivitetet e nevojshme për tu siguruar për zbatimin në kohë e me cilësi të investimeve kryesore.*
 - *Kemi parashikuar në buxhet një sasi të konsiderueshme fondesh për plane, studime, planifikime në mënyrë që gjithçka që bëjmë të jetë e mirëmenduar dhe e koordinuar në të gjitha nivelet.*

Ndër investimet kryesore të filluara ose në proces përgatitor janë:

Rruga e Dukagjinit filluar; Parku i hyrjes së Shkodrës, lidhur kontrata për lotin 1; rruga Shëngjin-Baks Rrjoll në punë; rruga Shirokë-Zogaj; Teatri Migjeni, Kinema republika, Sistemi i Muzeve, Investime në infrastruktura rrugore të qytetit dhe N.J.A. kryesore, shkolla dhe kopshtet publike, eficientia e energjisë në blloqet e pallateve, Rikualikimi i tregut të Zdrales, Impiani i Trajtitit të Ujrave të Zeza dhe Ujësjetësi Shkodër, Zgjeimi i Urës së Bahcallëkut dhe i rrugës Harku i Bërdiës-Ura e Bahcallëkut..

- **Kthimi i bashkisë në punë për t'iu përgjigjur me intensitet nevojave të qytetarëve në qytet dhe zonat rurale. Për këtë arsye kemi ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm si:**
 - o *Rishikimi i strukturës për të krijuar Ndërmarrjen e Shërbimeve dhe Punëve Publike dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike me qëllim intensifikimin e*

punëve të mirembajtjes së mjediseve publike, rrugëve, trotuareve e gjelbërimit, mirëmbajtjes së shkollave, kopshteve e godinave të tjera publike, përmirësimi i sinjalistikës horizontale e vertikale, ndërtimi i rrjetit të biçikletave në të gjithë qytetin,

- *Forcimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturës bashkiake nëpërmjet riorganizimit.*
 - *Vënies të të gjithëve në punë dhe ofrimit të kushteve më dinjitoze të punës; forcimi i infrastrukturës së bashkisë nëpërmjet paisjeve (makineri e paisje, materiale, makina, biçikleta dhe infrastrukturë IT.*
- ***Shkodra e kulturës, sportit dhe turizmit*** së pari si një politikë mirëqënieje për banorët por dhe si mjet për tërheqjen e vizitorëve.
- *Eshtë finalizuar brandimi, infot turistike dhe marketimi për bashkinë tonë.*
 - *Po fuqizojmë produktet specifike turistike*
 - *Kemi rritur buxhetin për aktivitete kulturore e sportive për të pasur në çdo sezon të vitit një apo dy evente madhore që tërheqin vizitorë në bashki, ndërkohë që përmirësojmë ndjeshëm infrastrukturën për evente kulturore dhe sportive.*
- ***Bashkia e hapur*** si një filozofi e re komunikimi me qytetarët dhe krijimi i një marrëdhënie të re transparence e besimi si bazë e domosdoshme për sukses.
- *Do të vazhdojmë politikën e “dyerve të hapura” të bashkisë si një vend eventesh si në sheshin përpara ashtu edhe brenda bashkisë në hollet e saj*
 - *Do të ndërtojmë një marrëdhënie më të ngushtë me qytetarët nëpërmjet informimit të vazhdueshëm rreth politikave vendore.*
 - *Do të ndërtojmë procese pjesëmarrëse në të gjitha nismat e mëdha si plani i mobilitetit, rishikimi i planit vendor dhe investimet e tjera madhore.*
 - *Komunikim më i hapur dhe intensiv me të gjithë aktorët zhvillimorë si komuniteti i biznesit, këshillat rinorë, universitetin e shkollat e mesme, shoqërinë civile për të çuar përpara nisma të përbashkëta.*

HYRJE.....	5
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	5
1.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	5
1.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË	10
1.3 INFORMACION FINANCIAR KRYESOR.....	10
1.3.1 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së.....	10
1.3.2 Tregues të rëndësishëm për buxhetin:.....	12
2. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË	13
2.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË/STRATEGJIA TERRITORIALE	13
2.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT	16
2.3 PLANI I SHPENZIMEVE KAPITALE 2025 - 2027 NE 000/LEKE	16
3. INFORMACION FINANCIAR.....	20
3.1 BURIMI I TE ARDHURAVE.....	20
2. Analiza e transfertës së pakushtëzuar sektoriale	23
3.1.1 Të ardhurat e veta të bashkisë	29
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA VENDORE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE	37
TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE	39
Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	40
Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	40
Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel	43
Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë	44
Të ardhura nga Taksa e Tabelës	45
TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA	46
Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura	47
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	47
Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare	47
Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	47
TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE.....	47
Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit	48
Taksapaguesit biznese dhe institucione	51
Të ardhura nga tarifa për shërbimet administrative	55
Të ardhura nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit.....	55
Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike	56
Të ardhura nga Tarifa për dhënie licënsë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve.....	56
Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave.....	56
Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri	56
Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike.....	56
Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet).....	56
Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.	57
TË ARDHURA TË TJERA	58
Te ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat.....	59
Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të Bashkisë.....	59
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	60
Të ardhura nga donacionet	60
Të ardhura dhe grantet ndërkombëtare.....	60
3.1.2 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	61
3.1.3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale	62
1. Analiza e përgjithshme	62
2. Analiza sipas sektorëve.....	62
3. Përmbledhje dhe përfundime	64
4. Analiza krahasuese	64
3.2 SHPENZIMET.....	67
1. Analiza e shpenzimeve totale	69
2. Analiza e zërave të shpenzimeve	70
1. Menaxhim dhe Shërbime Mbështetëse	73

2. Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	74
3. Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural.....	74
4. Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit	75
5. Shërbimet Publike Vendore.....	75
6. Kultura, Sporti, Argëtimi	76
7. Përkujdesi Social	77
8. Arsimit.....	77
9. Fondi i Rezervës dhe Kontigjencës	78
3.4 INFORMACION FINANCIAR SUPLEMENTAR.....	84
3.4.1 Huamarrja	84
3.4.2 Detyrimet e prapambetura.....	85
3.4.3 Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre.....	86
4. MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË NJËSISË	88
4.1 HYRJE – REZULTATI I PËRGJITHSHËM DHE PËRFUNDIME.....	88
4.3 INVESTIMET PUBLIKE STRATEGJIKE NË NIVEL VENDOR	92

Lista e Tabelave

Tabela 1 Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Shkodër	20
Tabela 2 Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit të financimit	25
Tabela 3 Të ardhurat e veta.....	31
Tabela 4 Të ardhurat e veta për vitet 2025-2027 sipas klasifikimit ekonomik	34
Tabela 5 Planifikimi i të ardhurave për vitet 2025-2027 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë.....	37
Tabela 6 Të ardhurat nga taksat vendore	39
Tabela 7 Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve sipas kategorizimit	40
Tabela 8 Kapaciteti i banesave të taksueshme	41
Tabela 9 Të dhena mesatare sipërfaqe e ndërtesave për taksapagues sipas llojit, familjar dhe biznes.....	41
Tabela 10 Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme, sipas kategorisë së bonitetit.....	42
Tabela 11 Efekti ekonomik i uljes së taksës së ndërtesës dhe tokës bujqësore	43
Tabela 12 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel	43
Tabela 13 Efekti i lehtësive fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë.....	45
Tabela 14 Të ardhurat nga taksat e ndara sipas llojit	46
Tabela 15 Të ardhurat nga tatifat vendore sipas llojit.....	48
Tabela 16 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve	49
Tabela 17 Kapaciteti i familjeve taksapaguese sipas grupimeve	50
Tabela 18 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese.....	51
Tabela 19 Kapaciteti i bizneseve të vogla sipas natyrës së tyre.....	53
Tabela 20 Kapaciteti i bizneseve të mëdha sipas natyrës së tyre	54
Tabela 21 Efekti ekonomik i lehtësive tek pastrimi, ndriçimi dhe gjelbrimi për familjet.....	55
Tabela 22 Të ardhura nga tarifatat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social.	57
Tabela 23 Të ardhurat e tjera sipas llojit të të ardhurës	58
Tabela 24 Transferta e pakushtëzuar	61
Tabela 25 Transferta e pakushtëzuar sektoriale	64
Tabela 26 Planifikimi i buxhetit për vitet 2024 -2026 sipas klasifikimit ekonomik	69
Tabela 27 Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.....	79
Tabela 28 Shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë 2025-2027...80	80
Tabela 29 Rezultati i buxhetit.....	84

HYRJE

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia e Shkodrës përfshin një territor me një sipërfaqe prej 872.71 km², dhe një popullsi prej rreth 214,270 banorë të regjistruar. Bashkia e Shkodrës ka në përbërjen e saj 11 njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipojë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 92 fshatra.

Bashkia Shkodër

Njësi Administrative: 11
(1 qytet dhe 92 fshatra)

Sipërfaqe: 872.71 km²

Popullsia: 214,270 banorë

Familje: 66,829




Bashkia Shkodër ka një pozicion strategjik duke mbuluar pjesë të Alpeve të Shqipërisë si dhe zonën detare dhe bujqësore në jug të saj. Ndërsa në pjesën perëndimore kufizohet nga Liqeni i Shkodrës, i cili ka një rëndësi mjaft të madhe kombëtare dhe ndërkufitare në marrëdhënie me Malin e Zi. Parë pikërisht nga marrëdhëniet ndërkufitare, pozicioni i favorshëm gjeografik, mundëson lidhjet si territoriale po ashtu edhe ekonomike dhe natyrore të Shkodrës me Malin e Zi dhe Kosovën duke e kthyer kështu në një pozicion mjaft të favorshëm strategjik për gjithë rajonin.

Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë së Shkodrës

Bashkia Shkodër	Nj.A	Fshatrat	Kufizimi Veri	Kufizimi Jug	Kufizimi Lindje	Kufizimi Perëndim
	Shkodër	Qyteti Shkodër 5 Lagje	Rrethina	Bërdicë, Guri i Zi	Rrethina, Guri i Zi	Liqeni i Shkodrës
	Ana e Malit	Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë esiperme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar	Shkodër	Lumi Buna Dajç	Rrethina	Mali i Zi
	Bërdicë	Bërdice e Madhe, Bërdice e Mesme, Bërdice e Sipërme, Trush, Beltoje, Mali Hebaj	Shkodër	Bushat	Guri i Zi Lumi Drin	Dajç
	Dajç	Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërme, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq	Lumi Buna Ana e Malit Mali i Zi	Velipojë	Bërdicë Bushat	Lumi Buna
	Guri i Zi	Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor	Postribë Shllak	Bushat Vau i Dejës	Vau i Dejës	Bërdicë Shkodër
	Postribë	Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz	Pult Malësi e Madhe	Guri i Zi	Shllak	Rrethina
	Pult	Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull	Shalë Malësi e Madhe	Postribë Shllak	Shosh Shalë	Malësi e Madhe
	Rrethinat	Dobraç, Grudë e Re, ShtojiRi, Guci e Re, Shtoj i vjeter, Zues, Golem, HotiRi, Bleran, Bardhaj	Gruemirë	ShkodërGuri i Zi	Postribë	Liqeni Shkodër
	Shalë	Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Nderlytaj, Gimaj, Nënnavriq, Lotaj	Kosove	Shosh Tropojë	Tropojë	Malësi e Madhe Pult
	Shosh	Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsuj, Brashtë	Shalë	Temal Shllak	Pult	Temal Tropoje Vau i Dejës
	Velipojë	Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj, Reç Pulaj	Dajç	Deti Adriatik	Lezhe	Lumi Buna


Tabela 1: Të dhëna mbi Bashkinë Shkodër

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Shkodër banojnë rreth 62 % e popullatës së qarkut Shkodër. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 214,270 banorë. Perqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (117,117 banorë). Parë nga këndvështrimi i raportit gjinor, popullsia e Bashkisë Shkodër ruan një diferencë të lehtë përse i përket ndarjes gjinore të popullsisë, në meshkuj e femra duke shprehur një situatë gjinore pothuaj të balancuar.



Burim i informacionit: Prefektura Shkodër


Zhvillimi ekonomik: Bashkia Shkodër karakterizohet nga një shumëllojshmëri aktiviteteve ekonomike ku mund të gjejmë elementë të industrisë, energjisë, zonave turistike dhe ekonomike. Vërehet se baza ekonomike përbëhet nga bizneset e vogla, të cilat janë edhe katalizatorë të zhvillimit, pasi krijimi, zhvillimi dhe përmirësimi i këtyre bizneseve përbën një potencial të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë e lehtë prodhuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile si dhe tregti e biznese shërbimesh.




Burim i Informacionit: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër.

Si një zonë karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtorale kemi prani të bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Gjithashtu edhe prania e bizneseve të artizanatit të cilët kanë një traditë të vjetër në qytetin e Shkodrës, vazhdon akoma sot duke luajtur rol të veçantë në ekonominë vendore. Industria përpunuese përbën


një nga potencialet më të mëdha të zhvillimit në Shkodër. Ndërsa në pjesën e ultësirës shtrihet një sipërfaqe e konsiderueshme tokash bujqësore, me një cilësi të lartë prodhimi. Veçanërisht, njësitë administrative Bërdicë, Velipojë, Dajç, Gur i Zi dhe Postribë kanë një avantazh të konsiderueshëm përsa i përket zhvillimit të bujqësisë. Ndërkohë përsa i përket prodhimit, mund të thuhet se në Shkodër ka një larmishmëri kulturash bujqësore të cilat prodhohen në territorin e bashkisë në periudha të ndryshme kohore. Aktualisht sipërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme janë burimi kryesor i të ardhurave ekonomike dhe kanë një strukturë si më poshtë:



Struktura e punësimit sipas sektorëve i referohet periudhës së 8-të mujorit të vitit 2024:



Burimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër



Burimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Papunësia: Bazuar në të dhënat paraprake të marra nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër për gjashtëmujorin e parë të vitin 2024 rezulton se:

Në Bashkinë Shkodër, numri i të papunëve për grupmoshën 19-64 vjeç vlerësohet të jetë 3,228 persona, referuar të dhënave Analiza e strukturës së papunësisë sipas grupmoshave tregon se shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë pune 30-39 vjeç është 18%. Në anën tjetër, përqindja e të papunëve të regjistruar për grupmoshën mbi 50 vjeç është më e lartë, duke reflektuar sfidat që hasin individët në këtë moshë për t'u riintegruar në tregun e punës.

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

Bashkia Shkodër mbështet skenarin policentrik të zhvillimit të territorit të saj. Ky skenar paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qëndërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qendër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor. Zona urbane e Shkodrës ka nevojë të krijojë qëndërsi të reja urbane rreth qendrës historike. Këto qëndërsi të reja urbane konsolidojnë strukturën ekzistuese, pa ndikuar në tipologjitë historike të ndërtimit. Ndërkohë zonat rurale kanë nevojë për të përmirësuar qendrat ekzistuese. Kjo qasje do të ruajë tokën bujqësore dhe burimet natyrore. Pra nga njëra anë skenari i policentrizmit promovon shpërndarjen në territor të centraliteteve (sipas një hierarkie të caktuar) dhe një vëmendje më të madhe në përmirësimin e cilësisë urbane edhe në zonat rurale, ndërkohe që nga ana tjetër promovon kompaktësimin dhe konsolidimin e tyre për të mos u shpërhapur në territor. Ky skenar promovon një zhvillim shumë-dimensional të ekonomisë dhe arritjen e qëllimit për zhvillimin rajonal duke promovuar edhe kohezionin territorial. Gjithashtu, krijohet një hierarki qendrash nga primare urbane (qyteti Shkodër) deri tek qendra lokale të cilat ofrojnë shërbime bazë për komunitetin. Gjithashtu skenari policentrik promovon mbrojtjen e burimeve natyrore e ujore duke garantuar mundësinë për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor sipas parashikimeve të PPK dhe PINS.

1.3 Informacion financiar kryesor

1.3.1 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së.

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2025 - 2027 është bere bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “ , udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV” , udhezimit plotesues nr. 3 date 28.02.2024 të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë “ *Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2025 - 2027* ” dhe dhe shtojcat plotesuese (*Shtojcat nr.1 Parashikimi I transferetes se pakushtezuar per bashkite e qarqet per periudhen 2025 - 2027 ; Shtojca nr.2 Relacioni I prgatitjes se programit buxhtor afatmesem vendor 2025 - 2027 ; Shtojca nr. 3 Treguesit kryesor makroekonomik e fiskale per periudhen 2025 - 2027 ; Shtojca nr. 5 Metodologjia e re per bashkite pilot ; Shtojca nr. 7-8 ; shtpojca nr. 7 dhe 8 – Detyrat e sugjeruara dhe afatet e brendshme per miratimin e PBA ; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” te ndryshuar ; Shkreses se Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14088 date 28.10.2024 “ Dergohet per njoftim Transfereta e Pakushtezuar e Pergjithshme per vitin 2025 “ ;*

Këshilli Bashkiak me VKB nr. 56 date 29.12.2023 “Per miratimin e kalendarit te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem 2025 - 2027 dhe buxhetit vjetor 2025 te Bashkise Shkoder” .

Veprimtaria e punës të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), ka qene si më poshte vijon:

- Vlerësimi dhe parashikimi i të ardhurave për vitet 2025 - 2027 dhe dërgimi për miratim në Këshill Bashkiak.
- Vlerësimi i strukturese se programeve lidhur me planifikimin buxhetor per periudhen 2025 - 2027 , duke siguruar perfshirjen brenda një programi shpenzimet sipas funksioneve të bashkisë.
- Analiza e politikave dhe objektivave të programeve sipas funksioneve të veta, të deleguara dhe atyre të financuara me transfertë specifike duke marre në konsiderate të dhenat financiare të një viti me pare, vitit aktual dhe parashikimin dhe planifikimin per tre vitet e ardhshme.
- Lidhja e objektivave strategjike te percaktuara në Planin e Pergjithshëm Vendor me objektivat e Programit Buxhetor Afatmesem.
- Prioriteteve të investimeve të miratuara në PPV dhe të konsultuara me qytetarët dhe grupet e interesit, në fushën e infrastrukturës publike.
- Analizes së shpenzimeve operative (dy vite më parë, viti aktual dhe për tre vitet e ardhshme).
- Analizes se parashikimit të shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2025 - 2027 , sipas çdo programi (per tre vitet e ardhshme).
- Analizës se vlerësimit të projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike.
- Analizes se sherbimeve të mirembajtjes se objekteve arsimore, administrative, rrugeve të brendshme dhe atyre rurale.
- Analizes se shpenzimeve të funksioneve të financuara me transfertë te pakushtezuar sektoriale, të transferuara që nga viti 2016.
- Shpërndarjen tek çdo Ekip i Menaxhimit të Programit të udhëzimeve të brendshem të nënshkruara nga titullari në lidhje me zbatimin e procedurave të programit buxhetor afatmesëm.
- Diskutimin me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t’u diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Nënshkrimin e të gjithë raporteve të përgatitjes së kerkesave buxhetore për përdorim të brendshëm të njesise në lidhje me Rishikimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.
- Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kerkesave buxhetore.

Bazuar ne Udhëzimin e Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr. 03 datë 28.02.2024 “Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025 - 2027 ” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV” dhe Shkreses se Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14088 date 28.10.2024 “ Dergohet per njoftim Transferta e Pakushtezuar e Pergjithshme per vitin 2025 “; Bashkia Shkoder ka hartuar projektin e pare te programit buxhetor afatmesem 2025 - 2027.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9970, datë 24. 07. 2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar, ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”, ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Bashkia Shkodër përmes programeve sociale ofron informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofron shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu trajton dhe mbështet viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

1.3.2 Tregues të rëndësishëm për buxhetin:

- Të ardhurat e veta vendore per vitet 2025 - 2027 , zënë mesatarisht 43 % të totalit të buxhetit.
 - 2024: 954,000 mijë lekë
 - 2025: 1,261,960 mijë lekë (+32.3%)
 - Mesatarja 2025-2027: 1,251,666 mijë lekë (+30.6% krahasuar me 2024)
- Transferta e pakushtëzuar per vitet 2025 - 2027 zë mesatarisht 37 % të totalit të buxhetit.
 - 2024: 957,789 mijë lekë
 - 2025: 1,039,174 mijë lekë (+8.5%)
 - Mesatarja 2025-2027: 1,077,050 mijë lekë (+12.5% krahasuar me 2024)
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale per vitet 2025 - 2027 zë mesatarisht 19 % të totalit të buxhetit.
 - 2024: 496,371 mijë lekë
 - 2025: 562,762 mijë lekë (+13.4%)
 - Mesatarja 2025-2027: 564,888 mijë lekë (+13.8% krahasuar me 2024)
- Totali i shpenzimeve te personelit per vitin 2025 është 1 267 861 mijë lekë dhe zë 43.2 % të totalit të shpenzimeve , per vitin 2026 është planifikuar 1 269 627 mijë lekë dhe ze 43.9 % te shpenzimeve dhe per vitin 2027 është planifikuar 1 269 172 mijë lekë dhe ze 43.4 % të totalit të shpenzimeve dhe zënë mesatarisht 43.5 % të totalit të shpenzimeve.
- Totali i shpenzimeve operative per vitin 2025 është 1 073 024 mijë lekë, per vitin 2026 është planifikuar 1 058 262 mijë lekë dhe per vitin 2027 është planifikuar 1 067 911 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 36.5 % të totalit të shpenzimeve .
- Totali i transfertave ku perfshihen edhe fondi rezerve dhe fondi i kontigjences per vitin 2025 është 253 363 mijë lekë, per vitin 2026 është planifikuar 252 565 mijë lekë dhe per vitin 2027 është planifikuar 255 167 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 8.7 % të totalit të shpenzimeve.

- Totali i shpenzimeve kapitale per vitin 2025 është planifikuar 343 885 mijë lekë, per vitin 2026 jane planifikuar 308 920 mijë lekë dhe ne vitin 2027 jane planifikuar 335 294 mijë lekë dhe mesatarisht ze 11.3 % te shpenzimeve totali.

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

Bazuar në direktivat kryesore të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit dhe në konsultim me palët e interesuara dhe qytetarët është hartuar objektivi afatgjatë për Bashkinë Shkodër:

“Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qëndër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike.

Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qëndër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit.

Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjetor do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agroturizmit, turizmit kulturor, malor e ujqor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.

Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujin dhe përballlet me sukses me rrezikun e përmbytjeve”.

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Objektivi Strategjik	Programi Strategjik	Programi Buxhetor
OS1: Përmirësimi Akselit dhe Marrëdhëniet Rajonale	OS1PS1: Terminalet multimodale	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS1PS2: Rregullimi i portave hyrëse në Shkodër	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS1PS3: Lidhjet strategjike rajonale e kombëtare	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS001PS4: Bashkëpunimi ndërkufitar	AC141 Mbështetje për zhvillimin ekonomik AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
OS2: Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses	OS2PS1: Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS2PS2: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS2PS3: Qendrat me një ndalesë dhe ngritja e kapaciteteve Lokale	AD141 Planifikim, menaxhim administrim
	OS2PS4: Qeverisja elektronike	AD141 Planifikim, menaxhim administrim
	OS2PS5: Qendrat multifunksionale dhe shërbimet sociale	AG141 Përkujdesi social
OS3: Konkureshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik	OS3PS1: Zhvillimi rural	Mbështetje për zhvillimin ekonomik
	OS3PS2: Zhvillimi akuakulturës	
	OS3PS3: Zhvillimi turizmit	
	OS3PS4: Mbështetja e sipërmarrjeve të reja	
	OS3PS5: Zhvillimi i zonave ekonomike	
	OS3PS6: Branding i Bashkisë Shkodër	
OS4: Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban		AB141 Siguria publike dhe mbrojtja civile
	OS4PS1: Rikualifikimi i ballinave ujore	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS4PS2: Restaurimi i ndërtesave historike dhe mbrojtja e trashëgimisë historike e kulturore	AF141 Kulturë, sport, argëtim dhe arsimit.
	OS4PS3: Rikualifikimi i hapësirave industriale dhe përdorimi i 'Broënfield'	AC141 Mbështetje për zhvillimin ekonomik

		AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit
OS4PS4: Urbanizimi i zonave informale		AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
OS4PS5: Rigjenerimi urban		AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
OS4PS6: Përmirësimi dhe integrimi i komuniteteve romë dhe egjiptiane		AE141 <u>Shërbimet publike vendore</u> AG141 Përkujdesi social
OS4PS7: Përmirësimi i qendrave të njësisve administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban		AE141 Shërbimet publike vendore
OS4PS8: Hapësirat publike; Hapësirat rekreative dhe sportive		AF141 Arsimi, kultura, sporti, argëtim
OS4PS9: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ		AE141 Shërbimet publike vendore
OS4PS10: Strehimi social dhe i përballueshëm		AG141 Përkujdesi Social
OS4PS11: Eficienca energjitike dhe energjia e rinovueshme		AE141 Shërbimet publike vendore
OS4PS12: Transporti publik		AE141 Shërbimet publike vendore
OS4PS13: Bicikletat		AE141 Shërbimet publike vendore
OS4PS14: Gjallëria urbane		AF141 Arsimi, kultura, sporti, argëtim AC141 Mbështetje për zhvillimin ekonomik
OS4PS15: Parkimet		AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
OS5: Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore	OS5PS1: Mbrojtja e mjedisit	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS5PS2: Mbrojtja nga përmbytjet	AB141 <u>Siguria publike dhe mbrojtja civile</u>
	OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane	AE141 Shërbimet publike vendore
	OS5PS4: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit
	OS5PS5: Qendra e menaxhimit nga risku i përmbytjeve	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.

OS5PS6: Menaxhimi i rreziqeve natyrore	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
OS5PS7: Menaxhim i pyjeve dhe kullotave	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
OS5 PS8: Ndryshimet klimatike	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

Burimi i informacionit: PPV/PZhS; të tjera

- Përforcimi i lidhjeve të Bashkisë Shkodër me rajonin përmes transportit rrugor, hekurudhor dhe ujor me qëllim zhvillimin social ekonomik të territorit të Bashkisë Shkodër.
- Përmirësimi i infrastrukturës në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë.
- Zhvillimi i ish-zonave industriale, duke përfshirë ndërlidhjen më të mirë të këtyre zonave me akse prioritare zhvillimi ekonomik. Ky hap do të kontribuonte në forcimin e pozicionit të Shkodrës si një qendër ekonomike e rëndësishme në rajon.
- Përmirësimi i riciklimit dhe i menaxhimit të mbetjeve, veçanërisht në qytete dhe zona rurale.
- Rigjenerimi/rikualifikimi i lagjeve duke përmirësuar cilësinë e hapësirave publike dhe kthimin e tyre në ambiente të këndshme dhe funksionale për qytetarët.
- Mbrojtja e biodiversitetit të liqenit dhe lumenjve dhe minimizimi i ndotjeve.
- Zhvillimi i Ekonomisë së Gjelbër dhe Ekonomisë Blu në Shkodër, duke e bërë atë një model të qëndrueshëm për zhvillim ekonomik dhe mbrojtje mjedisore.
- Zhvillimi rural, turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit, ekonomia blu dhe ajo e gjelbër.
- Integrimi i brezave të rinjtë në ekonominë vendore dhe krijimi i mundësive për iniciativa të reja.
- Rritja e kapaciteteve në sistemet e teknologjisë së informacionit.

Integrimi i turizmit me sektore të tjerë të ekonomisë si bujqësia, industria, dhe shërbimet, etj.

2.3 Plani i shpenzimeve kapitale 2025 - 2027 ne 000/leke

Nr. Prog	Emertimi programit	Emri i Projektit	2025	2026	2027
			Plani	Plani	Plani
AA141	Menaxhimi dhe Shërbimet	Blerje pajisje te ndryshme zyre.	812	612	612
		Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	9,581	2,581	2,581

	Mbështetëse	Shuma e investimit Programit	10,393	3,193	3,193
AB141	Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	Furnizim vendosje kamera sigurie per ambjente publike.	1,500		
		Blerje karrotreci	700		
		Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.	1,000	1,000	1,000
		Blerje + instalim, sistem përsëritës, përforcues të sinjalit të radiove të dorës për policinë bashkiake (repetitor, duplexer, radio bazë, antena, aksesore të plotësues; në valën UHF/VHF)	400		
		Blerje telefon celular + numer për policinë bashkiake	40		
		Shërbimi I Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	1,000		
		Shuma e investimit Programit	4,640	1,000	1,000
AC141	Mbështetj e për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural	Rikonstruksion i zyrave te Informacionit turistik,Qyteti i Shkoder, Velipoje, Theth			
		Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik	300	500	500
		Brandimi i territorit te Bashkise Shkoder	1300		
		Shuma e investimit Programit	1,600	500	500
AD141	Planifikim i dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi	Hartimi plani i Menaxhimit te Pyjeve e Kullotave te bashkise Shkoder(Ekonomi Pyjore Prueomos Sheldi)(Projektim)	2,229	2,251	4,000
		SHPRONESIME	16,000	19,000	19,000
		Rikualifikim Urban Bllaqe banimi Shkoder Qender		60,334	60,334
		Rikonstruksion Rruga “Bregu i Detit” Velipojë, Bashkia Shkodër	71,481		
		Rehabilitim, shtrim dhe asfaltim i rrugeve ne Njesi Administrative		83,638	90,889
		Rikonstruksion Rruga Roza Lejn	20,415		
		Rikonstruksion Rruga Selim Coba	21,192		
		Rikonstruksion degezim rruge Vekshar	10,708		

		Rikonstruksion rrugë Shkodër Qendër		76,000	94,874
		Rikualifikim urban sheshi pranee shkolles Martin Camaj	29,536		
		Rikualifikim urban bllok pallatesh Rruga Tafiliceve	25,370		
		Shuma e investimit Programit	196,931	241,223	269,097
AE141	Shërbimet Publike Vendore	Rikonstruksion I kanaleve kulluese (investim, mbikqyrje, kolaudim)	3,000		
		Blerje vegla pune per sherbimin e gjelberimit	900		
		Levizshmëria dhe sinjalistika	5,000	5,000	5,000
		Blerje fikse zjarri	100		
		Mirembajtje rrjeti dhe infrastrukture për ambjentin TIK	900		
		Sistem informacioni i integruar për menaxhimin financiar të NSHPP	250		
		Blerje kazanësh	3,000	3,000	3,000
		Ndërtim xhepush për kontenierë	3,849	3,849	3,849
		Ndriçim rruge dytesore+Projektim	14,000		
		Blerje automjete ne funksion tesherbimit te sistemit te ndriçimit publik te Qytetit dhe Njesive Administrative	5,000		
		Shuma e investimit Programit	35,999	11,849	11,849
AF141	Kultura, Sporti, Argëtim	Ndertimi I Ambjenteve Sportive Shkolla "Deshmoret e Prishtines" (Jeto me sportin)	3,541		
		Blerje paisje TIK	450		
		Blerje foni audio	300		
		Mobilim zyre	300		
		Blerje kondicioner / deumidifikator	200		
		Shpenzime per funksionimin e objekteve te trashegimise kulturore		1,250	1,250
		Zhvillim dhe pasurim i fondit te Biblotekes,libra,revista periodike	100		
		Blerje rafte librash	900		
		Blerje rafte per biblotekes	200		

		Shpenzime per aktivitetin		1,200	1,500
		Mirembajtje dhe blerje instrumentash	200	200	200
		Shuma e investimit Programit	6,191	2,650	2,950
AG141	Përkujdesi Social	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II)	30,000		
		Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit. (Ndertim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj.)		30,000	30,000
		Shuma e investimit Programit	30,000	30,000	30,000
AI141	Arsimi	Blerje pajisje operacionale	1,200		
		Blerje pajisje tik	900		
		Blerje vegla pune	1,200		
		Blerje uniforma pune	1,200		
		Blerje pajisje per sigurine ne kantier	1,200		
		Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse		5,700	5,700
		Blerje pajisje orendi	4,000	4,000	4,000
		Mobilim i konviktit Prenk Jakova	6,600		
		Projektim rikonstruksion shkolla të mesme të përgjithshme	3,000		
		Shkolla e hapur “Kolë Idromeno”	7,723		
		Rikonstruksion shkolla te mesme te pergjithshme		5,000	5,000
		Blerje pajisje orendi	605		
		Blerje pajisje për mobilim	1,000		
		Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse		1,605	1,605
		Rikonstruksion Shkolla Ndre Mjeda	23,876		
		Rikonstruksion I kopshtit bep Tusha	1,227		
		Projekt rikonstruksion I shkollave dhe fushave sporti	4,000	1,800	

	Materiale mbështetëse për mirembajtje per Cerdhet.	400	400	400
	Shuma e investimit Programit	58,131	18,505	16,705
	Totali	343,885	308,920	335,294

3. Informacion financiar

3.1 Burimi I te ardhurave

Buxheti total i Bashkisë Shkodër me burim financimi transferten e pakushtezuar , transferten sektoriale dhe te ardhurat e veta perfshire dhe donacionet për vitin 2025 është 2 938 133 mijë lekë, në vitin 2026 është planifikuar 2 889 374 mijë leke, ndersa ne vitin 2027 është planifikuar 2 927 544 mijë lekë.

Financimi i buxhetit realizohet nga:

- **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera dhe te ardhura qe trashegohen.
- **Nga grantet e projekteve të huaja dhe donacionet**, ku përfshihen grantet e përfituara përmes thirrjeve për propozime, për zbatimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar etj, në përputhje me ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve të financimit dhe VKM-ve për miratim në parim të marrëveshjeve të financimit.
- **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, që i jane transferuar Bashkisë, dhe transferta specifike per menaxhimin e mbetjeve.


Tabela 1 Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Shkodër

(000/lekë)

Nr.	BURIMET E FINANCIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR	VITI 2025	VITI 2026	VITI 2027
I	Nga burimet e veta vendore	1,261,960	1,247,232	1,245,806
1	Të ardhurat nga taksat lokale	592,668	592,826	586,527
2	Të ardhura nga taksat e ndara	155,035	155,035	156,535
3	Të ardhurat nga tarifat vendore	457,712	431,687	434,560
4	Të ardhura te tjera	56,545	67,684	68,184
II	Grante nga projektet e huaja	3,852		-
III	Nga burimet qendrore	1,601,936	1,642,142	1,681,738
1	Transferta e pakushtëzuar	938,455	976,549	1,013,990

2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	545,785	547,897	550,052
3	Transferte specifike per mbrojtjen e mjedisit	16,977	16,977	16,977
4	Transferta e pakushtëzuar per rritje page	100,719	100,719	100,719
IV	Te trasheguara	70,385		
	TOTALI	2,938,133	2,889,374	2,927,544

Grafik 1 Burimet e Financimit të PBA 2025 - 2027




Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Shkoder për vitet 2025 - 2027

Të ardhurat nga burimet qendrore, rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare bën që planifikimi i investimeve kapitale të jetë subjekt i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore.

Pavarësia financiare e Bashkisë Shkodër, matur si raport i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale, rezulton mesatarisht 44 % për trevjeçarin 2025 - 2027 . Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më madhe nga performanca e taksave dhe tarifave vendore.

Grafik 2 Raporti i burimeve te financimit 2025 - 2027



1.1. Burimet e veta vendore

Këto burime përbëjnë një pjesë të rëndësishme të autonomisë financiare të bashkisë. Për periudhën 2024-2027, ato ndjekin një trend të ngjashëm me rritje fillestare dhe qëndrueshmëri më pas.

Komponentët kryesorë:

1. Taksat lokale:

- Në vitin 2024: **376,487 mijë lekë**.
- Në vitin 2025: **592,668 mijë lekë (+57.4% nga 2024)**.

- Taksat mbeten të qëndrueshme në vitet pasuese me një rënie të lehtë në 2027 (**586,527 mijë lekë**). Meqenese ne vitin 2025 kemi parashikuar mbledhje te detyrimeve te prapambetura .
- 2. **Taksat e ndara :**
 - Në vitin 2024: **152 163 mijë lekë**.
 - Në vitin 2025: **155 035 mijë lekë**.
 - Taksat e ndara mbeten të qëndrueshme në vitet pasuese me nje rritje prej 1 % ne vitin 2027 kundrejt vitit 2026.
- 3. **Tarifat vendore:**
 - Në vitin 2024: **391,990 mijë lekë**.
 - Rriten në vitin 2025 në **457,712 mijë lekë** (+16.8% nga 2024), por pësojnë rënie më pas në **431,687 mijë lekë** në 2026 dhe rikuperojnë lehtë në **434,560 mijë lekë** në 2027. Ne vitin 2025 kemi parashikuar edhe mbledhjen te detyrimeve te prapambetura .
- 4. **Të ardhura të tjera:**
 - Rritja e vazhdueshme nga **33,360 mijë lekë** në 2024 në **68,184 mijë lekë** (+69.5% nga 2024)në 2027 (+104.5% nga 2024) është një tregues i mirë për përmirësimin e të ardhurave nga aktivitete dytësore .

Tendencat e përgjithshme:

- Burimet vendore pësojnë një rritje të konsiderueshme nga 2024 në 2025, duke treguar përpjekje për të forcuar mbledhjen e të ardhurave dhe kryesisht mbledhjen edhe te detyrimeve te prapambetura.

1.2. Burimet nga qeveria qendrore

Burimet nga qeveria qendrore janë një burim i qëndrueshëm financimi për Bashkinë Shkodër, duke mbuluar më shumë se gjysmën e buxhetit total.

Komponentët kryesorë:

1. **Transferta e pakushtëzuar:**
 - Shënon rritje të vazhdueshme nga **893,758 mijë lekë** në 2024 në **1,013,990 mijë lekë** në 2027 (+13.5% nga 2024).
 - Kjo transfere mbështet funksionimin bazë të bashkisë dhe është burimi më i qëndrueshëm ndër vite.
2. **Transferta për rritje page:**
 - Nga **64,031 mijë lekë** në 2024, ajo rritet në **100,719 mijë lekë** në 2025 dhe mbetet konstante deri në 2027.
 - Tregon prioritetin për mbështetjen e pagave të stafit të bashkisë.
3. **Transferta për mbrojtjen e mjedisit:**
 - Konstante në nivelin e **16,977 mijë lekë** për të gjitha vitet.

2. Analiza e transfertës së pakushtëzuar sektoriale

Transferta e pakushtëzuar sektoriale është një pjesë kyçe e financimit të dedikuar për sektorë të caktuar. Për periudhën 2025-2027, ajo ndjek një trend të qëndrueshëm, me një rritje të lehtë.

Tendenca vjetore:

- **2024: 480,046 mijë lekë.**
- **2025: 545,785 mijë lekë (+13.7%).**
- **2026: 547,897 mijë lekë (+0.4% nga 2025).**
- **2027: 550,052 mijë lekë (+0.4% nga 2026).**

Interpretimi i tendencave:

- Rritja e madhe nga 2024 në 2025 tregon përmirësim në financimin sektorial, që mund të përfshijë arsim.
- Stabiliteti nga 2025 deri në 2027 tregon se financimi është përcaktuar në bazë të prioritetëve të qeverisë qendrore dhe nevojave lokale.

Përfitimet e transfertës sektoriale:

- Siguron financim për funksionet specifike të deleguara nga qeveria qendrore.
- Ndhmon në uljen e presionit mbi burimet e veta të bashkisë, duke mbështetur sektorët strategjikë.

Tabela 2 Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit të financimit

000/leke

BURIMET BUXHETORE		2022	2023	2024	2024	2025	2026	2027
		Fakti	Fakti	Buxh.sipas VKB 55 date 27.12.2023	Pritshmi sipas buxh VKB 55 date 27.12.2023 ndryshuar	I rishikuar	I rishikuar	I rishikuar
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	970,365	941,029	965,087	970,217	1,265,812	1,247,232	1,245,806
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	344,708	303,651	376,487	376,487	592,668	592,826	586,527
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	2,238	1,898	1,000	1,000	1,000	500	500
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	187,954	195,328	212,566	212,566	248,668	237,043	237,244
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	167,173	171,488	175,840	175,840	201,932	191,307	191,407
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	6,226	8,226	21,736	21,736	22,986	22,299	22,299
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	14,555	15,614	14,990	14,990	23,750	23,437	23,538
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	18,408	26,609	24,000	24,000	30,000	30,000	31,000
A.1.4.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	121,182	65,703	123,921	123,921	267,000	279,283	271,683
A.1.4.2	Nga kontributi i subjekteve private në fondin publik të banesave sociale			-	-	30,000	30,000	30,000
A.1.5	Taksa e tabelës	14,926	14,113	15,000	15,000	16,000	16,000	16,100
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	118,568	166,877	152,163	152,163	155,035	155,035	156,535
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	18,935	10,650	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	70,780	101,350	93,128	93,128	91,000	91,000	91,500
A.2.3	Taksa e rentës minerare	6	1	35	35	35	35	35


A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	28,847	54,876	40,000	40,000	45,000	45,000	46,000
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	353,967	358,162	391,990	391,990	457,712	431,687	434,560
A.3.1	Tarifa me menaxhimin të mbetjeve	183,336	184,424	195,324	195,324	220,320	206,645	206,845
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	72,620	77,142	89,860	89,860	109,606	100,081	100,181
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	504	1,085	464	464	464	464	464
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	110,212	106,197	105,000	105,000	110,250	106,100	106,200
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve							
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	42,339	47,610	59,476	59,476	69,478	65,278	65,478
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	25,422	24,985	38,500	38,500	47,462	43,162	43,262
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	96	214	176	176	176	176	176
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	16,821	22,411	20,800	20,800	21,840	21,940	22,040
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	23,486	25,589	26,310	26,310	30,410	28,960	29,160
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	10,601	11,036	11,950	11,950	15,250	13,700	13,800
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	79	175	160	160	160	160	160
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	12,806	14,378	14,200	14,200	15,000	15,100	15,200
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	87,583	79,383	79,650	79,650	104,213	97,503	99,802
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	13,703	4,106	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500
A.3.5.5	Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit	1,513	1,068	812	812	998	808	1,086
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike	4,919	7,778	4,500	4,500	11,000	11,000	11,100
A.3.5.7	Tarifa për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	17,649	7,245	6,400	6,400	18,400	6,879	8,400
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	459	22	100	100	100	100	100
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shitesë nga zjarrëfiksja	1,487	2,079	1,423	1,423	2,300	2,300	2,600

A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	47,652	57,061	60,000	60,000	65,000	70,000	70,100
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	195	4	500	500	500	500	500
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	6	20	15	15	15	16	16
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	17,214	21,156	27,230	27,230	29,291	29,301	29,275
A.3.6.1	Bibloteka	9	9	15	15	15	15	15
A.3.6.2	Muzeumet	2,246	3,283	2,755	2,755	2,755	2,755	2,755
A.3.6.3	Teatri	306	2,005	2,400	2,400	2,500	2,500	2,500
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-			460	470	480
A.3.6.6	Qendra Komunitare	21	-	10	10	10	10	10
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	17	17	50	50	50	50	14
A.3.6.8	Kopshtet	9,846	10,788	15,000	15,000	14,995	14,995	14,995
A.3.6.9	Çerdhet	4,769	5,054	7,000	7,000	7,306	7,306	7,306
A.3.6.10	Kinema Republika					1,200	1,200	1,200
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	9	-	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
A.4	Të Ardhurat e Tjera	153,122	112,339	44,447	49,577	60,397	67,684	68,184
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	3,668	3,302	2,689	2,689	2,874	4,012	4,012
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	215	-	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	17,996	22,221	26,500	26,500	49,500	59,500	60,000
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdëmtime	1,668	959	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	88,139	83,028	11,087	16,217	3,852	-	-
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	39,762	-					
A.4.14	Të tjera	1,674	2,831	371	371	371	372	372
B	Transferta nga Buxheti Qendror	1,098,146	1,337,372	1,413,315	1,454,160	1,601,936	1,642,142	1,681,738
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	665,861	879,972	936,996	957,789	1,039,174	1,077,268	1,114,709

B.2	Transferta e Kushtëzuar	-	-	-	-	-	-	-
B.2.1	Për funksionet e deleguara							
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)							
B.3	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	432,285	457,400	476,319	496,371	562,762	564,874	567,029
C	Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
C.1	Huamarrja Afatshkurtër							
C.2	Huamarrja Afatgjatë							
D	Trashëgimi nga Viti i Shkuar	826,674	967,950	272,848	272,848	70,385	-	-
D.1	Trashëgimi Pa Destinacion	747,029	873,312	270,098	270,098	70,385		
D.2	Trashëgimi Me Destinacion	79,645	94,638	2,750	2,750			
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË	2,895,185	3,246,351	2,651,250	2,697,225	2,938,133	2,889,374	2,927,544

Grafik 3 Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit (në % ndaj totalit)

MESATARJA



3.1.1 Të ardhurat e veta të bashkisë

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifave vendore, dhe të ardhurat e tjera

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, te ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ te ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 1 date 22.01.2016 ”Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër“, të ndryshuar;
4. Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifave është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, të përditësuar, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Në përditësimin e paketës fiskale të Bashkisë së Shkodrës ndër vite, janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet. Për ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë takime konsultative gjithpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim.

Paketa fiskale e Bashkisë Shkodër, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj.sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:


- ✓ Politikat incentivuese në taksa:
 - Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.
 - Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
 - Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.
 - Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore.
- ✓ Politikat incentivuese dhe uljet nën nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:
 - Tarifa zero për shërbimin e gjelbërimit për zonat rurale
 - Tarifa minimale deri në zero për shërbimin e ndriçimit publik në zonat rurale
 - Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike.

- Tarifa të reduktuara 50% sipas kritereve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore
- Tarifa të ulëta pastrimi, dhe pa tarifa të tjera për ambulantët

Bashkia Shkodër, tashmë, ka ndërtuar një sistem të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksa paguesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit. Bashkia Shkodër ka kërkuar lidhjen e të dhënave për pasuritë e paluajtshme që disponon ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës) me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Tabela 3 Të ardhurat e veta

	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024 sipas Buxhetit	Viti 2024 Parashikimi I pritshem	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
Të ardhurat e veta / mijë lekë	682,069	659,778	762,298	882,226	888,305	954,000	954,000	1,261,960	1,247,232	1,245,806
Të ardhura nga taksat vendore	268,810	233,917	259,083	344,708	303,651	376,487	376,487	592,668	592,826	586,527
Të ardhura nga taksat e ndara	94,614	126,722	164,667	118,568	166,877	152,163	152,163	155,035	155,035	156,535
Të ardhura nga tarifat vendore	287,611	274,154	287,445	353,967	358,162	391,990	391,990	457,712	431,687	434,560
Të ardhura të tjera +grante nderkombetare+donacione	31,034	24,985	51,103	64,983	59,615	33,360	33,360	56,545	67,684	68,184
Grante nderkombetare me sistem të pjesshëm thesari	7,596	10,815	-	88,139	52,724	11,087	16,216	3,852	-	-
Të ardhurat total	689,665	670,593	762,298	970,365	941,029	965,087	970,216	1,265,812	1,247,232	1,245,806




Grafik 4 Pesha e të ardhurave të veta sipas klasifikimit ekonomik 2025-2027

Të ardhurat e veta, që mbledhen nga administrata e Bashkisë Shkodër në vitet 2025-2027 parashikohen që të jenë në vlerën 1,265,812 mijë lekë për vitin 2025 ose 30% më shumë se viti i kaluar ku peshën më të madhe specifike e zë taksa e ndikimit në infrastrukturë me 21% të totalit.

Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2025-2027 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 20%, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 21%, tarifa për pastrimin zë rreth 17%, taksa e qarkullimit të mjeteve të përdorura zë rreth 7%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 5%, tarifa e zënies së hapësirës publike me 5%, tarifa të tjera ku përfshihen tarifatat nga institucionet kulturore dhe tarifa administrative zë rreth 12%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 87% të planit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

PESHA E ÇDO TAKSË DHE TARIFË NË PARASHIKIMIN E TË ARDHURAVE



Grafik 5 Pesha e çdo taksë dhe tarifë në parashikimin e të ardhurave

Planifikimi i të ardhurave të veta për vitet 2025-2027 i kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor paraqitet si më poshtë:

Tabela 4 Të ardhurat e veta për vitet 2025-2027 sipas klasifikimit ekonomik

BURIMET BUXHETORE		2022	2023	2024	2024	2025	2026	2027
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	970,365	941,029	965,087	970,216	1,265,812	1,247,232	1,245,806
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	344,708	303,651	376,487	376,487	592,668	592,826	586,527
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	2,238	1,898	1,000	1,000	1,000	500	500
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	187,954	195,328	212,566	212,566	248,668	237,043	237,244
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	167,173	171,488	175,840	175,840	201,932	191,307	191,407
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	6,226	8,226	21,736	21,736	22,986	22,299	22,299
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	14,555	15,614	14,990	14,990	23,750	23,437	23,538
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	18,408	26,609	24,000	24,000	30,000	30,000	31,000
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	121,182	65,703	123,921	123,921	267,000	279,283	271,683
A.1.4.1	Kuntributi i subjekteve private në fondin publik të banesave sociale	-	-	-	-	30,000	30,000	30,000
A.1.5	Taksa e tabelës	14,926	14,113	15,000	15,000	16,000	16,000	16,100
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vend.	-	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	118,568	166,877	152,163	152,163	155,035	155,035	156,535
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	18,935	10,650	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	70,780	101,350	93,128	93,128	91,000	91,000	91,500
A.2.3	Taksa e rentës minerare	6	1	35	35	35	35	35
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	28,847	54,876	40,000	40,000	45,000	45,000	46,000
A.2.5	Taksa të tjera	-	-	-	-	-	-	-
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	353,967	358,162	391,990	391,990	457,712	431,687	434,560
A.3.1	Tarifa me menaxhimin te mbetjeve	183,336	184,424	195,324	195,324	220,320	206,645	206,845

A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	72,620	77,142	89,860	89,860	109,606	100,081	100,181
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	504	1,085	464	464	464	464	464
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	110,212	106,197	105,000	105,000	110,250	106,100	106,200
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	42,339	47,610	59,476	59,476	69,478	65,278	65,478
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	25,422	24,985	38,500	38,500	47,462	43,162	43,262
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	96	214	176	176	176	176	176
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	16,821	22,411	20,800	20,800	21,840	21,940	22,040
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	23,486	25,589	26,310	26,310	30,410	28,960	29,160
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	10,601	11,036	11,950	11,950	15,250	13,700	13,800
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	79	175	160	160	160	160	160
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	12,806	14,378	14,200	14,200	15,000	15,100	15,200
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	87,583	79,383	79,650	79,650	104,213	97,503	99,802
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	13,703	4,106	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500
A.3.5.2	Tarifa për dhënien e licënsave, lejeve e autorizimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e licënsimit të veprimtarive të transportit	1,513	1,068	812	812	998	808	1,086
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licënuara dhe vendparkime publike	4,919	7,778	4,500	4,500	11,000	11,000	11,100
A.3.5.7	Tarifa për dhënie licënsa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	17,649	7,245	6,400	6,400	18,400	6,879	8,400
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	459	22	100	100	100	100	100
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksjat	1,487	2,079	1,423	1,423	2,300	2,300	2,600
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	47,652	57,061	60,000	60,000	65,000	70,000	70,100
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	195	4	500	500	500	500	500
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	6	20	15	15	15	16	16
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	17,214	21,156	27,230	27,230	29,291	29,301	29,275
A.3.6.1	Bibloteka	9	9	15	15	15	15	15
A.3.6.2	Muzeumet	2,246	3,283	2,755	2,755	2,755	2,755	2,755

A.3.6.3	Teatri	306	2,005	2,400	2,400	2,500	2,500	2,500
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	460	470	480
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	21	-	10	10	10	10	10
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	17	17	50	50	50	50	14
A.3.6.8	Kopshtet	9,846	10,788	15,000	15,000	14,995	14,995	14,995
A.3.6.9	Çerdhet	4,769	5,054	7,000	7,000	7,306	7,306	7,306
A.3.6.10	Kinema Republika	-	-	-	-	1,200	1,200	1,200
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	9	-	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera	-	-	-	-	-	-	-
A.4	Të Ardhurat e Tjera	153,122	112,339	44,447	49,576	60,397	67,684	68,184
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	3,668	3,302	2,689	2,689	2,874	4,012	4,012
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	215	-	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	17,996	22,221	26,500	26,500	49,500	59,500	60,000
A.4.8	Sekuestime dhe Zhdëmtime	1,668	959	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	88,139	83,028	11,087	16,216	3,852	-	-
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	39,762	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	1,674	2,831	371	371	371	372	372


Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas Njësive Administrative

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave i ngarkohet Njesisë Administrative Shkodër, ose 83% të planit total të të ardhurave.

Tabela 5 Planifikimi i të ardhurave për vitet 2025-2027 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitet 2025-2027 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë																		
Viti	Totali	Njësia Administrative Qendër						Njësi Administrative të tjera										
		Shuma	Lagje nr. 1	Lagje nr. 2	Lagje nr. 3	Lagje nr. 4	Lagje nr. 5	Shuma	Pult	Shosh	Shalë	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajc	Ana e Malit	Rrethina
Plan 2025	1,265,812	1,045,647	224,935	215,188	213,122	202,530	189,872	220,165	250	165	2,917	7,349	9,670	14,320	147,806	6,517	3,599	27,572
Plan 2026	1,247,232	1,030,299	221,633	212,030	209,994	199,557	187,085	216,933	246	163	2,874	7,241	9,528	14,110	145,637	6,421	3,546	27,167
Plan 2027	1,245,806	1,029,121	221,380	211,787	209,754	199,329	186,871	216,685	246	162	2,871	7,233	9,517	14,094	145,470	6,414	3,542	27,136

Shpërndarja e të ardhurave sipas Njësive Administrative Administrative



Grafik Shpërndarja e të ardhurave sipas Njësive Administrative Administrative

Të ardhurat nga Taksat Vendore


Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësisve të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Për vitet 2025-2027 parashikohet që të ardhurat nga taksat vendore përbëjnë rreth 47% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

Tabela 6 Të ardhurat nga taksat vendore

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	592,668	592,826	586,427
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	950	500	500
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	50	0	0
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	248,668	237,043	237,244
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	30,000	30,000	31,000
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	267,000	279,283	271,683
Kontributi I subjekteve private në fondin publik të banesave sociale	30,000	30,000	30,000
Të ardhura nga taksa e tabelës	16,000	16,000	16,000

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila zë mbi 42% te totalit të të ardhurave nga taksat vendore, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me 45%, taksa e tabelës me 3% dhe taksa e fjetjes në hotel me 5%.



Grafik 6 Të ardhurat nga taksat vendore

Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar nga bizneset e vogla, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Shkodër.

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesa banimi dhe ndërtesa biznesi)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2025-2027 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë,
- Ndarjes në këste të pagesave për familjarët,
- Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucionin Agjencia e Kadastrës Shtetërore.

Kapaciteti i pronës së taksueshme

Bazuar në rregjistrat aktual, në total, sipërfaqja ndërtesave që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale te bashkisë Shkodër është rreth 711,100 m².

Bizneset tregti dhe shërbime kanë rreth 80% të sipërfaqes totale të bizneseve të taksueshme.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për sipërfaqet e taksueshme të ndërtesave në pronësi të bizneseve, sipas Njësisve Administrative:

Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve

Tabela 7 Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve sipas kategorizimit

Bashkia Shkodër	Total Sip. ndërtesa biznesi m ²	Sip. Taksueshme biznesi tregti-shërbime m ²	Sip. Taksueshme biznesi prodhimi m ²
NJA Qendër	391,589	288,191	103,398
Lagjia nr.1	79,704	72,835	6,869
Lagjia nr.2	93,148	50,225	42,923
Lagjia nr.3	104,411	64,718	39,693
Lagjia nr.4	70,801	65,981	4,820

Lagjia nr.5	43,525	34,432	9,093
NjA të tjera	319,511	286,593	32,918
NjA Pult	9	9	0
NjA Shosh	379	379	0
NjA Shalë	11,543	11243	300
NjA Postribë	9,647	8199	1448
NjA Guri i Zi	13,721	7746	5975
NjA Bërdicë	33,675	21580	12,095
NjA Velipojë	4,688	4341	347
NjA Velipojë Plazh	190,923	190923	0
NjA Dajc	3,520	2293	1227
NjA Ana e Malit	3,082	2987	95
NjA Rrethinat	48,324	36893	11,431
TOTALI	711,100	574,784	136,316

Tabela 8 Kapaciteti i banesave të taksueshme

Bashkia Shkodër	Total sipërfaqe ndërtesa banimi m ² (përfshirë lehtësimin)
NjA Shkodër	2,708,314
Lagjia nr.1	587,350
Lagjia nr.2	561,968
Lagjia nr.3	511,205
Lagjia nr.4	561,968
Lagjia nr.5	485,823
NjA të tjera	1,906,708
Pult	14,312
Shosh	3,607
Shalë	19,861
Postribë	292,801
Guri i Zi	155,647
Bërdicë	195,212
Velipojë	455,946
Dajc	242,520
Ana e Malit	133,266
Rrethinat	393,536
TOTALI	4,615,022


Tabela 9 Të dhena mesatare sipërfaqe e ndërtese për taksapagues sipas llojit, familjar dhe biznes

Bashkia Shkodër	Total Sipërfaqe truall i taksueshëm, m ²	Truall taksapagues familjar, m ²	Truall taksapagues biznes, m ²
NjA Shkodër	3,218,350	2,778,836	439,514
Lagjia nr.1	704,137	594,009	110,128
Lagjia nr.2	686,841	581,346	105,495
Lagjia nr.3	645,309	530,062	115,247
Lagjia nr.4	634,007	568,683	65,324
Lagjia nr.5	548,056	504,736	43,320
NjA të tjera	3,446,857	2,990,810	456,047
Pult	32,959	32,950	9
Shosh	16,583	16,121	462
Shalë	50,065	27,300	22765
Postribë	519,244	490,105	29139
Guri i Zi	254,364	229,826	24538
Bërdicë	433,890	333,724	100166
Velipojë	882,429	720,017	162412
Dajc	345,792	338,333	7459
Ana e Malit	243,265	236,448	6817
Rrethinat	668,266	565,986	102280
TOTALI	6,665,207	5,769,646	895,561

Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme

Tabela 10 Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme, sipas kategorisë së bonitetit

Nr	Bashkia Shkodër	Kat I	Kat II	Kat III	Kat IV	Kat V	Kat VI	Kat VII-X
1	NjA Pult	-	-	-	409	-	-	-
2	NjA Shosh	-	-	-	-	314	-	-
3	NjA Shalë	-	-	-	-	416	418	-
4	NjA Postribë	-	-	-	-	-	1 030	-
5	NjA Guri i Zi	-	-	-	1 965	-	-	-
6	NjA Bërdicë	-	-	-	2 151	-	-	-
7	NjA Velipojë	-	-	-	2 949	-	-	-
8	NjA Dajc	-	-	2 135	-	-	-	-
9	NjA Ana e Malit	-	-	886	887	-	-	-
10	NjA Rrethinat	-	-	-	-	2 481	-	-
	TOTALI	-	-	3 021	8 361	3 211	1 448	-



Grafik 7 të ardhurat mbi tokën bujqësore sipas kategorive të tokës

Efekti ekonomik i uljes së nivelit të taksës së pronës.

Bashkia Shkodër ka synuar mbajtjen e taksave në nivele të ulëta, deri në kufijtë e lejuar ligjor. Kështu, taksa e banesës dhe e ndërtesave për qëllime biznesi është ulur 30% në Njësitë Administrative, me një efekt prej 11,102 mijë Lekë në vit.

Taksa e tokës bujqësore është ulur deri në kufirin e lejuar 30% nga referenca ligjore. Efekti ekonomik i uljes së taksës së tokës bujqësore është 9,607 mijë Lekë/vit.

Në total, efekti ekonomik i uljes së taksave të pronës është 20,709 mijë Lekë në vit.

Tabela 11 Efekti ekonomik i uljes së taksës së ndërtesës dhe tokës bujqësore

Efektet financiare të uljes së taksës së pronës					000/leke
Emertimi	Njësi m2	Lekë/m2	Potenciali	Plani i të ardhurave	Efekti financiar
Banesa	4,615,022	20-29	106,452	98,500	7,952
Ndërtesa biznesi	711,100	24-122	106,582	103,432	3,150
Tokë bujqësore	16,043	0, 14-0,42	31,343	21,736	9,607
TOTAL			244,377	223.668	20,709

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Planifikimi i të ardhurave është bërë ju referuar kapacitetit aktual dhe parashakimit të zgjerimit të tij, rritjes së numrit të njësive, si dhe shtrirjen periudhave të sezoneve turistike për ushtrimin e aktivitetit.

Tabela 12 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Të dhënat e programit / Vitet	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Numri i turistëve (i personave) të akomoduar në hotele	282,229	105,425	214,286	229,928	285,714	286,714	428,210	428,210	428,500
Të ardhura nga taksa e qëndrimit në hotel në 000/Lekë	19,756	7,380	12,967	18,408	26,609	24,000	30,000	30,000	31,000

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Bashkia Shkoder, planin e të ardhurave nga taksa e ndikimi të infrastrukturës e ka bazuar në:

- Ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është përlllogaritur duke marrë për bazë parashikimin e lejeve për ndërtime të reja në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me VKB nr.: 27, datë 20.04.2017 “Për miratimin e planit të zhvillimit të territorit dhe rregulloren e zbatimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër” dhe me vendimin e KKT nr.5 date 16.10.2017 “ Per miratimin e planit te pergjithshem vendor si dhe në nismat Publike për hartim e PDV-ve, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, në disa njësi strukturore.

Kjo në mbështetje të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, si dhe në interesin publik;

- Shlyerjen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë të objekteve të legalizuara për objektet në process legalizimi, si dhe detyrime tatimore të pambledhura në kohë, prej më pak se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me ligjin. nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Shkodër, si dhe në mbështetjen nga Agjencia e Kadastres Shtetërore.

Efkti ekonomik i uljes së nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë

Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, Bashkia Shkodër ka ulur nivelin e taksës nga 3% në 2% të vlerës së investimit për Njësitë Administrative .

Efekti ekonomik në total është rreth 127,500 mijë Lekë në vit.

Tabela 13 Efekti i lehtësive fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë

Llogaritja e efektit financiar të lehtësimeve fiskale vendore ne 000/leke

Efektet financiare të uljes taksës së ndikimit në infrastrukturë			000/leke	
Emertimi	Njësi	Potenciali	Plani i të ardhurave	Efekti financiar
Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industries apo për përdorim publik.	4-8%	333,000	225,000	108,000
Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	1-3%	37,500	18,000	19,500
TOTAL		370,500	243,000	127,500

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Parashikimi i të ardhurave bazohet në numrin e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese dhe kërkesën për vendosje tabela reklamimi në akse kryesore rrugore.

Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Tabela 14 Të ardhurat nga taksat e ndara sipas llojit

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	155,035	155,035	156,535
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	91,000	91,000	91,500
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	19,000	19,000	19,000
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	35	35	35
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	45,000	45,000	46,000

Në përputhje me ligjin.nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.të ardhurat nga taksat e ndara, zënë 12% të totalit të të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër.

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Planifikimi i të ardhurave bëhet referuar numrit të automjeteve si dhe në eksperiencën e viteve të kaluara për nivelet e arkëtimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor .

Bashkia Shkodër përfiton 28 % të ardhura nga kjo taksë, e cila transferohet çdo muaj nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Planifikimi bëhet nga të dhenat e agjentit tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara referuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite.

Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Planifikimi i të ardhurave i është referuar të dhënave statistikore për të punësuarit në territorin e Bashkisë Shkodër, si dhe raporteve vjetore të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Parashikimi i vitit 2025 është bërë edhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 29/2023 Per tatimin mbi te ardhurat.

Të ardhurat nga Tarifatat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.


Për vitin 2025-2027 të ardhurat e parashikuara nga tarifatat përbëjnë rreth 36% të të ardhurave të veta.

Tabela 15 Të ardhurat nga tatifat vendore sipas llojit

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	457,712	431,687	434,560
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	220,320	206,645	206,845
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	69,478	65,278	65,478
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	30,410	28,960	29,160
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	137,504	130,804	133,077

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifatat vendore e zënë të ardhurat nga tarifatat për ofrimin e shërbimeve publike të pastrimit e largimit të mbeturinave me 48% të totalit të tarifave, duke qenë edhe një nga aktivitetet kryesore në funksionin e shërbimeve publike, të gjelbrimit me 7%, të ndriçimit publik me 15%, të shërbimit administrativ të bashkisë me 30%, ku bëjnë pjesë tarifa për zënien e hapësirës publike, tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj

Raporti i tarifave vendore mbi totalin e të ardhurave të veta



Grafik 8 Raporti i tarifave vendore mbi totalin e të ardhurave

Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Parashikimi i të ardhurave nga tarifatat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimit, bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës takapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me takapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Kontribuesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e rregjistrave për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak.

Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 41,275 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet, rreth 86%.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve

Tabela 16 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)			
Nr	Bashkia Shkodër	Familje	Biznese
I	Njësia Administrative Shkodër	21,253	4,644
1	Lagjia nr.1	4,745	1,277
2	Lagjia nr.2	4,231	844
3	Lagjia nr.3	4,399	1077
4	Lagjia nr.4	4,698	1046
5	Lagjia nr.5	3,180	400
II	Njësi Administrative të tjera	14,172	1,206
1	NjA Pult	334	1
2	NjA Shosh	80	11
3	NjA Shalë	477	89
4	NjA Postribë	1609	87
5	NjA Guri i Zi	1907	130
6	NjA Bërdicë	1425	147
7	NjA Velipojë	1270	252
8	NjA Dajç	1152	58
9	NjA Ana e Malit	1017	69
10	NjA Rrethinat	4901	362
	TOTALI	35,425	5,850

Taksapaguesit familjarë

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu referuar kapaciteteve reale të familjeve rezidente sipas Censurit, si dhe lehtësive fiskale të miratuara.


Në total numri i familjeve që përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 35,425. Në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër janë parashikuar lehtësi fiskale dhe numri i këtyre familjeve arrin në 10,714 familje si pensionistë, invalid, familje me ndihmë ekonomike, familje njëprindërore, familje me probleme sociale etj. Ato zënë 30% të numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Shkodër.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për familjet sipas kategorive/lehtësive fiskale dhe sipas Njësie Administrative:

Tabela 17 Kapaciteti i familjeve taksapaguese sipas grupimeve

Nr	Bashkia Shkodër	Totali i familjeve	Familje me taksa/tarifatëplota	Familje me lehtësi fiskale	Me lehtësi fiskale: Pensionistë, invalidë etj.	Me lehtësi fiskale: nd.ekonomike.
I	NjA Qendër	20,415	14,511	5,904	5,687	217
1	Lagjia nr.1	4745	3,562	1183	1126	57
2	Lagjia nr.2	4231	3,442	789	766	23
3	Lagjia nr.3	4399	3,178	1221	1207	14
4	Lagjia nr.4	4698	2,627	2071	1,976	95
5	Lagjia nr.5	2342	1,702	640	612	28
II	NjA të tjera	15,010	12,521	2,489	1,349	1,140
1	NjA Pult	333	691	125	4	50
2	NjA Shosh	68			2	27
3	NjA Shalë	415			14	28
4	NjA Postrisë	1793	1221	572	170	402
5	NjA Guri i Zi	2090	1759	331	161	170
6	NjA Bërdicë	1543	1207	336	258	78
7	NjA Velipojë	1322	1102	220	166	54
8	NjA Dajç	1144	1083	61	41	20
9	NjA Ana e Malit	1074	909	165	98	67
10	NjA Rrethinat	5228	4549	679	435	244
	TOTALI	35,425	27,032	8,393	7,036	1,357

Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Shkodër




Kapacitetet fiskale për taksapaguesit familjar



Grafik 9 Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Shkodër

Grafik 10 Kapacitetet fiskale për taksapaguesit familjar



Grafik 11 Kapacitetet fiskale për taksapaguesit familja sipas njësive administrative

Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 5,850. Biznesi i vogël zë rreth 71% të numrit total të bizneseve.


Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset dhe institucionet, sipas Njësive Administrative:

Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese

Tabela 18 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE					
Nr	Bashkia Shkodër	Totali	Biznes i vogel	Biznes i madh	Institucione
I	NjA Qendër	4,644	3,275	1,322	47
	Lagjia nr.1	1277	953	315	9
	Lagjia nr.2	844	576	258	10
	Lagjia nr.3	1077	771	297	9
	Lagjia nr.4	1,046	717	313	16
	Lagjia nr.5	400	258	139	3
II	NjA të tjera	1,206	883	317	6
	NjA Pult	1	1	0	0
	NjA Shosh	11	10	1	0
	NjA Shalë	89	77	12	0

NjA Postribë	87	69	18	0
NjA Guri i Zi	130	96	33	1
NjA Bërdicë	147	84	63	0
NjA Velipojë	252	211	40	1
NjA Dajc	58	30	28	0
NjA Ana e Malit	69	52	17	0
NjA Rrethinat	362	253	105	4
TOTALI	5850	4158	1639	53



Grafik 12 Shpërndarja e biznesit në Bashkinë Shkodër



Grafik 13 Raporti i bizneseve sipas xhiros


Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e vogla vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 89% ndaj totalit të bizneseve të vegjël.

Tabela 19 Kapaciteti i bizneseve te vogla sipas natyres se tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TE VOGLA SIPAS NATYRES SE TYRE

Nr	Bashkia Shkodër	Biznesi i vogël	Nga kjo :			
			Njësi tregtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Profesione te lira	Ambulantë
I	NjA Shkodër	3,275	2,887	59	226	103
	Lagjia nr.1	953	882	17	46	8
	Lagjia nr.2	576	507	14	45	10
	Lagjia nr.3	771	655	7	30	79
	Lagjia nr.4	717	602	10	99	6
	Lagjia nr.5	258	241	11	6	0
II	NjA të tjera	883	801	46	19	17
	Pult	1	1	0	0	0
	Shosh	10	10	0	0	0
	Shalë	77	77	0	0	0
	Postribë	69	62	6	1	0
	Guri i Zi	96	89	3	4	0
	Bërdicë	84	73	11	0	0
	Velipojë	211	187	4	3	17
	Dajc	30	23	5	2	0
	Ana e Malit	52	48	3	1	0
	Rrethinat	253	231	14	8	0
	TOTALI	4,158	3,688	105	245	120

Kapacitetet e biznesit të vogël



Grafik 14 Kapacitetet e biznesit të vogël


Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e mëdha, vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 70% ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj.

Tabela 20 Kapaciteti i bizneseve të mëdha sipas natyrës së tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TË MËDHA SIPAS NATYRËS SË TYRE

	Bashkia Shkodër	Biznesi i madh	Nga kjo :					
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi tregëtare për tregëtim karburanti	Njësi prodhimi	Subjekte ndërtimi	OJF	Institucione
I	NjA Shkodër	1,369	973	20	113	78	138	47
	Lagjia nr.1	324	243	11	20	15	26	9
	Lagjia nr.2	268	186	3	41	13	15	10
	Lagjia nr.3	306	205	2	24	21	45	9
	Lagjia nr.4	329	247	2	13	19	32	16
	Lagjia nr.5	142	92	2	15	10	20	3
II	NjA të tjera	323	212	21	43	21	20	6
	Pult	0	0	0	0	0	0	0
	Shosh	1	1	0	0	0	0	0
	Shalë	12	9	0	1	1	1	0
	Postribë	18	10	3	2	2	1	0
	Guri i Zi	34	16	1	8	5	3	1
	Bërdicë	63	41	4	12	5	1	0
	Velipojë	41	28	3	2	4	3	1
	Dajc	28	22	1	4	0	1	0
	Ana e Malit	17	15	2	0	0	0	0
	Rrethinat	109	70	7	14	4	10	4
	TOTALI	1692	1185	41	156	99	158	53

Kapaciteti i biznesit te madh



Grafik 15 Kapaciteti i biznesit te madh

Efekti ekonomik i lehtësive të tarifave për familjet

Bashkia Shkodër aplikon lehtësi tek tarifat vjetore të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbrimit 50% për familjet që kanë statusin e pensionistit, Invalidit, Paraplegjik, Tetraplegjik etj, dhe tarifa zero kur janë përfitues të ndihmës ekonomike. Efekti ekonomik mesatar i këtyre lehtësive llogaritet në total 25,753 mijë Lekë në vit.

Tabela 21 Efekti ekonomik i lehtësive tek pastrimi, ndriçimi dhe gjelbrimi për familjet

Efekti ekonomik të lehtësive tek tarifat vjetore familjare për familjet me kryefamiljar pensionit, invalid, si dhe përfituesit e ndihmes ekonomike 000/leke

Emertimi	Njësi	Lekë/Njësi	Potenciali	Plani i të ardhurave	Efekti financiar
Pastrimi	35,425	1450-3450	122,216	109,606	12,610
Ndriçimi	35,425	720-1500	54,600	47,462	7,138
Gjelbrimi	35,425	600	21,255	15,250	6,005
TOTAL			198,071	172,318	25,753

Të ardhura nga tarifa për shërbimet administrative

Tarifat për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje ndërtimi, zhvillimi, kontrolle dhe verifikime etj planifikohen të kenë një rritje të njetrajtshme të ardhurash në vit.

Të ardhura nga Tarifat e liçensimit te veprimtarive te transportit

Plani i të ardhurave të parashikuara, bazohet tek trendi i aplikimeve për rinovimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që pajisen me liçensën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike.

Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një licensë transporti, dhe një pjesë e tyre kanë vende të caktuara me sinjalistikë të veçante rrugore si taksi, mikrobusë, autobusë etj.

Të ardhura nga Tarifa për dhënie licensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve.

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, ky zë parashikon një shifër konstante, duke u bazuar tek trendi i aplikimeve për rinovimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që tregtojnë karburant, të cilave u përfundon afati 5- vjeçar i licencës.

Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave.

Të ardhurat e parashikuara bazohen në trendin e aplikimeve të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri.

Të ardhurat e parashikuara bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, sipas VKM, nr.607, datë 29.07.2020“Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” . Sipas kësaj dispozite ligjore, tarifat nuk aplikohen kur akti i ekspertimit kërkohet nga Prokuroria

Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kërkesës në vite dhe trendit në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë si dhe VKM për stacionet e plazhit.

Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet).

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave brenda juridiksionit të Bashkisë. Bashkia Shkoder është duke bërë regjistrimin e infrastrukturës pasive e cila mundëson vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ne regjistrin elektronik të të dhënave në sistemin ATLAS. Ne zbatim të Ligjit nr.120/2016 “Për

zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Vendimit nr.851 datë 07.12.2016 “Për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike të Bashkitë”, Ligji Nr. 9918 datë, 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” si edhe të Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, bashkia konsiderohet si operator rrjeti, pasi ka në pronësi apo administron infrastrukturë pasive të tubacioneve, të cilat mundësojnë vendosjen e rrjetit të komunikimeve elektronike.

Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të këtyre institucioneve, si dhe realizimit ndër vite.

Tabela 22 Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social.

Te dhenat e programeve	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Nr femije në kopshte	1681	1862	1862	2000	2000	2000	2000	2000	2000
Numri i fëmijevë të shërbyer në çerdhe	172	190	310	310	310	310	310	310	310
Numri i aktiviteteve kulturore gjithsej	65	50	71	71	71	71	136	136	136
Nr i vizitoreve në muzeume	12035	2950	12500	12500	12500	12500	30850	30850	30850
Nr i nxenesve që perfitojne ushqim me pagese	11	3	7	7	7	7	18	18	18

Efekti ekonomik i lehtësive të tarifave të kopshteve dhe çerdheve

Bashkia Shkodër po aplikon lehtësi tek tarifat vjetore të kopshteve dhe çerdheve për fëmijët me aftësi ndryshe. Efekti ekonomik mesatar i këtyre lehtësive llogaritet në total 3,549 mijë Lekë në vit.

Tabela 21 Efekti ekonomik i lehtësive të kopshteve dhe çerdheve

Efektet financiare të lehtësive të tarifave të kopshteve dhe çerdheve					000/leke
Emertimi	Nr. I femijeve	kuotë/ditë	Potenciali	Plani i të ardhurave	Efekti financiar




Kopshte	355	160	17,600	14,995	2,605
Cerdhe	205	125	8,250	7,306	944
TOTAL			25,850	22,301	3,549

Te ardhura të tjera

Tabela 23 Të ardhurat e tjera sipas llojit të të ardhurës

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
TË ARDHURA TË TJERA	60,397	67,684	68,184
Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	49,500	59,500	60,000
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	2,874	4,012	4,012
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	2,000	2,000	2,000
Grante nga ndihma nderkombetare me llogari ne thesar	0	0	0
Shitja e aseteve financiare	0	0	0
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	1,800	1,800	1,800
Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0
Të ardhura nga privatizimi	0	0	0
Të ardhura te tjera si agjent tatimor për taksën e pulles	371	372	372
Të ardhura nga garanci financiare	0	0	0
Të ardhura nga donacione/sponsorizime	0	0	0
Grante nga ndihma nderkombetare me llogari jashtë thesari	3,852	0	0

Të ardhurat e tjera zënë 5% të totalit të të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër. Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave të tjera e zënë të ardhurat nga kundravajtjet administrative (Gjobat) me 82 % të totalit të të ardhurave të tjera, duke vijuar me të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë 5%, të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime me 3%, të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve me 3%, të ardhura te tjera si agjent tatimor 1 % dhe grante nga ndihma ndërkombëtare me 6%.



Grafik 16 Peshat e të ardhurave të tjera sipas llojit

Te ardhurat nga kundrvajtje administrative/gjobat

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”: Bazuar në Nenin 6.b, ”Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta”.

Bazuar në Nenin 10, “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga kamatvonesa për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjoba për kundrvajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Ndërtimit Vendor etj.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kontratave vijuese dhe kapaciteteve brenda juridiksionit të Bashkisë dhe dhënies me qira të objekteve të cilave i ka përfunduar ose i përfundon afati i kontratës, sipas miratimeve me vendim të këshillit bashkiak.

Te ky zë parashikohen të ardhurat nga qira të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve

Sipas përcaktimeve ligjore, aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

Të ardhura nga donacionet

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi marrëveshjet për sponsorizime, nga organizata jo qeveritare, subjekte shtetërore / private dhe individë.

Të ardhura dhe grantet ndërkombëtare

Grant/ndihmë- janë të ardhura të përfituara në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, për një qëllim të përcaktuar ose jo, e cila përdoret për financimin e veprimtarive në përputhje me politika të caktuara dhe që jepen mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse nga institucione financiare, organizma të huaj, qeveri të vendeve të tjera etj.dhe marrëveshje për grante ndërkombëtare sipas aplikimeve në thirrje të ndryshme .

Ministria përgjegjëse për financat kontrollon, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat, kreditë dhe grantet. NJQP-të paraqesin, pranë strukturës përgjegjëse për buxhetin, kërkesat për përfshirje në programin buxhetor afatmesëm (PBA), në të cilin identifikohen me kod të veçantë produkti sipas klasifikimit funksional buxhetor. NJQP-të janë të detyruara t'i raportojnë ministrisë përgjegjëse për financat të dhënat e kërkuara të financimeve të huaja, brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave, kredive dhe granteve me financim të huaj do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor që miratohet në Këshill Bashkiak.

Projektet me sistem të pjesshëm Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara për çdo projekt të financimit të huaj.

Bashkia në vijim të marrëveshjeve të lidhura dhe projekteve në vazhdim, ka të parashikuara në vitin 2025 shumën 770 mijë lekë nga projekti TVESA, shumën 2,294 “Building Smart Forest”, shumën 53 mijë lekë për projektin “Punësim dhe mësim për përfshirje sociale” , shumën 115 mijë lekë nga projekti “Hold On”- Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë si dhe shumën 620 mijë lekë projekti “Fuqizim I komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.

Projektet me sistem të plotë Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transitimit nga llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara, për çdo projekt të financimit të huaj në Bankën e Shqipërisë.

3.1.2 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme.

Në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ndarja e transfertës së pakushtëzuar sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për periudhën 2025-2027 është bërë bazuar në formulë, sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Të dhënat sipas kriterit të popullsisë, të dëndësisë së popullsisë, të numrit të nxënësve, taksat e përdorura për ekualizimin janë ato të përdorura në ndarjen e transfertës së pakushtëzuar . Ndarja e transfertes se pakushteuzar sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2025-2027 , paraqitet në shtojcën nr. 1 “ Parashikimi i transfertes se pakshteuzar te pergjithshme per bashkite dhe qarqet per periudhen 2025-2027 “ bashkelidhe udhezimit .

Sipas udhëzimit plotësues nr. 3 datë 28.02.2024 “ Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027 për Bashkinë Shkodër transferta e pakushtëzuar është parashikuar si më poshtë :

Tabela 24 Transferta e pakushtëzuar

Vitet	(000/lekë)					
	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
Transferte e pakushteuzar	665,861	792,748	957,789	1,039,174	1,077,268	1,114,709

Më poshtë jepet grafiku i transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë Shkodër (përfshirë të gjitha NJA-të) që nga viti 2008 e në vazhdim.

Ne zbatim të ligjit të financave vendore , në vitin 2018, transferta e pakushtëzuar, është rritur 9.2%, ne krahasim me nje vit me pare, në vitin 2019 ka një rritje më të vogël se në vitin 2018, me rreth 2.2%, ne vitin 2020 ka një rritje me rreth 4.6 %, ne vitin 2021 ka një rritje me 0.7%, ne vitin 2022 ka një rritje me 2% ndaj vitit 2021, ne vitin 2023 ka një rritje prej 19.1 % ndaj viti 2022, ne vitin 2024 ka një rritje prej 18.1 % ndaj viti 2023, ne vitin 2025 ka një rritje prej 8.5 % ndaj viti 2024, ne vitin 2026 ka një rritje prej 3.7 % ndaj viti 2025, ne vitin 2027 ka një rritje prej 3.5 % ndaj viti 2026.

- Viti 2024: 957,789 mijë lekë
- Viti 2025: 1,039,174 mijë lekë (+8.5%)
- Mesatarja 2025-2027: 1,077,050 mijë lekë (+12.5% krahasuar me vitin 2024)

Tendenca: Transferta e pakushtëzuar tregon një rritje të qëndrueshme, e cila ndihmon në mbështetje të aktiviteteve të përditshme dhe zhvillimin e projekteve të planifikuara.

- Ndikimi: Kjo rritje mund të sigurojë fonde të qëndrueshme për shërbime të përgjithshme dhe projekte zhvillimi.

Grafik 17 Transferta e pakushtëzuar në vite Bashkia Shkoder me Njësitë Administrative 000/lekë



3.1.3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Sipas udhezimit transferta pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor për periudhën 2025-2027 , bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale siguron fonde specifike për sektorë të rëndësishëm në nivel lokal. Analiza e të dhënave për periudhën 2024-2027 ofron një pasqyrë mbi prioritetet sektoriale dhe mënyrën si këto fonde përcaktohen dhe shpërndahen.

1. Analiza e përgjithshme

Totali i transfertës sektoriale shfaq një rritje të qëndrueshme gjatë periudhës:

- **2024: 496,371 mijë lekë**
- **2025: 562,762 mijë lekë (+13.4%)**
- **2026: 564,874 mijë lekë (+0.4%)**
- **2027: 567,029 mijë lekë (+0.4%)**

Rritja më e madhe ndodh nga viti 2024 në 2025, që tregon prioritet për financimin sektorial. Pas kësaj, shifrat stabilizohen, duke sugjeruar një përcaktim afatgjatë të nevojave buxhetore.

2. Analiza sipas sektorëve

Më poshtë jepen detaje mbi alokimin e fondeve për secilin sektor dhe ndryshimet ndër vite.

2.1. Arsimi

Ky sektor zë pjesën më të madhe të transfertës sektoriale, duke përfshirë arsimin profesional, të mesëm dhe bazë.

1. **Arsimi profesional:**
 - **2024: 62,068 mijë lekë**
 - **2027: 66,513 mijë lekë (+7.2% nga 2024)**
 2. **Arsimi i mesëm i përgjithshëm:**
 - Financimi mbetet konstant pas 2025: **31,884 mijë lekë**.
 3. **Arsimi bazë dhe parashkollor:**
 - **Personeli:** Nga **165,491 mijë lekë** në 2024 në **199,467 mijë lekë (+20.5%)**.
 - **Stafi mbështetës:** Nga **64,940 mijë lekë** në 2024 në **67,533 mijë lekë (+4%)**.
 - Ky sektor merr rritjen më të madhe në fonde, duke reflektuar prioritetin për përmirësimin e arsimit bazë dhe parashkollor.
-

2.2. Kujdesi social

1. **Personat e sëmurë dhe me aftësi ndryshe:**
 - **2024: 38,183 mijë lekë**
 - **2027: 45,359 mijë lekë (+18.8%)**
 - Financimi reflekton përpjekjet për të përmirësuar shërbimet sociale për grupet më vulnerabël.
-

2.3. Infrastrukturë dhe shërbime publike

1. **Rrjeti rrugor rural:**
 - Rritje graduale nga **23,061 mijë lekë** në 2024 në **24,612 mijë lekë** në 2027 (+6.7%).
 - Prioritet për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrugëve rurale.
 2. **Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit:**
 - Financimi rritet lehtë, nga **31,980 mijë lekë** në 2024 në **33,257 mijë lekë** në 2027 (+4%).
 - Fokus në mbështetjen e sektorit bujqësor dhe përmirësimin e sistemeve të ujitjes.
 3. **Menaxhimi i mbetjeve urbane:**
 - Financimi mbetet konstant në **16,977 mijë lekë** pas 2025.
-

2.4. Mbrojtja civile dhe mjedisi

1. **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile:**
 - Një rritje e madhe nga **50,121 mijë lekë** në 2024 në **67,343 mijë lekë** (+34.4%).
 - Kjo tregon një përqendrim në përmirësimin e kapaciteteve emergjente dhe sigurisë publike.
2. **Administrimi i pyjeve dhe kullotave:**
 - Financimi mbetet konstant pas një rritjeje të lehtë nga **13,543 mijë lekë** në 2024 në **14,084 mijë lekë (+4%)**.



3. Përmbledhje dhe përfundime

Prioritetet kryesore:

- **Arsimi bazë dhe kujdesi social** janë sektorët me përfitimin më të madh nga transfertat sektoriale.
- **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile** përfiton një rritje të konsiderueshme, duke reflektuar një prioritet të lartë për emergjencat civile.
- Financimi për **infrastrukturën rurale** dhe **ujitjen/kullimin** mbetet i qëndrueshëm, duke treguar rëndësinë e zhvillimit bujqësor dhe mirëmbajtjes së rrjeteve ekzistuese.

Tabela e transfertes se pakushtëzuar sektoriale per PBA 2025-2027 eshte si me poshte:

Tabela 25 Transferta e pakushtëzuar sektoriale

000/leke

Emertimi programit	PBA 2024	PBA 2025	PBA 2026	PBA 2027
Arsimi profesional	62,068	63,930	65,209	66,513
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	30,659	31,884	31,884	31,884
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	38,183	44,503	44,927	45,359
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.- per personelin	165,491	199,467	199,466	199,467
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.- stafin mbeshtetes	64,940	67,533	67,533	67,533
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	50,121	67,343	67,343	67,343
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	13,543	14,084	14,084	14,084
Rrjeti rrugor rural	23,061	23,784	24,194	24,612
Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit	31,980	33,257	33,257	33,257
Klubi shumesportesh Partizani dhe Studenti				
Menaxhimi I mbetjeje urbane	16,325	16,977	16,977	16,977
Totali transfertes se pakushtezuar sektoriale	496,371	562,762	564,874	567,029
Rritja e nivelit te pagave				
TOTALI	496,371	562,762	564,874	567,029

4. Analiza krahasuese

4.1. Ndryshimet 2025 krahasuar me 2024

- **Rritje më e lartë:**

- **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (+34.4%)**: Prioriteti është i dukshëm për përmirësimin e kapaciteteve emergjente.
 - **Kujdesi social (+16.6%)**: Reflekton rritje të angazhimit për personat vulnerabël.
 - **Arsimi bazë - personeli (+20.5%)**: Rritja tregon prioritetin për fuqizimin e stafit edukativ.
 - **Rritje më e ulët:**
 - **Arsimi profesional (+3.0%)**: Rritja modeste sugjeron përmirësime të vogla në këtë sektor.
 - **Rrjeti rrugor rural (+3.1%)**: Fokusimi është i kufizuar në përmirësime minimale.
 - **Pa ndryshim:**
 - **Menaxhimi i mbetjeve urbane (0.0%)**: Nuk ka përmirësime në këtë sektor, duke treguar një qëndrueshmëri të shërbimeve ekzistuese.
-

4.2. Mesatarja 2025-2027 krahasuar me 2024

- **Rritje më e madhe:**
 - **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (+34.4%)**: Prioritet afatgjatë për emergjencat.
 - **Kujdesi social (+17.7%)**: Fokus në mirëqenien sociale gjatë gjithë periudhës.
 - **Arsimi bazë - personeli (+20.5%)**: Përmirësim i qëndrueshëm për arsimin bazë.
 - **Rritje mesatare:**
 - **Arsimi profesional (+5.1%)**: Rritje e qëndrueshme.
 - **Rrjeti rrugor rural (+4.9%)**: Përmirësim i vazhdueshëm i infrastrukturës rurale.
 - **Pa ndryshim:**
 - **Menaxhimi i mbetjeve urbane (0.0%)**: Mbetet një sektor pa zhvillim të mëtejshëm.
-

Bashkia Shkodër me fondet e veta ka planifikuar një shtesë prej 1 % nga fondet e veta për funksionin e mbrojtjes civile në programin Siguria publike dhe mbrojtja civile

Refreuar pergjigjes se MFE se “Kush konsiderohet buxheti i NJQV mbi të cilin do të llogaritet 1 % për mbrojtjen civile?”, jemi njoftuar se:

Buxheti i NJQV, mbi të cilin do të llogaritet të paktën 1 % për mbrojtjen civile, konsiderohet buxheti i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak (nga të ardhurat e veta vendore, nga fondet që ju vijnë drejtpërdrejtë nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja, donacionet, transferta e pakushtëzuar e pergjithshme dhe sektoriale, si dhe burime të tjera të parashikuara me ligj) pa përfshirë Transferten e Kushtëzuar nga buxheti i shtetit.

Prandaj mbi këte baze është bërë llogaritja e fondit prej te pakten 1 % për mbrojtjen civile si më poshtë :

000/leke

Llogaritja e fondit te mbrojtjes civile			
VITI	PBA 2025	PBA 2026	PBA 2027
Burimet e veta	2,867,750	2,889,376	2,927,546
Llogaritja e fondit prej te pakten 1% per mbrojtjen civile	28,678	29,106	29,493

3.2 Shpenzimet

Ne mbështetje të udhëzimit nr. 3 datë 18.2.2024 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem të 2025-2027 “ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë , Bashkia e Shkodrës është përzgjedhur bashki pilot dhe për procesin e PBA 2025-2027 është punuar me metodologjinë e re të cituar në shtojcën 5 të këtij udhëzimi që thuhet :

1. *Shtojca e veçantë e këtij udhëzimi është përgatitur për bashkitë Korçë, Gjirokastër, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shijak, Shkodër dhe Belsh të cilat do të ndjekin një metodologji të re për përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Këto bashki do të përgatisin PBA 2025-2027 dhe buxhetin për vitin 2025 duke përdorur:*
 - a) *Informacionin për transfertat nga qeveria qendrore sipas shtojcës nr.1 të këtij udhëzimi.*
 - b) *Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV).*
 - c) *Metodologjinë e re të planifikimit dhe kodifikimit të programeve dhe produkteve, sipas kësaj shtojce.*
2. *Metodologjia e re mbështetet në katër kritere të rëndësishme:*
 - a) *Struktura e programeve buxhetore të NJVQV-ve pilot bazohet në strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve të NJVQV-ve (por nuk njihsohet domosdoshmërisht me to)¹.*
 - b) *Ruajtja e raportimit funksional të shpenzimeve për 36 klasa të nivelit të 3-të të COFOG.*
 - c) *Heqja e detyrimit të NJVQV-ve për të patur deri në 20 programe (të bazuara në nivelin 3 COFOG), 20 Ekipe të Menaxhimit të Programit dhe 20 DEMP.*
 - d) *Ruajtja e një numri të menaxhueshëm të programeve buxhetore, duke shmangur problematikën e numrit shumë të madh të programeve të vogla që aktualisht përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore.*
3. *Parimet themelore të metodologjisë së re, që do të zbatohet gjatë vitit 2024 nga këto 12 NJVQV janë:*
 - a) *Shkëputja e dimensionit të funksionit nga ai i programit për raportimin funksional të shpenzimeve. Funksioni do të identifikohet tashmë përmes kodit të produktit (dhe jo kodit të programit) për raportimin fiskal.*
 - b) *Lejimi i NJVQV-ve që të krijojnë programe buxhetore të ngjashme me strukturat e menaxhimit të shërbimeve:*
 - *Kodet për programet e reja të jenë të ndryshme dhe të dallueshme nga kodet e programeve të vjetra të NJVQV-ve (shiko më poshtë Seksionin e fundit të kësaj shtojce).*
 - *Kodet e reja në planin e llogarive për programet e reja do të përfshihen në përgatitjen e buxhetit të NJVQV-ve dhe në sistemin e thesarit për qëllime të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.*
 - c) *Kodet e produkteve do të mundësojnë raportim të saktë fiskal kundrejt nivelit të 3-të të COFOG (36 funksioneve të qeverisjes vendore).*
 - d) *Dimensioni i funksionit do të përdoret vetëm për raportim dhe raportimi funksional i shpenzimeve do të kryhet përmes kodit të produktit, përcaktuar si më poshtë në shtojcë.*

¹ Struktura e programeve e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 23, datë 30.07.2018, “Për Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të NJVQV”, të ndryshuar, **nuk** do të zbatohet nga këto 12 bashki.

- e) *Përgatitja dhe Zbatimi i Buxhetit të Vitit 2025 për këto 12 bashki do të bëhet në nivel produkti, krahas klasifikimeve të tjera buxhetore të përcaktuara me ligj.*
4. *Bazuar në metodologjinë e re për përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit:*
- Drejtuesit e programeve të NJVQV, në vitin 2025, do të menaxhojnë zbatimin e një vëllimi më të madh burimesh financiare që më parë ishin të fragmentuara në një numër të madh programesh të bazuara në nivelin 3 të COFOG.*
 - Madhësia mesatare e buxhetit të programeve individuale do të rritet, duke u lejuar drejtuesve më shumë fleksibilitet në zbatim, në përgjigje të ngjarjeve të paparashikuara dhe të paparashikueshme.*
 - Kjo përmirëson ndjeshëm mundësinë për të planifikuar dhe shpërndarë burimet në mënyrë korrekte për programet dhe produktet në përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe në përgatitjen e Buxhetit të Vitit 2025. NJVQV-të duhet të përmirësojnë procesin e buxhetimit nëpërmjet:*
 - Finalizimit të kujdesshëm i produkteve të PBA 2025-2027.*
 - Përfshirja e produkteve të PBA 2025-2027 në Buxhetin e Vitit 2025.*
 - Rishikimi i produkteve të vitit 2025 në dokumentin e PBA-së 2025-2027 në përgjigje të çdo udhëzimi të Këshillit Bashkiak për ndryshimin e produkteve të Buxhetit të Vitit 2025.*
5. *Për të përgatitur PBA 2025-2027 dhe Buxhetin e Vitit 2025, 12 njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të ndjekin hapat si më poshtë:*
- NJVQV-të mund të përzgjedhin programet e tyre buxhetore bazuar në nevojat për menaxhimin e shërbimeve publike vendore.*
 - Produktet nga më shumë se një klasë (niveli 3), grup (niveli 2) ose (niveli 1) i COFOG lejohen të përfshihen në një program të vetëm.*
 - NJVQV-të do të dakortësohen me Drejtorinë e Financave Vendore pranë Ministrisë së Financave për përshtatshmërinë dhe kodifikimin e programeve dhe produkteve të tyre.*
 - Programet, produktet dhe kodet përkatëse për zbatimin e buxhetit për funksionet e deleguara do të vazhdojnë të trajtohen si edhe më parë.*

Sipas udhëzimit Plotësues nr.3 datë 28.02.2024 “ Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2025-2027” dhe ne zbatim te shtojces nr.5 , pjesë e udhezimit , struktura e programeve te buxhetit vendor te Bashise Shkodër do të jetë si më poshtë:


Nr	Emertimi I programit
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse
2	Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile
3	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe rural
4	Planifikimi dhe kontrolli i territorit dhe Mjedisi
5	Shërbimet Publike Vendore
6	Kultura, Sporti dhe Argëtim
7	Përkujdesi Social
8	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë
9	Arsimim

Shpenzimet ne vitet 2025 - 2027 mbulohen nga transferta te pakushtezuar dhe transferte sektoriale mesatarisht 56 % ndersa me te ardhurat e veta dhe donaciononet mbulohen mesatarisht 44 %. Konkretisht ne vitin 2025 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe sektoriale me 54.5 % dhe 45.5 % me te ardhurat e veta dhe donaciononet , ne vitin 2026 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe transferte sektoriale ne masen 56.8 % dhe 43.2 % me transferta te pakushtezuar dhe transferte sektoriale ,ne vitin 2027 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe transferte sektoriale ne masen 57.4 % dhe 42.6 % me te ardhurat e veta dhe donaciononet .

Tabela 26 Planifikimi i buxhetit për vitet 2024 -2026 sipas klasifikimit ekonomik

Zërat e shpenzimeve	000/lekë		
	VITI 2025	VITI 2026	VITI 2027
Paga dhe sigurime shoqërore	1,267,861	1,269,627	1,269,172
Shpenzime operative	1,073,024	1,058,262	1,067,911
Transferta	253,363	252,565	255,167
Investime	343,885	308,920	335,294
Totali	2,938,133	2,889,374	2,927,544

Grafik 1 Raporti i zerave te shpenzimeve mbi totalin sipas viteve



1. Analiza e shpenzimeve totale

- Viti 2025: Totali i shpenzimeve është 2,938,133 mijë lekë.
- Viti 2026: Totali i shpenzimeve ulet në 2,889,374 mijë lekë, duke shënuar një rënie prej 1.66% krahasuar me vitin 2025. Meqenese ne vitin 2026 ne krahasim me vitin 2025 nuk kemi te ardhura te trasheguara dhe realizimi i te ardhurave nga detyrimet e prapambetura eshte planifikuar ne vlere me te larte ne vitin 2025 .
- Viti 2027: Totali i shpenzimeve rritet në 2,927,544 mijë lekë, që përfaqëson një rritje prej 1.32% krahasuar me vitin 2026.

2. Analiza e zërave të shpenzimeve

a) Paga dhe sigurime shoqërore

- Viti 2025: 1,267,861 mijë lekë, duke zënë 43.15% të totalit.
- Viti 2026: 1,269,627 mijë lekë, me një rritje minimale prej 0.14% krahasuar me vitin 2025. Pesha specifike mbetet pothuajse e njëjtë, me 43.95% të totalit.
- Viti 2027: 1,269,172 mijë lekë, duke shënuar një rënie të lehtë prej 0.04% krahasuar me vitin 2026 dhe një peshë specifike prej 43.37%.

Ne korrik dhe shtator te vitit 2024 kemi rritje te nivelit te pagave gje qe ka sjelle dhe efektet financiare ne PBA 2025-2027.

b) Shpenzime operative

- Viti 2025: 1,073,024 mijë lekë, që përfaqëson 36.51% të totalit, me një rritje prej 3.77 % krahasuar me vitin 2024.
- Viti 2026: 1,058,262 mijë lekë, me një rënie prej 1.38% krahasuar me vitin 2025. Pesha specifike zbret në 36.63%.
- Viti 2027: 1,067,911 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 0.91% krahasuar me vitin 2026 dhe një peshë specifike prej 36.49%.

Shpenzimet operative zene mesatarisht 36.5% te shpenzimeve te pergjithshme meqenese jane planifikuar kryerja e disa sherbimeve publike nga vete njesite shpenzuese dhe jo me sipermarje duke rritur keshtu peshen specifike te shpenzimeve dhe duke ulur peshen specifike te investime .

c) Transferta

- Viti 2025: 253,363 mijë lekë, me një peshë specifike prej 8.63%, me një rritje prej 26.09 % krahasuar me vitin 2024.
- Viti 2026: 252,565 mijë lekë, duke shënuar një rënie minimale prej 0.31% krahasuar me vitin 2025 dhe një peshë specifike prej 8.74%.
- Viti 2027: 255,167 mijë lekë, që përfaqëson një rritje prej 1.03% krahasuar me vitin 2026 dhe një peshë specifike prej 8.72%.

d) Investime

- Viti 2025: 343,885 mijë lekë, duke përbërë 11.71% të totalit.
- Viti 2026: 308,920 mijë lekë, duke reflektuar një rënie krahasuar me vitin 2025. Peshë specifike zbret në 10.70%.
- Viti 2027: 335,294 mijë lekë, me një rritje prej 8.53% krahasuar me vitin 2026 dhe një peshë specifike prej 11.46%.

Shume shërbime publike të kryhen nga vete ndermarrja e punëve publike e krijuar për këto qëllime ka sjelle uljen e kostos së investimeve në total dhe kryerjen e investimeve për të pasqyruara si kosto operative dhe si kosto personeli në buxhetin e paraqitur.

Analiza për peshat specifike dhe kontributet kryesore të programeve dhe shpenzimeve për periudhën 2025-2027.

Në vitin 2025 janë planifikuar shpenzime bruto në shumën **2,938,133 mijë lekë**, një rritje prej **8.93%** në krahasim me vitin 2024 ku peshë më e madhe specifike sipas programeve është:

- **AE141 - Shërbimet Publike Vendore**, që zë **28.4%**.
- **AI141 - Arsimi**, që zë **25.2%** të totalit.
- **AA141 - Menaxhim dhe Shërbime Mbështetëse**, që zë **11.6 %**

Struktura e shpenzimeve për vitin 2025:

- **Paga dhe sigurime shoqërore** janë planifikuar në shumën **1 267 861 mijë lekë**: Zënë **43.2%** të totalit. Peshën më të madhe specifike e zënë:
 - **AI141 - Arsimi**, që zë **37.3%**,
 - **AA141 - Menaxhim dhe Shërbime Mbështetëse**, që zë **17.6%**, dhe
 - **AE141 - Shërbimet Publike Vendore**, që zë **12%**.
- **Shpenzime korrente** janë planifikuar në shumën **1 326 387 mijë lekë**: Zënë **45.1%**. Kontributet kryesore janë nga:
 - **AE141 - Shërbimet Publike Vendore**, që zë **48.8%**,
 - **AI141 - Arsimi**, që zë **15.7%**, dhe
 - **AF141 - Kultura, Sporti, Argetim**, që zë **14.1%**.
- **Shpenzime kapitale** janë planifikuar në shumën **343 885 mijë lekë**: Zënë **11.7%**. Peshën më të madhe specifike e zënë:
 - **AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi**, që zë **57.3%**,
 - **AI141 - Arsimi**, që zë **16.9%**, dhe
 - **AE141 - Shërbimet Publike Vendore**, që zë **10.5%**.

Viti 2026

Në vitin 2026 janë planifikuar shpenzime bruto në shumën **2,889,374 mijë lekë**, një ulje prej **1.7%** në krahasim me vitin 2025. Struktura sipas programeve është:

- **AE141 - Shërbimet Publike Vendore**, që zë **28.3%**.
- **AI141 - Arsimi**, që zë **24.2%** të totalit.

- AA141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi, që zë 11.7%,
- **Struktura e shpenzimeve për vitin 2026:**
- **Paga dhe sigurime shoqërore** janë planifikuar në shumën **1 269 627 mije leke**: Përfaqësojnë **43.9%** të totalit, me peshat kryesore nga:
 - AI141 - Arsimi, që zë **37.2%**,
 - AA141 - Menaxhim dhe Shërbime Mbështetëse, që zë **17.6%**, dhe
 - AE141 - Shërbimet Publike Vendore, që zë **12%**.
- **Shpenzime korrente** janë planifikuar në shumën **1 310 827 mije leke**: Zënë **45.4%**, ku peshat kryesore janë:
 - AE141 - Shërbimet Publike Vendore, që zë **49.9%**,
 - AI141 - Arsimi, që zë **15.8%**, dhe
 - AF141 - Kultura, Sporti, Argetim, që zë **13.4%**.
- **Shpenzime kapitale** janë planifikuar në shumën **308 920 mije leke**: Arrijnë **10.7%**, ku:
 - AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi, që zë **78.1%**,
 - AG141- Përkujdesi Social që zë **9.7%**,
 - AI141 - Arsimi, që zë **6%**, dhe

Viti 2027

Në vitin 2027 janë planifikuar shpenzime bruto në shumën **2,927,544 mijë lekë**, me një rritje prej **1.3%** në krahasim me vitin 2026. Struktura sipas programeve është:

- AE141 - Shërbimet Publike Vendore, që zë **28%**.
- AI141 - Arsimi, që zë **23.9%** të totalit.
- AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi, që zë **12.5%**,

Struktura e shpenzimeve për vitin 2027:

- **Paga dhe sigurime shoqërore** janë planifikuar në shumën **1 269 172 mije leke**: Përfaqësojnë **43.4%** të totalit, ku kontribuojnë:
 - AI141 - Arsimi, që zë **37.2%**,
 - AA141 - Menaxhim dhe Shërbime Mbështetëse, që zë **17.6%**, dhe
 - AE141 - Shërbimet Publike Vendore, që zë **12%**.
- **Shpenzime korrente** janë planifikuar në shumën **1 323 078 mije leke**: Përbëjnë **45.2%**, ku:
 - AE141 - Shërbimet Publike Vendore, që zë **49.5%**,
 - AI141 - Arsimi, që zë **15.9%**, dhe
 - AF141 - Kultura, Sporti, Argetim, që zë **13.7%**.
- **Shpenzime kapitale** janë planifikuar në shumën **335 294 mije leke**: Përbëjnë **11.5%**, ku:
 - AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi, që zë **80.3%**,
 - AG141- Përkujdesi Social që zë **8.9%**,
 - AI141 - Arsimi, që zë **5%**,

Fondi rezervë dhe kontingjenca

Për të tre vitet (2025-2027), është planifikuar një fond rezervë dhe kontingjence prej **31,031 mijë lekë**, ku përfshihet:

- **Fondi rezervë prej 11,281 mijë lekë**, që zë **0.4 %** të totalit.
- **Fondi kontingjence prej 19,750 mijë lekë**, që zë **0.7%** të totalit.

Në këtë analizë, do të shqyrtojmë shpenzimet për secilin program për vitet 2025-2027, duke analizuar peshën specifike të secilit komponent shpenzimi (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale), krahasuar me vitin paraardhës (2024-2025, 2025-2026 dhe 2026-2027), dhe duke vlerësuar tendencat e zhvillimit të shpenzimeve për secilin program.

1. Menaxhim dhe Shërbime Mbështetëse

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**
 - Në vitin 2025, shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë **223,712 mijë lekë**, që përbëjnë **65.8%** të shpenzimeve totale të programit. Ky përqindje mbetet pothuajse konstante për vitin 2026 dhe 2027, që tregon stabilitet të financave për pagat dhe sigurimet shoqërore gjatë periudhës.
- **Shpenzime Korrente:**
 - Në vitin 2025, shpenzimet korrente janë **106,052 mijë lekë**, që përbëjnë **31.2%** të shpenzimeve totale, dhe në vitin 2026 kjo përqindje bie në **29.5%**. Pavarësisht rënies relative, shpenzimet korrente mbeten një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për këtë program. Në vitin 2027, ato mbeten në nivele të ngjashme me vitin 2026.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Në vitin 2025, shpenzimet kapitale janë **10,393 mijë lekë**, që përbëjnë vetëm **3.1%** të shpenzimeve totale. Këto shpenzime kane një rënie në vitin 2026 , duke mbetur konstante në vitin 2027.

Krahasimi midis viteve:

- **2025 vs 2024:** Shpenzimet totale për vitin 2025 shënojnë një rritje të dukshme prej **25.9%** krahasuar me vitin 2024. Kjo është kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve korrente dhe pagave, duke reflektuar një rritje të aktiviteteve administrative dhe mbështetjes për shërbime shtesë.
- **2026 vs 2025:** Shpenzimet totale bien me **5.3%** në vitin 2026.
- **2027 vs 2026:** Shpenzimet totale për vitin 2027 mbeten në nivele të ngjashme me vitin 2026, me një rritje të prej **0.04%**, që tregon një stabilizim të shpenzimeve të këtij programi.

2. Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**
 - Në vitin 2025, paga dhe sigurimet shoqërore përbëjnë **72.4%** të shpenzimeve totale të programit (141,295 mijë lekë), dhe këtë përqindje vazhdon të rritet në vitin 2026 (73.7%), para se të stabilizohet përsëri në vitin 2027 (73.3%).
- **Shpenzime Korrente:**
 - Shpenzimet korrente janë **49,114 mijë lekë** në vitin 2025, që përbëjnë **25.2%** të shpenzimeve totale. Pesha e shpenzimeve korrente rritet gradualisht në vitin 2026 dhe 2027, duke arritur përkatësisht **25.8%** dhe **26.2%**, duke reflektuar një rritje për shërbime korrente.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Shpenzimet kapitale përbëjnë një pjesë të vogël të buxhetit total: **4,640 mijë lekë** (2.4%) në vitin 2025, duke rënë në vetëm **1,000 mijë lekë** (0.5%) në vitin 2026 dhe mbetur të pandryshuara në vitin 2027.

Krahasimi midis viteve:

- **2025 vs 2024:** Shpenzimet totale për vitin 2025 rriten me **28.2%** krahasuar me vitin 2024, kryesisht për shkak të rritjes së pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve korrente.
- **2026 vs 2025:** Pavarësisht rritjes së shpenzimeve për shpenzime korrente, shpenzimet totale mbeten të qëndrueshme me një ndryshim të papërfillshëm prej **0.005%** në vitin 2026.
- **2027 vs 2026:** Shpenzimet totale rriten lehtë me **0.2%** në vitin 2027, duke treguar stabilitet në shpenzimet për sigurinë dhe mbrojtjen civile.

3. Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**
 - Paga dhe sigurimet shoqërore përbëjnë **58.9%** të shpenzimeve totale në vitin 2025 (28,081 mijë lekë). Kjo përqindje bie në **53.4%** në vitin 2026 dhe vazhdon të bie në **51.9%** në vitin 2027. Ky rënie e peshës është për shkak të rritjes së shpenzimeve korrente për zhvillimin e projekteve.
- **Shpenzime Korrente:**
 - Shpenzimet korrente janë **18,021 mijë lekë** në vitin 2025 (37.8% e shpenzimeve totale), dhe kjo përqindje rritet në **45.6%** në vitin 2026 dhe **47.1%** në vitin 2027.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Shpenzimet kapitale janë minimale, me **1,600 mijë lekë** në vitin 2025 (3.4%), që bien në **1 000 mijë lekë** (1%) në vitin 2026 dhe në të njëjtin nivel në vitin 2027.

Krahasimi midis viteve:

- **2025 vs 2024:** Shpenzimet totale për vitin 2025 rriten me **3.3%**, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve korrente për mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe rural.
- **2026 vs 2025:** Shpenzimet totale rriten me **10.2%** në vitin 2026, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve korrente për zhvillimin e projekteve.
- **2027 vs 2026:** Rritja e shpenzimeve për vitin 2027 është më e moderuar, me një ndryshim prej **3%**, duke treguar një stabilizim të financimeve për zhvillimin ekonomik dhe mbështetje për rritjen e kapaciteteve lokale.

4. Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**
 - Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë **90,619 mijë lekë** në vitin 2025, që përbëjnë **30.3%** të shpenzimeve totale të programit. Kjo vlerë qëndron e pandryshuar për vitin 2026 dhe 2027, duke treguar një stabilitet në shpenzimet për stafin administrativ.
- **Shpenzime Korrente:**
 - Shpenzimet korrente janë **11,437 mijë lekë** në vitin 2025 (3.8% e shpenzimeve totale), dhe në vitin 2026, duke arritur në **6.124 mijë lekë** (1.8% e shpenzimeve totale) dhe një rritje të ngadaltë deri në **6,200 mijë lekë** (1.7% e shpenzimeve totale) në vitin 2027.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Shpenzimet kapitale janë të konsiderueshme, duke përbërë **65.9%** të shpenzimeve totale për vitin 2025 (196 931 mijë lekë). Kjo rritet në **71.4%** e shpenzimeve totale në vitin 2026, duke mbetur në rreth **73.5%** e shpenzimeve totale në vitin 2027. Ky program është i orientuar kryesisht në zhvillimin e infrastrukturës dhe mbrojtjen e mjedisit.

Krahasimi midis viteve:

- **2025 vs 2024:** Shpenzimet totale për vitin 2025 janë **9.4%** më të larta krahasuar me vitin 2024, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve kapitale, të cilat reflektojnë investimet në infrastrukturë dhe mjedis.
- **2026 vs 2025:** Shpenzimet totale rriten me **13.04%** në vitin 2026, për shkak të rritjes së shpenzimeve kapitale.
- **2027 vs 2026:** Shpenzimet totale rriten me **8.27%** në vitin 2027, duke pasqyruar një rritje të moderuar të shpenzimeve kapitale dhe stabilizimin e shpenzimeve korrente.

5. Shërbimet Publike Vendore

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**

- Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë **151,766 mijë lekë** në vitin 2025, që përbëjnë **18.2%** të shpenzimeve totale. Ky vlerë mbetet e pandryshuar për vitet 2026 dhe 2027.
- **Shpenzime Korrente:**
 - Shpenzimet korrente janë **647,567 mijë lekë** në vitin 2025 (77.5% e shpenzimeve totale). Ato rriten në **654,395 mijë lekë** në vitin 2026 dhe mbeten të larta në **654,813 mijë lekë** në vitin 2027, që tregon fokusimin e mundshëm në zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve për qytetarët.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Shpenzimet kapitale janë të ulëta për këtë program meqenese shërbimet kryehen me fuqine punetore të ndermarrjes dhe kryesisht shpenzohen blerje material, me **35,999 mijë lekë** (4.3% e shpenzimeve totale) në vitin 2025, në **11,849 mijë lekë** (1.4% e shpenzimeve totale) në vitin 2026 dhe duke mbetur të pandryshuara në vitin 2027.

Krahasimi midis viteve:

- **Ne vitin 2024 në krahasim me vitin 2025** kishim krijimin e ndermarrjes dhe kishte me shumë investime për blerje mjete dhe pajisje.
- **Ndërsa në vitin 2026 - 2027:** Shpenzimet totale për vitin 2027 mbeten të pandryshuara krahasuar me vitin 2026, që tregon një stabilizim në shpenzimet për shërbime dhe infrastruktura.

6. Kultura, Sporti, Argëtimi

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**
 - Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë **95,633 mijë lekë** në vitin 2025, që përbëjnë **33.1%** të shpenzimeve totale të programit. Kjo vlerë mbetet e qëndrueshme për vitet pasuese (2026 dhe 2027).
- **Shpenzime Korrente:**
 - Shpenzimet korrente janë **187,446 mijë lekë** në vitin 2025 (64.8% e shpenzimeve totale), duke u rritur në **176,210 mijë lekë** (64.2% e shpenzimeve totale) në vitin 2026 dhe duke mbetur stabile në **181,210 mijë lekë** në vitin 2027.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Shpenzimet kapitale për vitin 2025 janë **6,191 mijë lekë** (2.0% e shpenzimeve totale), në **2,650 mijë lekë** (1.0%) në vitin 2026 dhe **2,950 mijë lekë** (1.1%) në vitin 2027.

Krahasimi midis viteve:

- **2025 vs 2024:** Shpenzimet totale rriten me **5.9%** në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, që tregon rritje të financimeve për aktivitete kulturore dhe sportive.
- **2026 vs 2025:** Shpenzimet totale bien me **5.1%** në vitin 2026 për shkak të uljes së shpenzimeve kapitale.

- **2027 vs 2026:** Shpenzimet totale rriten me **1.9%** në vitin 2027, duke pasqyruar një rritje të moderuar të shpenzimeve për kultura dhe aktivitete sportive.
-

7. Përkujdesi Social

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**
 - Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë **64,280 mijë lekë** në vitin 2025, që përbëjnë **39.9%** të shpenzimeve totale, dhe kjo përqindje mbetet në nivele të ngjashme në vitin 2026 dhe 2027.
- **Shpenzime Korrente:**
 - Shpenzimet korrente janë **67,017 mijë lekë** (41.5%) në vitin 2025, duke rritur në **66,146 mijë lekë** (41.4%) në vitin 2026 dhe qëndrojnë në **67,082 mijë lekë** (41.7%) në vitin 2027.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Shpenzimet kapitale janë **30,000 mijë lekë** për çdo vit, duke përbërë **18.6%** të shpenzimeve totale, dhe mbeten të pandryshuara gjatë periudhës 2025-2027.

Krahasimi midis viteve:

- **2025 vs 2024:** Shpenzimet totale për vitin 2025 rriten me **30.6%** krahasuar me vitin 2024, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve për shërbimet e përkujdesit social.
 - **2026 vs 2025:** Shpenzimet totale bien me **1%** në vitin 2026, duke pasqyruar një optimizim të mundshëm në menaxhimin e shërbimeve.
 - **2027 vs 2026:** Shpenzimet totale për vitin 2027 janë të qëndrueshme krahasuar me vitin 2026, që tregon një stabilizim të shpenzimeve për përkujdesin social.
-

8. Arsimi

Pesha Specifike për Vitet 2025-2027:

- **Paga dhe Sigurime Shoqërore:**
 - Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë **472,475 mijë lekë** për vitet 2025-2027, që përbëjnë **63.9%** të shpenzimeve totale të arsimit.
- **Shpenzime Korrente:**
 - Shpenzimet korrente janë **208,702 mijë lekë** në vitin 2025, duke përbërë **28.2%** të shpenzimeve total dhe mbetur pothuajse të qëndrueshme në vitin 2026 dhe 2027.
- **Shpenzime Kapitale:**
 - Shpenzimet kapitale janë **58,131 mijë lekë** në vitin 2025, dhe në **18,505 mijë lekë** në vitin 2026 dhe **16,705 mijë lekë** në vitin 2027, duke i dhene

prioritet aplikimeve per investime kapitale ne buxhetin qendror dhe projekte te ndryshme.

Krahasimi midis viteve:

- **2025 vs 2024:** Shpenzimet totale për vitin 2025 rriten me **7.5%** krahasuar me vitin 2024, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore.
- **2026 vs 2025:** Shpenzimet totale bien me **5.5%** në vitin 2026.
- **2027 vs 2026:** Shpenzimet totale mbeten të qëndrueshme në vitin 2027 krahasuar me vitin 2026.

9. Fondi i Rezervës dhe Kontigjencës

Shpenzimet për fondin e rezervës dhe kontigjencës janë **31,031 mijë lekë** çdo vit për periudhën 2025-2027, duke pasqyruar një pjesë të vogël të shpenzimeve totale për çdo vit (1.1%).

Krahasimi midis viteve:

Shpenzimet për këtë fond mbeten të pandryshuara, duke siguruar një burim të qëndrueshëm për emergjencat dhe nevojat e paplanifikuara.

Tabela 27 Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT											000/leke
2025											
Kodi I Progra mit	Emri I Programit	Paga & Sigurime		Të Tjera Korente				Kapitale		Plani Total	
		600	601	602	604	606, 651, etj.	230	231			
AA141	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetë	193,014	30,698	98,783	-	7,269	-	-	-	10,393	340,157
AB141	Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	121,391	19,904	17,922	-	28,678	-	2,514	1,000	3,640	195,049
AC141	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	24,227	3,854	13,121	-	4,900	-	-	-	1,600	47,702
AD141	Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedis	78,183	12,436	11,437	-	-	-	-	6,061	190,870	298,987
AE141	Shërbimet Publike Vendore	130,940	20,826	632,567	-	15,000	-	-	-	35,999	835,332
AF141	Kultura, Sporti, Argëtim	82,510	13,123	89,846	-	97,600	-	-	-	6,191	289,270
AG141	Përkujdesi Social	55,468	8,813	16,646	-	44,503	-	5,868	-	30,000	161,297
AH141	Fond Rezerve/ Kontigjenc	-	-	-	-	-	-	31,031	-	-	31,031
AI141	Arsimi	407,642	64,833	192,702	-	16,000	-	-	8,227	49,904	739,308
TOTALI		1,093,375	174,486	1,073,024	-	213,950	-	39,413	15,288	328,597	2,938,133

Grafik 18 Shpenzimet e Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike




Tabela paraqet shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilin program buxhetore për periudhën 2025-2027.

Tabela 28 Shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë 2025-2027

TABELA 3- 5


PERMBLEDHESE

PBA 2025-2027							
Raport	Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike						
Bashkia Shkoder	Institucioni- TOTALI Thesari+ Llog Jashte Thesari						
Burim financimi : Transferte e pakushtezuar , Transferte sektoriale , Ardhurat e veta dhe Donator							
Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)							
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2022	2023	2024	2025	2026	2027
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest I miratuar VKB 55 dt 29.12.2023 dhe shtesat sipas transfertave	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime							
Paga	600	567,031	694,074	938,893	1,093,375	1,095,360	1,094,970
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	94,607	114,941	154,826	174,486	174,267	174,202
Korente							
Mallra dhe Shërbime	602	661,113	719,476	1,034,033	1,073,024	1,058,262	1,067,911
Subvencion	603	0	0	2,000	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	93,026	114,556	157,471	213,950	212,766	214,809


Transferta të Jashtme	605	0	3,477	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	22,850	35,082	10,437	8,382	8,768	9,327
Fond Rezerve dhe Kontigjencë	609	0	0	31,031	31,031	31,031	31,031
Shpenzime Kapitale							
Aktive të Paprekshme	230	13,774	5,633	9,500	15,288	2,800	1,000
Aktive të Prekshme	231	394,427	384,786	359,034	328,597	306,120	334,294
TOTALI		1,846,828	2,072,025	2,697,225	2,938,133	2,889,374	2,927,544

Grafik 19 Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Programeve

Emertimi i Programit	VITI 2025	VITI 2026	VITI 2027
AA141 -Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	340,157	321,995	322,119
AB141- Siguria Publike dhe mbrojtja civile	195,049	195,058	195,445
AC141- Mbeshtetje per zhvillim ekonomik vendor dhe rural	47,702	52,563	54,137
AD141 - Planifikimi dhe Kontrolli I Territorit dhe Mjedisi	298,987	337,966	365,916
AE141 - Shërbimet Publike Vendore	835,332	818,010	818,428
AF141 - Kultura, Sporti, Argëtim	289,270	274,493	279,793
AG141 - Përkujdesi Social	161,297	159,785	160,721
AH141 - Fond Rezerve dhe Kontigjencë	31,031	31,031	31,031
AI141 - Arsimim	739,308	698,473	699,954
Totali	2,938,133	2,889,374	2,927,544



Pesha specifike e shpenzimeve sipa programeve:



Rezultati total i Buxhetit

Tabela 29 Rezultati i buxhetit

Në mijë Lekë

	2025 plan	2026 plan	2027 plan
TOTALI I BURIMEVE TË BUXHETIT			
Burimet e përgjithshme të buxhetit	2,938,133	2,889,374	2,927,544
TOTALI I SHPENZIMEVE			
Shpenzimet e përgjithshme	2,907,102	2,858,343	2,896,513
TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË	31,031	31,031	31,031
FITIMI / HUMBJA E PËRGJITHSHME			
Përfitimi (+)/ Humbja (-) e përgjithshme	0	0	0

3.4 Informacion Financiar suplementar

3.4.1 Huamarrja

Bashkia Shkoder nuk ka huamarrje vendore.

3.4.2 Detyrimet e prapambetura

		000/leke								
		2,024	2024	2025	2026	2027				
		Viti aktual	Viti aktual	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)				
Kreditor	Data e Detyrimit	Stoku i borxhit,	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor
Rregjistrim detyrimi per tatim ne burim	09.03.2021	2	2	0	0	0	0	0	0	0
Rregjistrim detyrimi per takse kombetare	09.03.2021	240	240	0	0	0	0	0	0	0
Rregjistrim detyrimi per kontributet shoqerore	09.03.2021	18	18	0	0	0	0	0	0	0
Rregjistrim detyrimi per global	09.03.2021	311	311	0	0	0	0	0	0	0
Total		571	571	0	0	-	0	0	0	0

3.4.3 Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

- a) Identifikimi i objektivave
- b) Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme.
- c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).
- d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.
- e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura
- f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë.
- g) Monitorimi dhe raportimi.
- h) Hartimi i planit të veprimit.

Nr.	Lloji i Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Shkaku	Pasojat e Mundshme	Vlerësimi i Rrezikut (Probabiliteti/Ndikimi)	Masat për Menaxhimin e Rrezikut	Përgjegjësit për Zbatimin
1	Ndryshimet ligjore	Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin fiskal ndikojnë në stabilitetin e të ardhurave.	Ndryshime në politika ose reformat qendrore	Paqartësi në mbledhjen e të ardhurave; vështirësi në planifikim	Lartë/Mesatar	Bashkëpunim me institucionet qendrore; monitorim i rregullt i ligjeve	Zyra e financave lokale
2	Teknologji fiskale e vjetëruar	Sistemet teknologjike të vjetëruara pengojnë proceset efektive të mbledhjes së taksave.	Buxheti i kufizuar për përditësimet teknologjike	Gabime në të dhëna; efikasitet i ulët; rrezik për sigurinë	Mesatar/Lartë	Investim në përditësimet teknologjike; trajnime për stafin	Departamenti i IT dhe Financave

Nr.	Lloji i Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Shkaku	Pasojat e Mundshme	Vlerësimi i Rrezikut (Probabiliteti/Ndikimi)	Masat për Menaxhimin e Rrezikut	Përgjegjësit për Zbatimin
3	Paqartësi në rregulloret fiskale	Mungesa e udhëzimeve të qarta për mbledhjen e disa taksave lokale.	Rregullore të pasakta ose të vjetëruara	Pabarazi në mbledhje; humbje e besimit të qytetarëve	Mesatar/Mesatar	Përditësimi dhe qartësimi i rregulloreve	Zyra juridike dhe e financave
4	Demografia në rënie	Shpopullimi i zonës çon në reduktimin e bazës së taksapaguesve.	Migrimi i popullsisë, veçanërisht të rinjve	Ulje e të ardhurave; vështirësi në përmbushjen e shërbimeve	Mesatar/Lartë	Promovimi i investimeve për tërheqjen e popullsisë dhe biznesit	Zyra e zhvillimit ekonomik
5	Risku i mungesës së burimeve njerëzore të kualifikuara	Mungesa e stafit të trajnuar dhe të specializuar për mbledhjen efektive të të ardhurave.	Mungesë trajnimesh ose motivimi	Ulje e efektivitetit në mbledhje; gabime në përlllogaritje	Mesatar/Mesatar	Rekrutimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit	Departamenti i burimeve njerëzore
6	Fluksi i papritur i punës	Rritja e papritur e kërkesave për shërbime fiskale dhe tatimore.	Projekte ose politika të reja	Vonesa në përpunimin e të dhënave dhe mbledhjen e taksave	Mesatar/Mesatar	Shpërndarja efektive e burimeve; përgatitja për flukse të larta	Departamenti i taksave dhe tarifave
7	Identifikimi i pamjaftueshëm i taksapaguesve	Vështirësi në identifikimin e plotë të tatimpaguesve dhe të ardhurave të tyre.	Mungesa e regjistrave të sakta ose teknologjive mbështetëse	Humbje e të ardhurave; mos-mbledhje e detyrimeve të plota	Lartë/Mesatar	Përdorimi i sistemeve të përmirësuara për identifikimin e taksapaguesve	Zyra e taksave dhe IT
8	Rënie e investimeve lokale	Rënia e investimeve private ose publike që kontribuojnë në të ardhurat vendore.	Klima e pasigurt ekonomike ose ligjore	Rënie e të ardhurave; ulje e zhvillimit lokal	Lartë/Mesatar	Mbështetje për bizneset lokale; incentiva për investime	Zyra e zhvillimit ekonomik
9	Rritja e detyrimeve të prapambetura	Detyrime të papaguara nga taksat ose tarifat e papaguara në kohë.	Kapaciteti i ulët i ndjekjes së pagesave	Ulje e të ardhurave; përkeqësimi i raportit financiar	Mesatar/Lartë	Ndjekje më e fortë e pagesave; incentivim për pagesat në kohë	Zyra e financave dhe e taksave
10	Të Ardhura të Pamjaftueshme nga burimet ekzistuese	Burimet aktuale të të ardhurave nuk përmbushin nevojat buxhetore.	Baza e ngushtë tatimore ose rënie ekonomike	Deficit në buxhetin vendor; mungesë investimesh	Lartë/Lartë	Zhvillimi i burimeve të reja të të ardhurave; përmirësimi i eficiencës së mbledhjes	Zyra e financave dhe planifikimit

4. Monitorimi i zbatimit të strategjisë së Zhvillimit të njësisë

4.1 Hyrje – rezultati i përgjithshëm dhe përfundime

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me ‘monitorimin dhe vlerësimin’ e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit. Periudha kohore e monitorimit përfshin periudhën kur plani është miratuar deri në Maj 2024.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025 - 2027, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është realizuar kuadri logjik i PBA-së dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Prandaj monitorimi i ecurisë së zbatimit u bë mbështetur në informacionet për gjendjen e zbatimit dhe të financimit të projekteve të strategjisë deri në nentor të vitit 2024.

Burimet kryesore të informacionit për mbledhjen e të dhënave zyrtare janë: informacioni i siguruar nga drejtoritë dhe drejtoritë e varësisë dhe raportimi i zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër.

Monitorimi i zbatimit të strategjisë territoriale Shkodër përbëhet nga dy pjesë. Njëra është monitorimi të ecurisë së zbatimit. Tjetra është monitorimi i rezultateve të zbatimit.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër përbëhet nga:

- 🚩 Vizioni
- 🚩 5 objektiva strategjike
- 🚩 28 programe strategjike
- 🚩 198 projekte

VIZIONI																																							
OS1				OS2					OS3						OS4										OS5														
PS1	PS2	PS3	PS4	PS1	PS2	PS3	PS4	PS5	PS1	PS2	PS3	PS4	PS5	PS6	PS1	PS2	PS3	PS4	PS5	PS6	PS7	PS8	PS9	PS10	PS11	PS12	PS13	PS14	PS15	PS1	PS2	PS3	PS4	PS5	PS6	PS7	PS8		
P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1				
P2	P2	P2	P2		P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2			
P3	P3	P3	P3		P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3			
P4		P4			P4		P4	P4		P4	P4	P4		P4		P4	P4		P4	P4		P4	P4		P4	P4	P4	P4	P4	P4	P4	P4	P4	P4	P4	P4	P4		
P5					P5		P5	P5		P5	P5	P5		P5		P5	P5		P5	P5		P5	P5		P5	P5	P5	P5	P5	P5	P5	P5	P5	P5	P5	P5	P5		
					P6		P6	P6		P6	P6	P6		P6		P6	P6		P6	P6		P6	P6		P6	P6	P6	P6	P6	P6	P6	P6	P6	P6	P6	P6	P6		
					P7		P7	P7		P7	P7	P7		P7		P7	P7		P7	P7		P7	P7		P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	P7	
					P8		P8	P8		P8	P8	P8		P8		P8	P8		P8	P8		P8	P8		P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	P8	
					P9		P9	P9		P9	P9	P9		P9		P9	P9		P9	P9		P9	P9		P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	P9	
					P10		P10	P10		P10	P10	P10		P10		P10	P10		P10	P10		P10	P10		P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	P10	
					P11		P11	P11		P11	P11	P11		P11		P11	P11		P11	P11		P11	P11		P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11	P11
					P12		P12	P12		P12	P12	P12		P12		P12	P12		P12	P12		P12	P12		P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12	P12
					P13		P13	P13		P13	P13	P13		P13		P13	P13		P13	P13		P13	P13		P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13	P13
					P14		P14	P14		P14	P14	P14		P14		P14	P14		P14	P14		P14	P14		P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14	P14
					P15		P15	P15		P15	P15	P15		P15		P15	P15		P15	P15		P15	P15		P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15	P15
					P16		P16	P16		P16	P16	P16		P16		P16	P16		P16	P16		P16	P16		P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16	P16
					P17		P17	P17		P17	P17	P17		P17		P17	P17		P17	P17		P17	P17		P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17	P17
					P18		P18	P18		P18	P18	P18		P18		P18	P18		P18	P18		P18	P18		P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18	P18
					P19		P19	P19		P19	P19	P19		P19		P19	P19		P19	P19		P19	P19		P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19	P19
					P20		P20	P20		P20	P20	P20		P20		P20	P20		P20	P20		P20	P20		P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20	P20
					P21		P21	P21		P21	P21	P21		P21		P21	P21		P21	P21		P21	P21		P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21	P21
					P22		P22	P22		P22	P22	P22		P22		P22	P22		P22	P22		P22	P22		P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22	P22
					P23		P23	P23		P23	P23	P23		P23		P23	P23		P23	P23		P23	P23		P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23	P23
					P24		P24	P24		P24	P24	P24		P24		P24	P24		P24	P24		P24	P24		P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24	P24
					P25		P25	P25		P25	P25	P25		P25		P25	P25		P25	P25		P25	P25		P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25	P25
					P26		P26	P26		P26	P26	P26		P26		P26	P26		P26	P26		P26	P26		P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26	P26

4.2 Lista e masave strategjike për çdo fushë prioritare – statusi i shpenzimit

Zbatimi i Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkisë Shkodër mbështetet në burimet financiare të parashikuara në programin buxhetor afatmesëm, fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH etj) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës, fondet nga donatorët e huaj (Bashkimi Europian, Banka Botërore, USAID, DLPD etj) për çështje që lidhen me trajtimin e mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh.

Aktualisht programi buxhetor afatmesëm i Bashkisë Shkodër është instrumenti kryesor i financimit të planit të investimeve. Ndërsa disa nga projektet strategjike kanë gjetur mbështetjen financiare të partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit si Bashkimi Europian, Banka Botërore, UNDP, etj.

Për zbatimin e projekteve të strategjisë është marrë për bazë Plani i Investimeve Kapitale, si pjesë e dokumentit strategjik të Bashkisë Shkodër. Ky dokument ka shërbyer si udhërrëfyes për të identifikuar të gjitha investimet kapitale, prioritetin, kohën e kryerjes së tyre dhe burimin e financimit.

Në çdo rast, financimi i zbatimit të strategjisë është mbështetur në:

- Kostot e planifikimit të projekteve të strategjisë.
- Kostot reale të projekteve të strategjisë.

Përveç kostos së planifikimit të projekteve të strategjisë, duhet përmendur fakti se për një pjesë e projekteve të parashikuara në planin e investimeve nuk kanë të përcaktuar vlerën e financimit që në këtë fazë. Kjo ndodh për arsye se strategjia e zhvillimit të territorit është e shtrirë në kohë 2015 – 2030, për arsye se projektet mund të jenë të lidhura me përfundimin e projekteve të tjera zinxhir ose për shkak të natyrës specifike që ato kanë.


Sa mësipër, monitorimi i zbatimit të projekteve u bë duke u mbështetur në një shkallë vlerësimi prej tre vlerash kryesore:

- E ulët - Programet që kanë më pak se 10% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi (ngjyrë të kuqe).
- E mesme - Programet që kanë nga 11% deri në 50% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi (ngjyrë të verdhë).
- E mirë - Programet që kanë mbi 51% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mirë zbatimi. (ngjyrë të jeshile).

Për të adresuar 5 objektivat strategjike të planifikuara në këtë plan janë parashikuar 198 projekte.

Nga 198 projekte të monitoruara, të cilat kanë një afat zbatimi 2015-2030, konstatohet se:

- 47 % projekteve janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi, rreth 92 projekte;
- 44 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi, rreth 88 projekte;
- 9 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të lartë zbatimi, rreth 18 projekte.



Gjëndja e zbatimit të programeve të Planit të Përgjithshëm Vendor

Objektivi Strategjik	Programi strategjik	Statusi
OS1 - Përmirësimi i Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale	OS1PS1: Terminalet Multimodale	
	OS1PS2: Rregullimi i portave hyrëse në Shkodër	
	OS1PS3: Lidhjet Strategjike Rajonale e Kombëtare	
	OS1PS4: Bashkëpunimi Ndërkufitar	
OS2 - Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses	OS2PS1: Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)	
	OS2PS2: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane	
	OS2PS3: Qëndrat me një ndalesë dhe ngritja e kapaciteteve lokale	
	OS2PS4: Qeverisja Elektronike	
	OS2PS5: Qëndrat Multifunksionale dhe shërbimet Sociale	
OS3 - Konkureshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik	OS3PS1: Zhvillimi Rural	
	OS3PS2: Zhvillimi Akuakulturës	
	OS3PS3: Zhvillimi i Turizmit	
	OS3PS4: Mbështetja e sipërmarrjeve të reja	
	OS3PS5: Zhvillimi i Zonave Ekonomike	
	OS3PS6: Branding i Bashkisë Shkodër	
Objektivi Strategjik 4 - Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban	OS4PS1: Rikualifikimi i Ballinave Ujore	
	OS4PS2: Restaurimi i Ndertesave Historike dhe mbrojtja e trashëgimisë historike e kulturore	

	OS4PS3: Rikualifikimi i Hapësirave Industriale dhe Përdorimi i 'Broënfield'	
	OS4PS4: Urbanizimi i Zonave Informale	
	OS4PS5: Rigjenerimi Urbane	
	OS4PS6: Përmirësimi dhe Integrimi i Komuniteteve Rome dhe Egjyptiane	
	OS4PS7: Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban	
	OS4PS8: Hapësirat Publike; Hapësirat Rekreative dhe Sportive	
	OS4PS9: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ	
	OS4PS10: Strehimi Social dhe i Përballueshëm	
	OS4PS11: Eficienca Energjitike dhe Energjia e Rinovueshme	
	OS4 PS12: Transporti Publik	
	OS4PS13: Bicikletat	
	OS4PS14: Gjallëria Urbane	
	OS4PS15: Parkimet	
Objektivi Strategjik 5- Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore	OS5PS1: Mbrojtja e mjedisit	
	OS5PS2: Mbrojtja nga përmbytjet	
	OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane	
	OS5PS4: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja	
	OS5PS5: Qendra e menaxhimit nga risku i përmbytjeve	
	OS5PS6: Menaxhimi i rreziqeve natyrore	
	OS5PS7: Menaxhim i pyjeve dhe kullotave	
	OS5 PS8: Ndryshimet klimatike	

Komente përfundimtare të monitorimit

Në përfundim të monitorimit të zbatimit të strategjisë territoriale Shkodër, deri në Maj 2024 raportohen 18 projekte të zbatuara, 88 projekte në proces zbatimi dhe 92 projekte të pa nisura për zbatim.

Referuar një vlerësimi krahasimor të zbatueshmërisë së 5 objektivave strategjike rezulton me ecuri të mesme zbatimi objektivi strategjik1 Përmirësimi i Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale dhe 2 Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses nga 11% deri në 50% të projekteve të zbatuara. Pjesa më e madhe e projekteve të parashikuara në matricën e projekteve strategjike janë projekte infrastrukture.

Në kuptim të zbatimit të objektivave të strategjisë, objektivat 1, 2 dhe 3 vlerësohen me ecurinë më të mirë të zbatimit, Objektivat 4 dhe 5 vlerësohen ecurinë më të ulët të zbatimit. Për zbatimin e suksesshëm të strategjisë procesi i saj do të marrë në konsiderate realizimin e projekteve specifike si dhe dinamikën dhe nevojat në territor.

4.3 Investimet publike strategjike në nivel vendor

Grant/ndihmë - janë të ardhura të përfituara në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, për një qëllim të përcaktuar ose jo, e cila përdoret për financimin e veprimtarive në përputhje me politika të caktuara dhe që jepen mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse nga institucione financiare, organizma të huaj, qeveri të vendeve të tjera etj. dhe marrëveshje për grante ndërkombëtare sipas aplikimeve në thirrje të ndryshme.

Ministria përgjegjëse për financat kontrollon, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat, kreditë dhe grantet. NJQP-të paraqesin, pranë strukturës përgjegjëse për buxhetin, kërkesat për përfshirje në programin buxhetor afatmesëm (PBA), në të cilin identifikohen me kod të veçantë produkti sipas klasifikimit funksional buxhetor. NJQP-të janë të detyruara t'i raportojnë ministrisë përgjegjëse për financat të dhënat e kërkuara të financimeve të huaja, brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave, kredive dhe granteve me financim të huaj do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor që miratohet në Këshill Bashkiak.

Projektet me sistem të pjesshëm Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara për çdo projekt të financimit të huaj.

Projektet me sistem të plotë Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transitimit nga llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara, për çdo projekt të financimit të huaj në Bankën e Shqipërisë.

Në zbatim të vizionit për *“Shkodrën qendër të rëndësishme kombëtare e rajonale, një bashki me cilësi të mirë jetese për banorët e vet dhe mikpritëse për vizitorët”* një sërë projektesh strategjike do të realizohen përmes mbështetjes me fonde nga Qeveria Shqipëtare dhe donatorë të huaj. Investimet janë të shtrira në të gjithë territorin nga Alpet në Bregdet duke synuar një përmirësim rrënjësor të infrastrukturës e cila do të përkthehet në një zhvillim të qëndrueshëm social ekonomik për banorët, bizneset dhe vizitorët.

Përgjatë vitit 2024 një sërë investimesh për të cilat morëm angazhimin për t'i realizuar, së bashku me partnerët dhe qeverinë kanë përfunduar duke dhënë impaktin e duhur, nga këto investime mund të përmendim:

1. Rikualifikim i Shtresave Asfaltike për bulevardet kryesore të qytetit si dhe Njësi Administrative



2. Projekti i Termoizolimit dhe Rikualifikimit të 59 pallateve (Parrucë – Xhabije dhe Rus



3. Ndërtimi i 3 moleve në Zogaj, Shirokë, Shkodër



4. Tregu i Rusit



5. Ndiriçimi i rrugëve plazh Velipojë



6. Ndërtimi i fushës Sportive pranë Shkollës “Prenk Jakova”



7. Ndërtimi i fushës Sportive pranë Shkollës “Adem Haxhija”



Investimet e planifikuara ndahen, sipas madhësisë dhe maturimit të projekteve, në dy kategori afatshkurta dhe afatmesme.


Investimet afatshkurta të cilat janë në proces të zbatimit të projekteve:

1. Rikualifikimi i lagjes tregtare Zdrale
2. Rikonstruksioni i rrugëve Fermentim
3. Rruga Shirokë Shirokë Zogaj dhe investimi në rrjetin ujësjellës-kanalizime
4. Ndërtim i urës së Bahçallekut dhe rindërtim aksi Bërdicë Hyrje Shkodër
5. Ndërtimi i muzeut të navigimit
6. Rruga Shëngjin Velipojë
7. Mbrojtja nga rrëshqitjet dhe ndërtimi i veprave të artit në aksin rrugor Prekal – Kir

8. Ndërhyrje në parkun e hyrjes së Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës
9. Rikualifikim i Shtresave Asfaltike për bulevardet kryesore të qytetit
10. Projekti i Termoizolimit dhe Rikualifikimit të 75 pallateve
11. Rijetëzimi i Kinema “Republika”
12. Instalimi i Sistemit ngrohës dhe ftohës në teatrin “Migjeni”
13. Rikualifikim i Tregut Rus “Merkata”
14. Rikualifikimi i Shkollës “Kolë Idromeno”
15. Rikualifikimi i Shkollës “Ndre Mjeda”
16. Ndërtimi i fushës Sportive pranë Shkollës “Dëshmorët e Prishtinës”
17. Rikonstruksion i Kanalit Ujitës KU 10 Gur i Zi, KU 22 – 23 dhe KU 32 – 33 Bërdicë
18. Ndërhyrje rigjenerimi urban në zona periferike Blloku Rruga “Revolucioni Antikomunist Hungarez” dhe Blloku Rruga “Koplikej – Kupe Danja” Shkodër
19. Rruga Mehmet Xhelil Fishta
20. Blloku i Pallateve Vëllezërit Frashëri
21. Rruga Gjon Gazulli
22. Rruga Marin Biçikemi
23. Rruga Ernest Bushati
24. Parku për fëmijët e të rinjtë

Investimet afatgjata të cilat janë në proces:

1. Autostrada Adriatik Joniane
2. Hekurudha Vore Hani i Hotit
3. Ndërtimi i Impiantit të pastrimit të ujrave të zeza dhe rrjeti i furnizimit me ujë
4. Rikualifikim qendër Zogaj
5. Rruga lidhëse ura e Bunës – rruga nacionale Shkoder - Velipojë dhe ndërtimi i godinës së pikës së kalimit kufitar “Ura e Bunës” bashkë me infrastrukturën ndihmëse”
6. Ndërhyrje në kalanë Rozafa
7. Rijetëzimi dhe përmirësimi i vlerave të kalasë së Drishtit



Investimet afatshkurta

1. Rikualifikimi i lagjes tregtare Zdrale

Zona ku do ndërhyhet, ndodhet në pjesën perëndimore të qendrës së qytetit. Konturohet nga dy akset qendrore, Bulevardi “Bujar Bishanaku” në veri dhe rruga “Studenti” në lindje, si dhe lidhet me unazën perëndimore me anë të rrugës “Isuf Sokoli”. Gjithashtu në anën perëndimore të tregut ndodhet Stadiumi Kombëtar “Loro Boriçi”.

Aktivitetet më të larmishme dhe më të dendura tregtare ndodhen në rrugën “Hamz Kazazi” dhe “Evlja Çelebiu”. Rruga “Hamz Kazazi” ka përfaqësuar historikisht tregun “Zdrale”.

Projekti parashikon:


- Studimin e mobilitetit të të gjithë zonës
- Rikualifikimin i sipërfaqes së rrugës dhe infrastrukturës
- Rikualifikimin i katit përdhe dhe ofrimin e shërbimeve ndaj bizneseve
- Rikualifikimin i fasadave
- Rikualifikimin e sheshit “Zdrale”

Projekti dhe preventivi për fazën e zbatimit do të hartohen në tërësi duke përfshirë infrastrukturën rrugore, ndriçimin, mobilimin urban, fasadat e ndërtesave, vitrinat e kateve përdhe, gjelbërim, etj, duke identifikuar edhe fazat e zbatimit të këtij projekti.

Përfituesit direkt të projektit janë 2100 banorët dhe 258 bizneset e zonës.

Qëllimi i projektit është, rikualifikimi dhe zhvillimi urban I zonës respektive. Projekti synon, përmasimin e infrastrukturës së nevojshme, rikualifikimin dhe unifikimin e fasadave kompozuese, promovimin e identitetit tregtar të tregut respektiv dhe të qytetit të Shkodrës në tërësi, me një ndikim pozitiv, në imazhin fizik dhe ekonomik të kësaj zone.

Zbatimi i këtij projekti do të kthejë shit-blerjen në tregun Zdrale nga një aktivitet, në një përjetim për të gjithë (tregtarë, banorë, blerës, turistë, vizitorë vendas dhe të huaj, etj). Ky projekt do të shërbejë si nxitës për thithje të investimeve private apo publike me profil tregtar, në këtë zonë por dhe në mbarë qytetin.



 **MARKATA
E PESHKUT
ZDRALE**

 **TREGU USHOIMOR
FRUTA/PERIME
ZDRALE**

 **BARE +
RESTORANTE
ZDRALE**

 **KULTURË +
TRASHEGIMI
ZDRALE**

 **HOTELE +
SHTEPI PRITJE
ZDRALE**

 **SHKOLLIM
PROFESIONAL
ZDRALE**





2. Rikonstruksioni i rrugëve Fermentim

Me synim përmirësimin e infrastrukturës në zonat informale Bashkia Shkoder me financimin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka filluar zbatimin e punimeve për “Rikonstruksionin e rrugëve Fermentim” përkatësisht:

rruga Besa: 428 ml

rruga Ardian Kodra: 744 ml

rruga Dëshmorët: 925 ml

rruga Çlirimi: 421 ml

rruga 12 Vjetori: 422 ml

rruga Ora e maleve: 223 ml


në një gjatësi lineare prej 3.2 km total dhe impaktuar direkt përmirësimin e cilësisë së jetesës për mbi 1000 banorë. Punimet parashikojnë rikonstruksionin e një sipërfaqeje prej rreth 10,500 m² duke ndërhyrë në infrastrukturën nëntokësore të kanalizimeve dhe asfaltimin e katyre rrugëve si dhe paisjen me ndriçim dhe sinjalistikwn përkatëse.

4. Ndërtim i urës së Bahçallekut dhe rindërtim aksi Bërdicë Hyrje Shkodër

Akset hyrës i qytetit nga Bërdica drejt Urës së Bahçallekut është tashmë një aks i rëndësishëm i transportit jo vetëm për Shkodrën por edhe për lidhjen me doganën e Muriqanit dhe Hanit të Hotit. Lëvizshmërisë e lartë në këtë rrugë si dhe në urën e Bahçallekut kërkon që të bëhen ndërhyrje infrastrukturore që lehtësojnë trafikun. Zgjerimi i rrugës dhe Urës si dhe krijimi i mundësive për përdorim të rrugëve dytësore të aksesit për bizneset e shumta të kësaj zone do të lehtësojë lëvizshmërinë dhe përmirësojë trafikun hyrës dhe dalës në qytet. Autoriteti Rrugor Shqiptar ka përmbyllur procedurën e prokurimit dhe lidh këto ditë kontratën e punimeve për segmentin rrugor të hyrjes së Shkodrës nga Harku i Bërdicës tek Ura e Bahçallëkut.

Ky investim i financuar plotësisht nga Qeveria Shqiptare me një vlerë prej rreth 8.4 milion eurosh përfshin zgjerimin e rrugës në 4 korsi, ndërtimin e trotuareve, ndërtimin e një ure të dytë mbi Drin paralel me urën ekzistuese të Bahçallëkut dhe përmirësimin e nyjeve te Harku i Bërdicës dhe tek Ura e re e Bunës.

Punimet, të cilat me lidhjen e kontratës do të fillojnë shumë shpejt, do të kenë një ndikim të madh në zbutjen e trafikut e radhëve të gjata sidomos gjatë sezonit veror. Si bashki po punojmë ngushtë me ARRSH-në për të siguruar një projekt sa më funksional e të sigurt për të gjithë përdoruesit, banorët dhe bizneset përgjatë rrugës.



5. Ndërtimi i muzeut të navigimit

Për shekuj me radhë, bregu i lumit Buna ishte një zonë ku kalonin qindra varka që ngarkonin dhe shkarkonin mallra nga liqeni. Aty pranë kishte punishte për ndërtimin dhe riparimin e anijeve që shquheshin për format e tyre të bukura dhe siluetat e stilizuara. Rindërtimi i Portit të Shkodrës dhe Muzeut të Lundrimit krijon dy pjesë të ndërlidhura që i bëjnë homazh një prej elementeve që e bënë Shkodrën një qendër të rëndësishme ekonomike në rajon. Ato janë mjete interpretimi që shpjegojnë historinë e qytetit për brezat e rinj duke shërbyer si një atraksion turistik. Ato janë gjithashtu elementë aktivë që rikthejnë traditën e ndërtimit dhe riparimit të varkave tradicionale prej druri, të cilat do të përdoren në port për të transportuar turistë dhe vendas përgjatë liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna. Projekti synon të ndërtojë një flotë varkash tradicionale që jo vetëm të rikuperojnë një traditë të vjetër, por edhe me dizajnin e saj të bukur të markave të qytetit të Shkodrës si gondolat e markave të qytetit të Venecias.

Muzeu i Lundrimit të Shkodrës përbëhet nga elementët e mëposhtëm: Historia e lundrimit përgjatë lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës. Përshkrimi i dizajnit dhe përdorimit të tre llojeve kryesore të anijeve të Shkodrës: “sule” (5-7 m), “take” (deri në 10 m), dhe “lundra” (15-20 m). Rindërtimi i anijeve historike nga vizatimet, përshkrimet dhe fotot origjinale. Shpëtimi, restaurimi dhe ekspozimi i një anijeje me avull Austro-Hungareze të fundosur pranë Shirokës. Laboratori krijues që kombinon njohuritë për materialet natyrore dhe ndërtimin artizanal të anijeve me materiale dhe teknologji moderne si skanerët 3d, prerëset lazer dhe printerët 3d. Rindërtimi i një lundrimi me varka tradicionale prej druri që do të shërbejë si një sistem transporti përgjatë liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna.





6. *Rruga Shëngjin Velipojë*

Projekti është pjesë e Projektit për Ndërlidhjen e Rrugëve Rajonale dhe Lokale (PNRRL). Ky projekt synon të përmirësojë rrugët dhe të gjenerojë përfitime ekonomike si rrjedhojë e ndërlidhjeve rrugore, veçanërisht në sektorët e bujqësisë dhe turizmit, që janë shtysa të rritjes dhe punësimit në Shqipëri. Më konkretisht, PNRRL-ja e propozuar do të mbështesë zhvillimin e turizmit përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore për destinacione ekzistuese dhe të mundshme turistike. Gjithashtu, do të sigurojë kushte cilësore dhe favorizuese për turizmin (për shembull parkime, pika vrojtimi, dhe sinjalistikë) në zonat e Projektit. Projekti do të mbështesë edhe integrimin e prodhuesve

bujqësorë në zinxhirin e vlerave agro-ushqimore dhe në pjesëmarrje në treg, veçanërisht gratë, që përbëjnë shumicën e fuqisë punëtore në bujqësi.

Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të të dy bashkive, dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Shkodër, (përgatitur nga Universiteti Shtetëror i Arizonës, MetroPolis, Universiteti Polis dhe Bashkia Shkodër në vitin 2013), Projekti ka rëndësi strategjike, veçanërisht për sektorin e turizmit.

Numri i banorëve në Shëngjin dhe Velipojë është përkatësisht 12.630 dhe 9.623 (Ministria e Punëve të Brendshme, 2017), megjithatë këto dy qytete janë destinacione turistike në rritje. Sipas raportit të analizës ekonomike të Projektit, në vitin 2017, 830.000 turistë kanë vizituar Velipojën dhe 1.000.000 turistë kanë vizituar Shëngjinin. Gjurma e propozuar e rrugës do të ofrojë një qasje më të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë në këto destinacione turistike, krahasuar me rrugët ekzistuese.




7. Mbrojtja nga rrëshqitjet dhe ndërtimi i veprave të artit në aksin rrugor Prekal – Kir

Në këtë aks rrugor mungon prej shumë vitesh ndërhyrja për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës rrugore. Ky aks rrugor rezulton të këtë një dimension strategjik për zhvillimin e turizmit në rajonin e Shkodrës dhe Tropojës.

Përgjatë këtij segmenti rrugor konstatohet një gjendje jo e mirë e parametrave teknik, gjendje e degraduar e shtresave rrugore ekzistuese dhe gjerësi e vogël e rrugës. Rruga është e ngushtë, tërësisht e amortizuar, dhe me probleme serioze që cenojnë sigurinë e qarkullimit në këtë segment. Kjo gjë shkakton vështirësi të mëdha në qarkullimin e automjeteve, duke rritur rrezikun e aksidenteve. Rruga i shërben banorëve jo vetëm të zonës, por edhe të gjithë turistëve vendas dhe të huaj kështu që është e nevojshme sistemimi i këtij aksi. Projekti konsiston në sistemimin, profilimin e rrugës si dhe vendosjen e tombinove dhe mureve mbajtës nga Fshati Prekal deri në hyrje të Fshatit Lotaj.

Duke qene se rruga ka pjerrësi gjatësore dhe kanalet anësore mungojnë, ujerat atmosferike kalojnë në rruge duke dëmtuar e prishur trupin e rrugës.

Gjatë rikonicioneve janë identifikuar të gjitha veprat e artit dhe niveli i ndërhyrjes së tyre. Rehabilitimi i këtij aksi rrugor përmirëson në mënyrë të ndjeshme aksesin për rreth 20000 banorë të tre njësisve administrative: Pult, Shalë dhe Shosh si dhe të zonave turistike (Parku Kombëtar i Thethit, luginën e Lumit Kir, Luginën e Lumit të Shalës gjithashtu dhe një numri të konsiderueshëm të monumenteve të kulturës dhe të monumenteve natyrore).



Në tërësi, ndërhyrjet e propozuara në projekt janë:

- Ndërtimi i shtresave me çakëll $t=10/15\text{cm}$ dhe $t=30/50\text{cm}$;
- Zgjidhja e drenazhimit të rrugës;
- Ndërtimi i tombinove dhe veprave të artit në rrugë;

Rruga do të ketë një gjerësi të përgjithshme prej 5.00 m, dhe do të përbëhet nga trupi i rrugës me gjerësi 4.00 m dhe në të dyja anët bankinë me gjerësi $2 \times 0.50\text{ m}$

Rruga e projektuar ruan përgjithësisht aksin e rrugës egzistuese duke bërë përmirësimet e mundshme gjeometrike të rrugës.

Shtresat e çakëllit do të shërbejnë edhe si shtresa profiluese të rrugës.

8. Ndërhyrje në parkun e hyrjes së Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës

Vendndodhja strategjike e zonës, e rrethuar nga tre lumenj në hyrje të liqenit të Shkodrës, dhe lundrimi përgjatë lumit Buna që lidhte liqenin dhe qytetin me detin, e shndërruan vendin në të kaluarën në një qendër të rëndësishme ekonomike të rajonit nën mbrojtjen e kalasë së Rozafës. Ky pol ekonomik u rrit me ndërtimin e portit të Shkodrës dhe pazari i tij u bë qendra tregtare më e rëndësishme jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajon.

Projekti synon të riaktivizojë këtë pol social dhe ekonomik të Shkodrës duke përfituar nga kushtet natyrore të vendit dhe duke lidhur e promovuar tre aktivitetet kryesore strategjike: Rekreacionin (vendësit), Turizmin (vizitorët) dhe Ekonominë (biznes). Buna Park përbëhet nga ndërhyrjet kryesore të mëposhtme:

1. Ndërtimi i shtigjeve për ecje dhe biçikleta përgjatë gjithë bregdetit që lidh dy urat.
2. Mbjellja e pemëve dhe sipërfaqet e gjelbra.
3. Ndërtimi i objekteve publike

Nderhyrjet e përfshira në këto kontrate:

- Sheshi pranë Molit të Bunës
- Auditorium
- Sheshi i Eventeve
- Sheshi i Shatërvanit
- Pazari i vjetër
- Shesh lojërash për fëmijë
- Arena e lojërave
- Parku stërvitor Buna Park
- Pylli i Aventurave
- Zona e kafeve
- Sistemit i sheshit në zonën e Parkut të Rekreacionit
- Sistemet zona e Parkut të Rekreacionit
- Rruga Zona e Parkut të Rekreacionit

Investimi do të përmirësojë atraksionin turistik të zonave, do të rrisë cilësinë e jetës së banorëve dhe gjithashtu do të rrisë interesin e vizitorëve dhe turistëve për të vizituar këto zona dhe rrisë kohëzgjatjen e qëndrimit. Nga ana tjetër, përmirësimi i hapësirave të degraduara dhe planifikimi i tyre për funksione të tjera, do të ofronte për komunitetet dhe vizitorët hapësira të reja, që do të ndihmojnë në plotësimin e shërbimeve apo dhe në rritjen e numrit të pikave të atraksionit.





9. Rikualifikim i Shtresave Asfaltike për bulevardet kryesore të qytetit

Bashkia Shkodër ka identifikuar në terren problematikat e ndryshme sa i përket amortizimit të rrjetit rrugor në qytet dhe në njësi administrative. Përmes zhvillimit të degjesave publike si dhe prioritarizimit të nevojave për investime ka përgatitur materialet përkatëse për aplikim pranë FSHZH për rikualifikim të shtresave asfaltike përkatësisht në rrugët si më poshtë:

- 1) Rruga “Smakej” (Lagja Nr.1, Shkoder)
- 2) Përmirësim i shtresave Rruga Lin Shkreli (Lagja Nr.3, Shkoder)
- 3) Përmirësim i shtresave Rruga Kole Heqimi Degezim (Lagja Nr.3, Shkoder)
- 4) Përmirësim i shtresave Bulevardi Skenderbeu (Lagja Nr.3, Shkoder)
- 5) Përmirësim i shtresave Rruga Banja e Vogel (Lagja Nr.4, Shkoder)
- 6) Përmirësim i shtresave Rruga Alimetaj (Ana e Malit)
- 7) Përmirësim i shtresave Rruga e Drinit (Bërdicë)

- 8) Përmirësim i shtresave Rruga Trush Qender dhe Maksutaj (Bërdicë)
- 9) Përmirësim i shtresave Rruga e Varrezave (Dajç)
- 10) Përmirësim i shtresave Rruga e Rrushkullit (te xhamia e re) (Dajç)
- 11) Përmirësim i shtresave Rruga Logorec, Fran Ilia (Gur i Zi)
- 12) Përmirësim i shtresave Rruga e Varrezave Katolike (Gur i Zi)
- 13) Përmirësim i shtresave Rruga Boks Kullaj (Postribë)
- 14) Përmirësim i shtresave Rruga Hysaj (Rrethina)
- 15) Përmirësim i shtresave Rruga Rakaj (Rrethina)
- 16) Përmirësim i shtresave Rruga “Todi Germenji”, “Udhetari” (Rrethina)



ID	Emertimi	Gjeresia (ml)	Gjatesia (ml)	Siperfaqe Shtresa (m2)
1	Rruga Smakej	4	105	420
2	Rruga Lin Shkreli	3.5	185	648
3	Rruga Kole Heqimi Degezim	4	245	980
4	Bulevardi Skenderbeu	12	995	11,940
5	Rruga Banja e Vogel	5	365	1,825
6	Rruga Alimetaj	4	1,530	6,120
7	Rruga e Drinit	5	320	1,600
8	Rruga Trush Qender dhe Maksutaj	4	1,570	6,280
9	Rruga e Varrezave, Dajç	4	445	1,780
10	Rruga e Rrushkullit (te xhamia e re)	3.5	790	2,765
11	Rruga Logorec, Fran Illia	4	760	3,040
12	Rruga e Varrezave Katolike	3.5	785	2,748
13	Rruga Kryesore Boks Kullaj	4.5	1,585	7,133
14	Rruga Hysaj	4.5	585	2,633
15	Rruga Rakaj	4	250	1,000
16	Rruga Todi Germenji, Udhetari	6	2,270	13,620
Totali			12,785	64,530

10. Projekti i Termoizolimit dhe Rikualifikimit të 75 pallateve

Bloqet ku do të ndërhyhet shtrihen në akset kryesore hyrëse në qytet dhe si të tillë janë pjesë e itinerareve lidhëse të qendrës qytetit me zonat atraktive shumë pranë tij, si kalaja e qytetit, liqeni, zona e Alpeve, etj.

Këto blloqe paraqet një trajtë lineare zhvillimi përgjatë akseve rrugore, me dendësi të lartë populsië, numër të lartë biznesesh në katet përdhë (bare, restorante, dyqane, etj) si dhe përdorim i lartë nga banorët i hapësirave të gjelbërta.

Ndërtesat janë të ndërtuara me gjuhën moderniste të RPSSH. Dallohen disa tipologji dhe karaktere objektësh (brenda familjes së modernizmit) të cilat reflektojnë dhe periudhën e ndërtimit:

- Pallatet plurifamiljare me module te parafabrikuara 4 - 5 katëshe

Janë godina plurifamiljare shtetërore të ndërtuara në vitet '70, me sistemin gjermano lindor "plattenbauten", të ndërtuara me parafabrikate betoni armé. Katet përdhë janë projektuar për banim. Ri adoptimi për shërbime është kryer gjatë viteve '90.

- Pallatet stekë 4 – 5 – 6 katëshe më shërbime në katin përdhë


Reflektojnë modernizmin e viteve '70 - 80 të RPSSH, të viteve '70 – '80 me mure mbajtëse tulle dhe breza betoni, me mbulesë të sheshtë. Paraqiten në formë gjatësore paralele me aksin e rrugës, me dy ose 3 volume. Volumi i parë është kati përdhë i shërbimeve (dyqane, etj). Ndërsa volumi i dytë, me funksion banimi ngjitet dhe 4-5 kate duke u tërhequr nga aksi i rrugës. Duke krijuar më shumë dritë për rrugën, por dhe duke krijuar një tarracë mbi katin përdhë të shërbimeve, e cila pas viteve '90 është përdorur nga familjarët e kateve të para për krijimin e kopshteve tarracore.

- Kullat e banimit 5 katëshe

Janë godinat e fundit shtetërore që ndërtohen në këtë bulevard. Janë 5 katëshe në formë kulle. Kati përdhë në shumicën e rasteve është i banueshëm. Shërbimet janë shpeshherë godina 1-katëshe që i bashkëngjiten në krah kullave.

Përkatësisht do të ndërhyhet në blloqet e pallateve:

Rruga Vellezerit Frasheri, Rruga Faik Konica, Rruga Mehmet Pashe Plaku, Sheshi Perash, Rruga Daut Borici, Rruga Hafiz Sabri Bushati, Rruga Qemal Dracini, Rruga Martin Camaj, Sheshi Dom Simon Jubani, Rruga Skenderbeu.



11. Rijetëzimi i Kinema “Republika”

Një ndër godinat më të bukura të Qytetit të Shkodrës ‘Kinema Republika’ së fundmi është rikthyer në administrim të Bashkisë Shkodër. E ndërtuar në 1958, kinemaja ka një kapacitet ekzistues prej 600 vendesh. Ndërtesa është karakteristike për pamjen e

saj madhështore dhe unike duke qënë se është e vetmja e ndërtuar me këtë stil në Shqipëri. Historiku i shfaqjes së filmave në Shqipëri fillon në vitet 1919 përmes artistit Kolë Idromeno i cili realizoi projektin e parë të filmit në Shkodër. Duke vlerësuar të gjithë trashëgiminë por edhe nevojën për të gjallëruar jetën artistike të qytetit të Shkodrës kemi ndërtuar vizionin e rikthimit në funksion të këtij objekti. Duke qënë se në vite e ka humbur identitetin e saj si Kinema e Qytetit, është e nevojshme që të ketë një qasje të re me një sërë ndërhyrjesh për t'a rikthyer atë në identitetin e saj. Oborri i jashtëm do të ketë funksione të ndryshme si mjedise rekreative për fëmijët dhe hapsirave të dedikuara për aktivitete të publike duke u bërë një mjedis tërheqës dhe pikë vëndtakimi për banorët.

Ndërhyrjet Infrastrukturore konsistojnë në:

- ❖ Rikualifikim të Fasadës
- ❖ Rivitalizim i sheshit
- ❖ Krijim i hapsirave rekreative

Interiori

Ndërhyrja tjetër e nevojshme ka të bëjë me interiorin e Kinemasë dhe logjistikën funksionale të saj. Me qëllimin e vendosjes në funksion si një kinema por edhe mjedis për zhvillim të aktiviteteve të ndryshme kulturore është e nevojshme që të bëhen një sërë ndërhyrjesh që rikualifikojnë mjediset e brëndshme. Kjo për të krijuar salla të reja të cilat do të përdoren si sallë e mirëseardhjes me ekspozitor të ndryshëm të historikut të filmit në Shkodër, biletaria, salla teknike si dhe salla e provave.

Paisjet

Ekrani, sistemi audio – video si dhe ndriçimi janë të tjerë element të cilët duhet të rinovohen, për të ndërtuar një standard dhe atraktivitet të kinemasë për publikun. Në kuadër të ndërhyrjeve të planifikuara janë të nevojshme instalimet e paisjeve inovative për shfaqje të filmave:

- ❖ Sistem i ndriçimit për Kinemanë
- ❖ Sistem audio





12. Instalimi i sistemit ngrohës dhe ftohës në teatrin “Migjeni”

Teatri “Migjeni” ka një ndikim të madh në zhvillimin dhe promovimin e jetës kulturore e artistike në qytetin e Shkodrës. Çdo vit, teatri pret qindra aktivitete kulturore që ushqejnë shpirtin shkodran. Duke pasur parasysh nivelin e lartë intelektual dhe kulturor si dhe dashamirësinë e publikut shkodran ndaj Teatrit dhe aktiviteteve të tij, jemi përpjekur që nga viti në vit t'i rrisim shfaqjet në nivel artistik, duke rritur kështu pritshmëritë e publikut. Megjithatë, përtej vlerave të trashëguara ndër vite, ne kemi evidentuar nevojën e ndërhyrjes brenda teatrit. Konkretisht ndërhyrja e propozuar konsiston në instalimin e sistemit të kondicionimit të Teatrit Migjeni, i cili është i amortizuar dhe jashtë funksioni, duke e bërë të veshtirë ndjekjen e aktiviteteve artistike – kulturore në teatër, si për audiencën ashtu dhe për artistët performues dhe stafin e teatrit. Luhatjet e temperaturës

dhe lagështirës në ambjentet e brendshme të godinës ndikojnë negativisht në përvojën e spektatoreve dhe dhe artisteve në teatër, duke sjellë uljen e numrit të frekuentimit në periudha të ndryshme të vitit. Prandaj projekti i propozuar ka të bëjë me realizimin e punimeve për instalimin e sistemit të kondicionimit të Teatrit Migjeni, për ta kthyer atë në një ambient të këndshëm për spektatorin dhe për artistët.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti:

Ruajtja dhe përmirësimi i vendeve të trashëgimisë kulturore në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit.


Objektivi specifik 1: Restaurimi i sistemit të kondicionimit të Teatrit Migjeni.

Ky projekt synon restaurimin, mbrojtjen dhe promovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si një mjet për të përmirësuar kushtet e institucioneve kulturore të Bashkisë Shkodër, duke kontribuar në zhvillim ekonomik lokal dhe duke ruajtur identitetin kulturor dhe historik të vendit. Prandaj përmirësimi i vendeve të trashëgimisë kulturore, sjellë përfitime të mëdha në aspektin kulturor, ekonomik, turistik si dhe në edukimin e brezave të rinj.

Objektivi specifik: Restaurimi i sistemit të kondicionimit të Teatrit Migjeni.

Bashkia Shkodër ka identifikuar nevojën për ndërhyrje në pjesën e sistemit të kondicionimit të Teatrit Migjeni për ta kthyer atë në identitet. Ndërhyrja do të fokusohet në sistemin e kondicionim-ventilimit, për ta kthyer godinën e Teatrit në një sistem efektiv dhe të qëndrueshëm, e cila siguron kushte ambientale të qëndrueshme dhe të këndshme për audiencën, si dhe kushtet e nevojshme për vënien në një skenë të një shfaqje të një niveli të lartë nga aktorët, regjizorët, skenografët, mjeshtrat e zërit dhe të fotografisë si dhe të gjithë trupës mbështetëse. Instalimi i sistemit të kondicionimit në godinën e Teatrit Migjeni do të bëjë të mundur mbajtjen konstante të temperatures dhe për rrjedhojë edhe lagështirës dhe cilësisë së ajrit duke siguruar jo vetëm komoditet për spektatorin dhe artistës por njëkohësisht për mbrojtjen e godinës nga amortizimi.





Kjo merkatë ka dy funksione

- a) Tregtim i produkteve bujqësore (treg ambulant i hapur)
- b) Tregtim i produkteve blegtorale (merkata e mishit)

Ndërsa është në zbatim e sipër investimi për merkatën e hapur të fruta perimeve, merkata e mbyllur e mishit ka një amortizim të theksuar duke mos krijuar kushte të higjenes dhe sigurisë së tregtimit të produkteve. Kjo merkatë përfaqëson një tjetër aset historik dhe të rëndësishëm të tregtisë së produkteve lokale në qytetin e Shkodrës, prandaj është me shumë vlerë rikualifikimi i saj si dhe krijimi i hapsirave frigoriferike për ruajtje të sigurisë dhe higjenes së produkteve.



14. Rikualifikimi i Shkollës “Kolë Idromeno”

Projekti Shkolla e HAPUR “Kolë Idromeno”, do të realizojë rikonstruktionin e ambienteve ekzistuese të brëndshme dhe të jashtme të godinës, duke standardizuar kushtet

dhe infrastrukturën për zhvillimin normal të programit të Shkollave të Mesme. Rikonstrukcioni i shkollës “Kolë Idromeno” i referohet standardeve të projektimit të shkollave dhe modeleve bashkohore të mësimdhënies.

Aktualisht objekti ka një oborr prej 5 841 m² nga të cilat godina e shkollës zë 740m². Vendndodhja e objektit të propozuar për ndërhyrje, sipas ortofotos dhe planimetrisë së vendndodhjes, pjesë përbërëse e projektit teknik. Shkolla “Kolë Idromeno” ndodhet në lagjen nr. 4 të qytetit të Shkodrës, përkatësisht në Blv. “Mehmet Pashë Plaku”, në një nga lagjet me densitet të lartë të popullsisë.

Duke pasur parasysh që krijimi i ambjenteve të përshtatshme dhe sipas standardeve do të nxisë pjesëmarrjen në shkollë dhe do të krijojë kushtet e favorshme për zhvillimin e nxënësve por edhe komunitetit ndërhyrja e parashikuar është totale.

Nevoja për ndërhyrje në këtë objekt prioritarizohet nga fakti që shkolla “Kolë Idromeno” ka një numër të lartë frekuentuesish prej rreth 600 nxënësish dhe në vite përveç ndërhyrjeve në mirëmbajtje, nuk ka pasur investime kapitale për rikonstrukcion. Duke qënë se kjo shkollë ndodhet në një nga lagjet më të populluara të qytetit, rikualifikimi i saj do të ndikojë direkt në të gjithë komunitetin e zonës, përmes krijimi të hapsirave të reja edukuese, rekreative dhe sportive.

Ndërhyrjet e parashikuara do të marrin në konsideratë të gjithë godinën dhe oborrin e shkollës Kolë Idromeno.





15. Rikualifikimi i Shkollës “Ndre Mjeda”

Projekti Shkolla e HAPUR “Ndre Mjeda” - Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, synon rikualifikimin total të ambjenteve ekzistuese, sipas standarteve të projektimit të Shkollave, duke shtuar klasa të reja e eliminuar kështu mësimin me turne në një nga shkollat me nr. më të lartë të nxënësve në qytetin e Shkodrës.

Objekti ku propozohet të realizohet ndërhyrja ndodhet në një nga zonat me densitetin më të lartë të popullsisë në Shkodër, përkatësisht pjesë e lagjes nr. 1. Godina e shkollës 9 vjeçare “Ndre Mjeda” është e ndërtuar në 1985 dhe në vite ka patur vetëm ndërhyrje të mirëmbajtjes. Godina është 3 katëshe me soletë pa një sistem kapote duke krijuar humbje të mëdha të energjisë dhe shpesh edhe problematika nga terraca gjatë periudhës së rreshjeve. E gjithë godina ka një amortizim në strukturën e saj, duke mos ofruar kushte të mira të zhvillimit të aktivitetit mësimor. Shkolla “Ndre Mjeda” duke qënë se është një nga shkollat më të mira 9 vjeçare në Shkodër me një vendndodhje në qendër të qytetit ka frekuencim shumë të madh prej 798 nxënësve.

Shkolla aktualisht ka një numër prej 24 klasash të cilat përveç se janë të amortizuara nuk mundësojnë akomodimin e të gjithë nxënësve duke detyruar zhvillimin e mësimin me turne. Me organizimin e ri dhe ndërtimin e godinës së re kapaciteti i klasave shkon në 38, një sallë multimediale, bibliotekë, laborator dhe palestër. Të gjitha këto ndërhyrje do të krijojnë kushte të përshtatshme për nxënësit dhe mësuesit duke eliminuar mësimin me turne, por edhe për komunitetin që do të ketë mundësi të aksesojë ambjentet rekreative e sportive të kësaj Shkollë të Hapur.





16. Ndërtimi i fushës Sportive pranë Shkollës “Dëshmorët e Prishtinës”

Aktivitetet sportive ndihmojnë të rinjtë në krijimin e marrëdhënieve ndërpersonale, lojrave në grup dhe bashkëpunimit në zhvillim të aftësive të tyre. Projekti “Jeto me Sportin” synon të përfshijë të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke nxitur përfshirjen e komunitetit në zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Konkretisht përmes këtij projekti do të bëhet rikualifikimi i ambienteve sportive në:


- Shkollën e 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, qytet, pjesë e Lagjes Nr. 4 Sheshi i ndërtesës, me një sipërfaqe rreth 3100 m², ka një gjëndje të amortizuar pa hapsira përkatëse për zhvillimin e aktiviteteve dhe orëve sportive për nxënësit.

Sipërfaqja e sheshit është pjesërisht e shtruar (me pllaka betonike vetfiksuese) ndersa pjesa tjetër jo! Gjithsesi terreni ku zhvillohen aktivitetet sportive është në gjëndje jo të mirë, duke penguar kështu ushtrimin normal të aktiviteteve sportive. Aktualisht mund të konstatohet që sheshi është i papërshtatshëm për çdo aktivitet sportiv dhe rekreativ. Aktualisht në këtë shkollë një pjesë e oborrit që perdoret si kështu sportive. Ky kështu sportiv është jashtë standardeve dhe nderhyrjet në të kanë qenë pothuajse inekzistente. Duke parë numrin e madh të nxënësve dhe nevojat që ka shkolla u mendua që ky kështu sportive egzistues të lihet ashtu siç është dhe meqë terreni na e lejon të krijojmë një kështu të ri.

Është menduar që të krijohen 1 fushë basketbolli dhe 1 volejbolli, gjithashtu dhe 1 fushë kalçeto me përmasa 17x 29 m. Shtresa e fushes do të jetë me tapet bari artificial.

Ndërtimi i ambienteve sportive të reja si dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për stërvitje, synon rritjen e numrit të sportistëve dhe cilësisë së tyre. Fusha e basketbollit 12.8m x 24 m dhe volejbollit me dimensione: 9m x 15m si dhe fusha e kalçetos me dimensione: 17m x 29m e cila do të jetë e mbuluar. Është menduar që fusha ku mund të luhen sporti i basketbollit ose volejbollit dhe kalçetos të paiset me 150 vende për qëndrimin e spektatorëve.

Rimodelimi i të gjithë sheshit, si para ndërtesës, ashtu edhe pas saj, e kthen sheshin në një hapësirë multi funksionale. Në sheshin përpara ndërtesës është menduar krijimi i një hapësirë rekreative, hapësirë kjo e cila mund të perdoret si nga nxënësit dhe mësuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti në territorin administrativ ku ndodhet Shkolla.





17. Rikonstruksimi i Kanalit Ujitës KU 10 Gur i Zi, KU 22 – 23 dhe KU 32 – 33 Bërdicë

Në përgjigje të thirrjes për aplikim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Mbi financimin e objekteve të ujitjes dhe kullimit të bashkive” ku kërkohet dërgimi i propozimeve mbi prioritetet e ndërhyrjeve në objektet e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe dërguar për financim propozimet dhe projektet e zbatimit për ndërhyrje në infrastrukturën e ujitjes.

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 226 date 09.04.2024 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, Bashkia Shkodër ka përfutur financimin e investimit për këto kanalë ujitëse.

Miratimi i financimit të këtyre projekteve i jep mundësinë Bashkisë Shkodër që me anë të zbatimit të tyre të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën e ujitjes në territorin e saj, infrastrukturë kjo e amortizuar ndër vite e cila ka nevojë për ndërhyrje kapitale të cilat janë të pamundura me buxhetin e vetë bashkisë.



18. Ndërhyrje rigjenerimi urban në zona periferike Blloku Rruga "Revolucioni Antikomunist Hungarez" dhe Blloku Rruga "Koplikej – Kupe Danja" Shkodër

Rruga "Revolucioni Antikomunist Hungarez" ndodhet në lagjen nr. 5 të Bashkisë Shkodër, e cila është një lagje periferike e qytetit në pjesën lindore të saj. Kjo rrugë është shumë e frekuentuar pasi bën lidhjen e aksit kryesor "Bulevardi Skënderbeu" me pjesën e unazës lindore të qytetit dhe është ndërlidhëse edhe me Spitalin Rajonal Shkodër apo me Stacionin Hekurudhor. Kjo lagje, edhe pse periferike, është e populluar dhe ofron tipologji të ndryshme biznesi, për shkak të aksesueshmërisë lehtësisht me qendrën urbane të qytetit apo si nyje ndërlidhëse me stacionin e trenit. Profili dominues i aktiviteteve tregtare të zonës janë dyqanet ushqimore të lagjes, përfshirë dhe furrat e bukës, lavazhe dhe servise makinash, bar-kafe, parukeri, hotel apo shërbime të tjera të profesioneve të lira.

Ndërhyrja për rigjenerimin e bllokut të pallateve parafabrikate që ndodhen në këtë rrugë vjen si vijim i të gjitha investimeve që Bashkia Shkodër ka ndërmarrë së fundmi në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, me qëllim përmirësimin e fasadave të blloqeve të banimit në funksionin estetik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës duke përmirësuar cilësinë e banesave me sistem kapotë. Shumica e pallateve ndodhen në gjendje të keqe, me probleme si lagështira apo mungesa e izolimeve cilësore në total ose pjesërisht. Situata ekonomike e banorëve në përgjithësi nuk është shumë e mirë, duke ndikuar negativisht në jetën sociale të zonës, investimet individuale, duke krijuar kështu një ambjent deri diku të paqendrueshëm.

Bashkia Shkodër ka identifikuar nevojën për ndërhyrje bllok rrugën "Koplik – Kupe Danja". Ky bllok është pjesë e lagjes nr. 4 dhe ka një densitet të lartë popullsie. Rruga konturohet nga Bulevardi "Mehmet Pashë Plaku" në perëndim dhe lidhet me unazën lindore të qytetit. Kjo zonë përfshin një kombinim të ndërtimeve të periudhave të ndryshme, ku janë ndërtuar pallate plurifamiljare trekatëshe në vitet '60, pallate me module të parafabikuara 4-5 katëshe, kullat e banimit 5 katëshe, shtesat 1-3 katëshe, shtesat anësore dhe ballore pas viteve '90. Përtej rëndësisë që ka, për infrastrukturën e qytetit, zona përballet me problematika të shumta. Një ndër problematikat kryesore në zonën e rrugës "Koplik – Kupe Danja" është gjendja e amortizuar e ndërtesave, në shumicën e të cilave nuk ka patur investime për mirëmbajtje. Katet e para janë riadotuar për shërbime ndërsa katet e tjera janë të banuara. Këto ndryshime kanë sjellë një heterogjenitet të dukshëm në zonë dhe kanë krijuar një sfidë për menaxhimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Të tjera problematika lidhen me hapësirat publike, sic janë gjelbërimi, ndriçimi, kanalizimet e ujërave të bardha, etj.

Ndërhyrjet parashikojnë:

- Rehabilitim të rrjetit rrugor të zonës së ndërhyrjes duke e plotësuar me troturarë dhe të gjithë elementët e tij.
- Përmirësim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe propozimi i rrjeteve të reja, nëse shihet si e nevojshme, si dhe facilitete të tjera publike, etj.
- Përmirësim i rrjetit të furnizimit me ujë si dhe facilitete të tjera publike, etj.
- Përmirësim i fasadave, çatime, mureve rrethues të objekteve të zonës së propozuar.
- Rikualifikim i shesheve kryesore dhe hapësirave të gjelbërta.

ZONIM FUNKSIONAL 2

Ndërhyrje rigjenerimi urban në: Blloku Rruga "Revolucioni Antikomunist Hungarez" Shkodër



ZONIM FUNKSIONAL 1


"Ndërrhyrje rigjenerimi urban në: Blloku Rruga "Koplikaç" – Kupe Danja" Shkodër



19. Mehmet Xhelil Fishta


Infrastruktura rrugore ekzistuese Rruga "Xhelil Mehmet Fishta" ka një gjatësi 637.5m me gjerësi mesatare 4m. Shtresat asfaltike mungojnë plotësisht. Projekti parashikon ndërrhyrje totale në:

- Kanalizimet ekzistuese të ujërave të zeza Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza nuk ekziston.
- Kanalizimet ekzistuese të ujërave të bardha. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha nuk ekziston.
- Rrjeti ekzistues i ujësjellësit. Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm ekziston por është në gjendje të amortizuar.
- Rrjeti ekzistues i ndriçimit rrugor. Rrjeti i ndriçimit rrugor është i tipit me krah i fiksuar në muret rrethuese dhe në shtyllat e betonit të rrjetit elektrik.
- Rrjeti ekzistues i furnizimit me energji elektrike dhe i telekomunikacionit. Linjat e energjisë elektrike janë të padisiplinuara dhe kalojnë mbi trupin e rrugës dhe në fasadat banesave.
- Sinjalistika ekzistuese pasi sinjalistika rrugore horizontale dhe vertikale nuk ekziston.




20. Blloku i Pallateve Vëllezërit Frashëri

Gjendja ekzistuese Ky segment është me rëndësi të madhe për levizjen e banorëve të kësaj zone. Ky projekt do të parashikojë ndërtimin e sheshit nga e para me të gjithë elementet e nevojshme të këtij segmenti. Gjatesia e segmentit është rreth 180 m. Ky segment është i konturuar në krahun e djathtë nga rruga e unazës perëndimore të Shkodrës dhe nga krahun e majtë me palatë 5 kateshe. Ka mungesë të trotuareve. Rruga është shtruar me çakull në mënyrë të çrregullt nga banorët. Sheshi ka gjatësi nga 2m - 23m. Trotualet nuk ekzistojnë dhe parashikohen ndërhyrje. Ujësjetësi: Rrjeti i furnizimit me ujë nuk ekziston dhe parashikohen ndërhyrje. Sistemi KUZ: Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza ekziston por është i amortizuar dhe do zëvendësohet me sistem të ri. Sistemi KUB: Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha nuk ekziston dhe projekti parashikon kullimin e tyre në krahun e djathtë të sheshit me tuba dhe me puseta cdo 25m vetëm për një segment të përcaktuar në projekt.



21. Rruga Gjon Gazulli

Aksi rrugor “Gjon Gazulli” shtrihet në pjesën lindore të qytetit të Shkodrës, në afërsi të Unazës Lindore. I pozicionuar në rajonin 5 në Bashkinë Shkodër ai kufizohet me rrugën “Mirash Ivanaj” në veri dhe lidhet me rrugën “Sarda” në jug. Rruga kufizohet në katër anët e saj me shtëpi banimi 1-3 katëshe dhe kapanone industriale. Aktualisht në këtë segment mungon plotësisht infrastruktura mbi dhe nën tokësore. Projekti për rikonstruksionin e rrugës "Gjon Gazulli" synon përmirësimin e aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës ndërlidhëse duke synuar zhvillimit e ekonomisë lokale.



22. Rruga Marin Biçikemi

Zona e ndërhyrjes shtrihet në pjesën qendrore të qytetit të Shkodrës, në kufi me qendrën historike të Qytetit. I pozicionuar në Rajonin 3 të Bashkisë Shkodër ai kufizohet me rrugën “Marin Beçikemi” në anën jugore dhe rrugën “Gjuhadol” në anën veriore. Sheshi kufizohet me pallate shumëkatëshe dhe shtëpi banimi 1-3 katëshe. Aktualisht në këtë segment mungon infrastruktura mbi dhe nën tokësore.

Projekti parashikon rikonstruksimin e plotë të këtij sheshi, në tërësinë e vet, duke përfshirë punime të rrjeteve të infrastrukturës publike (rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza, rrjeti i telekomunikacionit, rrjeti i furnizimit me energji elektrike,

ndriçimit, riparimi dhe zëvendësimi i shtresa rrugore, trotuare, gjelbërim, parkim etj.), duke përmirësuar lëvizshmërinë, sigurinë dhe cilësinë jetës së banorëve dhe duke nxitur ekonominë e zonës.

Përfitues të drejtpërdrejtë nga zbatimi i projektit do të jenë rreth 500 banorët e zonës ku shtrihet ndërhyrja dhe ato të zonave përreth.

Projekti për rikonstrukcion e këtij degëzimi të rrugës "Marin Biçikemi" synon përmirësimin e aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës ndërlidhëse duke synuar zhvillimit e ekonomisë lokale. Qëllimi i projektit konsiston në rikualifikimin e trupit të rrugës, sheshit publik dhe elementeve përbërës të tij, për krijimin një infrastrukture të sigurtë, efikase dhe të qëndrueshme për të gjithë përdoruesit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, mbitolkësor, ndriçim, gjelbërim etj. rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve në zonat më pak të zhvilluara.



23. Rruga Ernest Bushati

Aksi rrugor “Ernest Bushati” shtrihet në skajin verior të qytetit të Shkodrës, në pjesën e sipërme të zonës “Industriale”. I pozicionuar në rajonin 3 në Bashkinë Shkodër ai kufizohet me rrugën ‘Gjovalin Gjadri’ në perëndim dhe shtrihet mes rrugës "Lodërtune" në veri dhe rrugës ‘Luigj Benusi’ në jug. Rruga kufizohet në 2 anët e saj me shtëpi banimi 1-3 kate. Aktualisht në këtë segment mungon plotësisht infrastruktura mbi dhe nën tokësore. Rruga " Ernest Bushati" është një rrugë me gjatësi rreth 278 m . Rruga aktualisht paraqitet e paasfaltuar , me gabarit të pasistemuar për transport të organizuar me mjete motorrike , sidomos keto të tipit të veturave ,te cilat janë mjetet me frekuate ne zone pa përmendur këtu mjetet e transportit me kapacitet të mesëm dhe të madh të cilat mundet të shërbejnë për qëllime të ndryshme që lidhen me zhvillimin e zonës sot apo në të ardhmen.Ne pikëpamje konstruktive , rruga paraqitet përgjithësisht jashtë parametrave: ne pamje të përgjithëshme të jep idene e një segmenti të konceptuar dhe realizuar me tepër

sipas funksionit qe ka kryer , me nje mirembajtje sporadike sipas nevojës qe ka patur , cka ka bere qe deri ne shumicen e gjtesise se saj te disponohen shtresa zhavorri te ngjeshur , nderkohe qe kullimi I ujrave eshtë bere siperfaqesor dhe/ose i paorganizuar, gje qe sjell per pasoje qe ne disa segmente te ketij aksi te shfaqen random gjate periudhes se shirave pjese te mbushura me pellgje uji.



24. Parku për fëmijët e të rinjt

Qyteti i Shkodrës ka nevojë për një ambient të dedikuar, ku të rinjtë dhe fëmijët të mund të shfrytëzojnë kohën e lirë në një mjedis të sigurt dhe të organizuar, i cili do të kontribuonte në mirëqenien fizike dhe psikologjike të tyre. Në këtë kuader, propozojmë ndërtimin e një parku multifunksional, i cili mund të përfshijë fusha sportive për të zhvilluar aktivitete të ndryshme dhe duke promovuar një jetë të shëndetshme dhe aktive për të rinjtë e komunitetit, pajisje dhe struktura lojërash për fëmijët e moshave të ndryshme, të cilat do të jenë të sigurta dhe edukative dhe duke ofruar një vend argetimi dhe mesimi për më të vegjlit, hapësirë të gjelbër, ku banorët mund të relaksohen dhe të shijojnë natyrën, duke krijuar një ambient të qetë dhe të këndshëm për familjet, ambiente ndihmëse si dhe ndricim të pershtatshëm për të siguruar akses dhe përdorim gjatë gjithë ditës



Projektet Afatgjata


1. Rruga Muriqan Balldre – pjese e koridorit Adriatic Jonian ĒBIF

Shkodra është një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti.

Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër vijon realizimin e projekteve të saj strategjike infrastrukturore, me bashkëpunimin e partnerëve dhe donatorëve të ndryshëm.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim BERZH, është angazhuar përmes Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (ĒBIF) në realizimin Projektit Muriqan – Lezhë pjesë e Korridorit Adriatiko – Jonian.

Projekti ka shtrirje në territorin e Bashkisë Shkodër dhe do të japë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin e rrjetit të transportit duke ndikuar, veçanërisht, në përmirësimin e transportit në zonat me flukse të larta turistike.



2. Hekurudha Vore Hani i Hotit

Rehabilitimin e linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit, Shqipëri” është një tjetër projekt strategjik në të cilin Bashkia Shkodër është përfituese direkte. Ky Projekt është pjesë e zgjatimit të Rrjetit Kryesor të Transportit Trans-Europian TEN-T në Ballkanin Perëndimor, i cili do të lidhë Shqipërinë me rrjetet hekurudhore rajonale dhe Europiane përmes Korridorit pan Europian X.

Projekti shtrihet nga Vora ne Hanin e Hotit, pergjate hekurudhes ekzistuese. Gjatesia e pergjithshme e kesaj hekurudhe eshte rreth 120 km. Ajo pershkon Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë, me drejtim nga Jugu në Veri. Hekurudha lidh qytetet e Vorës, Mamurrasit, Laçit, Milotit, Lezhës, Shkodrës dhe Koplikut. Hekurudha kalon kufirin shtetëror Shqipëri/Mal i Zi në Hanin e Hotit. Hekurudha Vorë – Hani i Hotit, afërsisht 120 km e gjatë, u ndërtua në dy faza: nga Vora në Laç në fillim të viteve 1960, ndërsa nga Laçi në kufirin Shqipëri/Mali i Zi në vitet 1980. Traseja e planifikuar hekurudhore në përgjithësi ndjek atë ekzistuese. Përmirësimet në shtrirjen e trasese prekin vetëm disa segmente të shkurtra, të cilat ndodhen pothuajse ngjitur me atë ekzistuese dhe për këtë arsye ato nuk ndikojnë në shtrirjen gjeografike të zonës së projektit. Projekti synon:

- Rritjen ekonomike dhe përmirësimin e kushteve socioekonomike brenda vendit;
- lehtësimin e lidhjeve tregtare dhe ekonomike me vendet fqinje dhe vendet e BE-së.

Objektivat teknike te Projektit përfshijnë:

- përmirësimin e shtrirjes horizontale të linjës hekurudhore, për të mundësuar lëvizjen e trenave me shpejtësi 120 km/orë;
- përmirësimin e lartësisë së trasesë për të shmangur përmytjen e hekurudhës (km 69 deri në 74);
- zëvendësimin e superstrukturës (ballast, traversa, fiksuese, shina);
- zëvendësimin dhe rehabilitimin e përbërësve të nën-strukturës -trasese (nën-ballast, nënshtresë);
- projektimin e rrugëve të shërbimit, pothuajse paralel me linjën hekurudhore që do t'i shërbejnë popullatës lokale dhe do të shmangin kalesat e paautorizuara në nivel;
- vendosjen e sistemeve të duhura të sinjalizimit dhe telekomunikimit;
- rrethimin e linjës hekurudhore, ne te gjithe gjatesine e saj, ne te dy krahet;
- ndertimin e pengesave kunder zhurmes se trenave;
- rehabilitimin/rindertimin e stacioneve hekurudhore.




Figure 2.6_Planimetria e stacionit Shkoder



3. Projektimi dhe zbatimi i ndërtimit të impiantit të përpunimit të ujrave

KfË dhe SECO do të financojnë në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza në Bashkinë Shkodër. Bashkia Shkodër është përzgjedhur duke u bërë pjesë e programit të Infrastrukturës Bashkiake.

Investimi prej 27 milion Euro, pjesë e kredisë së KfË, do të përfshijë projektet prioritare në ujësjellës dhe kanalizimetë ujrave të zeza- KUZ.

Projektet prioritare për investim në ujësjellës:

- ✓ Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit përtej qytetit të Shkodrës në zonën e Dobraçit e të Golemit,
- ✓ Zgjerimi i rrjetit në qytetin e Shkodrës me prioritet zonat informale Livadhe, dhe Lagje nr.5 (MarLulaj, Shinat e trenit)
- ✓ Vendosja e matësve të ujit.
- ✓ Adminstrimi përmes sistemit SCADA I sistemit të shpërndarjes.
- ✓ Rehabilitimi i pus-shpimeve, rritja e kapaciteteve të rezervuarëve dhe sistemi i pompimit.

Projektet prioritare për investim në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza- KUZ:

- ✓ Ndertimi i Impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Shkodrës i ndarë në dy faza.
- ✓ Rehabilitimi dhe zëvendësimi i kolektorëve ekzistues që kanë nevojë për ndërhyrje.
- ✓ Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në Shkodër, në zonën e Dobraçit dhe të Golemit.
- ✓ Përmirësim i rrjetit ekzistues të KUZ- ve në qytetin e Shkodrës, kryesisht në zonat më të amortizuara.





4. Rikualifikim qendër Zogaj

Rehabilitim i shesheve urbane te fshatit Zogaj dhe sistemimi i rrugëve dhe shkallareve karakteristike të fshatit, gjelbërim i peizazhit urban të zonës dhe ruajtjen e arkitekturës tradicionale. Zona e ndërhyrjes mbulon nje shtirje prej 3800ml. Projekti është ndër ndërhyrjet që do të ndryshojë imazhin urban të fshatit Zogaj dhe do të forcojnë karakterin turistik të tij. Përtej këtij aspekti ai do të ndikojë dhe në rritjen e cilësisë mjedisore në zonë. Projekti jo vetëm do të ofrojë një hapësirë rekreative të këndshme për qytetarët por do të permiresoje edhe imazhin turistik te zones. Objektiv i specifik i projektit eshte rehabilitimi dhe zhvillimi urban i fshatit turistik Zogaj.

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në harmoni me peizashin urban.
- Krijimi i hapësirave rekreative për qëndrimin e banoëve dhe vizitorëve.
- Ofrimi i këndeve te lojrave.
- Gjelbërimi i zonës.
- Ofrimi i parkimeve për biçikleta dhe automjete.
- Rikualifikimi i mjedisit urban i fshatit Zogaj, restaurimit te shkallarve prej guri, ekzaltimi dhe ripërtëritja e traditës së punimeve me gurë ne zone.
- Rikualifikimi i fasadave të banimit duke ruajtur arkitekturën tradicionale të fshatit



5. Rruga lidhese ura e Bunes – rruga nacionale Shkoder-Velipoje dhe ndertimi i godines se pikes se kalimit kufitar “ura e Bunes” bashke me infrastrukturen ndihmese”

Plani i Shqipërisë dhe Malit të Zi është që, deri në vitin 2024, së bashku të ndërtojnë një urë mbi lumin Buna, e cila do të lidhë Ulqinin - komunën më jugore të Malit të Zi dhe vendpushimin e Velipojës në Shqipëri. Ura e gjatë 310 metra do të shkurtojë rrugën nga Plazhi i Madh i Ulqinit deri në Velipojë, nga 70 kilometra sa janë tani.

Ndërtimi i urës mbi Bunë dhe lidhja e dy qendrave të mëdha turistike, do të jetë jashtëzakonisht e rëndësishme për Ulqinin dhe për zhvillimin e turizmit.

Lartësia mesatare e urës në raport me nivelin më të lartë të ujit do të jetë rreth 10 metra për të mos ndërhyrë në qarkullimin lumor. I gjithë projekti do të kushtojë nëntë milionë euro dhe ndërtimi do të zgjasë rreth 18 muaj.





6. Ndërhyrje në kalanë Rozafa

Kalaja e Rozafës ka potencialin për t'u bërë një destinacion i rëndësishëm turistik në Shqipëri. Është një nga kështjellat më të mëdha dhe më të ruajtura në veri të Shqipërisë. Ajo ka një histori të gjatë që kalon në periudha të ndryshme historike dhe stile arkitekturore. Ajo ka një vlerë të lartë simbolike duke qenë dëshmitar i betejave, rrethimeve dhe festimeve të rëndësishme.

Kalaja e Rozafës sot perceptohet si një pjesë e izoluar e qytetit me akses të vështirë dhe përdoret pothuajse ekskluzivisht nga turistët, por jo aq shpesh nga qytetarët e Shkodrës. Kryesisht konsiderohet si pjesë e së kaluarës për t'u ruajtur, por jo pjesë e së tashmes së qytetit apo si e rëndësishme për të ardhmen e tij. Ndërhyrjet e parashikuara janë:

1. Transformimi i kondrës në parkun e Rozafës
2. Aksese të reja që lidhin kalanë me atraksionet përreth
3. Akses direkt nga Parku i Bunës në Kalanë Rozafa
4. Nivele të ndryshme aksesueshmërie për në kala
5. Piacë publike me pikat panoramike
6. Transformimi në një atraksion rajonal

Duke përditësuar dhe përforcuar përmbajtjen muzeologjike të kalasë me muze të rinj dhe atraksione kulturore që lidhen me qytetin dhe rajonin e Shkodrës, Kalaja e Rozafës mund të bëhet një qendër për të kuptuar historinë, kulturën dhe traditat e pjesës veriore të Shqipërisë. Pësha specifike e kalasë së Rozafës në Shqipëri mund të krahasohet me atë të kalasë së Gjirokastrës në jug, duke qenë Rozafa përfaqësuese e kulturës gegë në veri dhe Gjirokastra e kulturës toske në jug. Të dyja kështjellat mund t'u prezantojnë vizitorëve prezantimin e parë të Historisë dhe Kulturës Shqiptare, duke treguar ngjashmëritë dhe

dallimet e tyre. Programimi paralel por i ndryshëm i të dyja kështjellave mund të ndihmojë njëra-tjetrën, duke zgjuar kureshtjen e vizitorëve kur ata vizitojnë njëren kështjellë për të vizituar tjetrën dhe për të eksploruar një pjesë tjetër të vendit.



7. Rijetëzimi dhe përmirësimi i vlerave të kalasë së Drishtit

Projekti i “Rijetëzimit dhe përmirësimit të vlerave të Kalasë së Drishtit” duke shtuar kështu një tjetër atraksion në paketën turistike të Bashkisë së Shkodrës.

Kalaja e Drishtit (Drivastum) së shpejti do të jetë protagoniste e një ndërhyrjeje për rikualifikimin dhe nxjerrjen në pah të vlerave të një prej vendbanimeve më të vjetra në Shqipëri.

Bashkia Shkodër me bashkëpunimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit përmes studios Atelie 4 po planifikon së shpejti investimin në një prej zonave më me rëndësi për sa i përket historisë dhe trashëgimisë, duke e rikthyer Kalanë e Drishtit në një prej pikave më atraktive për turistët e vizitorët.

- Rivitalizimi i zonës së Kalasë së Drishtit;
- Evidentimi dhe përforcimi i gjurmëve historike;
- Restaurimi dhe rijetëzimi i objekteve dhe hapsirave të banuara brenda Kalasë;

- Kthimi i lagjes së banuar në gjëndje funksionale dhe tërheqëse për turistët; Projekti do ta kthejë zonën në një destinacion të mirëfilltë turistik duke rritur numrin e vizitorëve e duke ndikuar në zhvillimin social ekonomik të banorëve.

